amf ALBANIA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

# 2014
## RAPORT VJETOR

amf ALBANIA

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

# 2014

raporti vjetor

© 2015
**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare**

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi jeni të lutur të citoni AMF.

Për çdo informacion të mëtejshëm, ju lutemi na kontaktoni.
Adresa: Rruga "Dora D'Istria", Nr. 10,  P.O.Box. 8363, Tiranë
Tel: +355-4-2251355  / 6
Faks: +355-4-2250686
E-mail: amf@amf.gov.al
Web: www.amf.gov.al

# Fjala Përshëndetëse e Drejtores së Përgjithshme Ekzekutive

*I nderuar lexues i Raportit Vjetor 2014,*



Enkeleda Shehi
Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Veprimtaria e AMF-së gjatë vitit 2014 u karakterizua nga dy periudha kryesore. Në gjysmën e parë të vitit vëmendja u përqendrua në aspektet e analizës së rreziqeve në tregjet financiare, konkludimit të rekomandimeve të FSAP-it dhe miratimit të paketës ligjore. Ndërsa në gjysmën e dytë u ndërtua dhe filloi zbatimi i programit të detajuar të punës për përmbushjen e rekomandimeve të FSAP-it, krijimin e kuadrit të përshtatshëm për zbatimin e paketës ligjore të miratuar dhe nisjes së projekteve të asistencës në mbështetje të objektivit të forcimit të kapaciteve administrative të AMF-së.

*Prirja e tregjeve që mbikëqyr AMF ka vijuar të jetë zgjerimi.* Në vitin 2014 totali i aktiveve në këto tregje arriti në rreth 89.5 miliardë lekë, me një rritje prej 22.4% kundrejt vitit 2013. Treguesi i aktiveve gjithsej ndaj PBB-së, që shpreh kontributin e këtyre tregjeve në ndërmjetësimin financiar, arriti në nivelin më të lartë të vërejtur deri më sot, prej 6.4%.

Struktura e tregjeve u dominua nga tregu i fondeve të investimeve, i cili me 63.7 miliardë lekë asete *u rendit si tregu i dytë më të madh pas tregut bankar.* Dinamika e zgjerimit të këtyre fondeve tregon interesin që kanë investitorët vendas për produkte të reja kursimi apo investimi. Një situatë e tillë favorizohet edhe nga mjedisi mbizotërues prej vitesh me norma të ulëta të interesit, që zbatohen për produktet bankare të kursimeve. Për të përballuar sfidat e këtij tregu AMF përmirësoi bazën rregullatore për fondet e investimeve, në drejtim të forcimit të regjimit të transparencës ndaj klientit/investitorit dhe po përmirëson kërkesat për administrimin e rreziqeve në treg. Po në funksion të administrimit të rreziqeve në treg, janë kryer inspektime të përbashkëta me Bankën e Shqipërisë, si dhe po punohet për ndërtimin e një protokolli veprimesh për ushtrimin e *mbikëqyrjes së konsoliduar.*

Zhvillimi më i rëndësishëm me ndikim afatmesëm në *tregun e sigurimeve*, mbetet miratimi i ligjit për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit. AMF ka hyrë kështu në rrugën e zbatimit në praktikë të metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus rrezikun në tregun e sigurimeve.

Tregu i sigurimeve, në tërësinë e tij, shfaq të njëjtat nevoja që lidhen me përmirësimin e raportit dëme/prime dhe rritjen e shkallës së penetrimit. Gjatë vitit 2014 vëllimi i primeve të shkruara bruto u rrit, kryesisht si rrjedhojë e rritjes së nivelit të primit të produktit të sigurimit të detyrueshëm motorik. Ky zhvillim ishte rrjedhojë e masave që u ndërmorën për të stabilizuar primet e shitjes në treg dhe për të mos i lënë të ndikoheshin nga konkurrenca e ashpër.

Masat stabilizuese që mori AMF lidhen me përcaktimin e rregullave për pagesën nga rezerva monetare të dëmeve që mbulohen nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit dhe me përcaktimin e nivelit të financimit të fondit të kompensimit në masën 430 milionë lekë për vitin 2014 për të përballuar pagesat e dëmeve të prapambetura. Nga monitorimi mujor u vërejt se në tërësinë e tyre, këto masa kanë gjetur zbatim. Në veçanti, financimi i fondit të kompensimit për pagesat e dëmeve pezull u realizua në masën 105%.

*Tregu i pensioneve shfaqet më modest në krahasim me dy tregjet e tjera.* Megjithatë, dinamika e zhvillimit në këtë treg është e konsiderueshme. Totali i aseteve neto të fondeve të pensioneve private u rrit me 44.7% dhe numri i anëtarëve me 7.7%. Zhvillim i rëndësishëm në këtë treg ishte përfshirja e nxitësve të përshtatshëm fiskalë në paketën fiskale të vitit 2015.

Ndryshimet ligjore përfshinë edhe vetë AMF, me synim forcimin e kapacitetit rregullator e mbikëqyrës, përmes forcimit të pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së institucionit. Këto ndryshime të miratuara në gjysmën e parë të vitit 2014 kanë krijuar hapësirat e nevojshme që AMF të ndërtojë kapacitetet e përshtatshme administrative, të cilat ishin vënë në ngërç dhe zhvillimi i tyre ishte bllokuar.

Megjithatë, përfitimet nga ky status i përforcuar pavarësie është ende herët të shprehen për shkak të konstituimit me vonesë të Bordit të ri të AMF-së. Kështu, konstituimi përtej afatit ligjor i Bordit të ri, bëri që nga hyrja në fuqi e amendimeve (korrik 2014) deri në dhjetor 2014 të vijonte funksionimin Bordi i vjetër, për të siguruar vijueshmërinë e procesit të punës. Kjo situatë vonoi më tej ushtrimin në praktikë të kompetencave të pavarura, në veçanti të ndërtimit strukturor të institucionit, situatë të cilën po përpiqemi ta riparojmë gjatë vitit 2015. Pavarësisht kësaj, angazhimi dhe përkushtimi në punë i administratës së AMF-së ka qenë i plotë, duke kapërcyer edhe problemet e krijuara nga ndryshimi në strukturën qeverisëse.

Shpresoj që lexuesi të gjejë në këtë raport një burim të vlefshëm informimi dhe edukimi.

Me konsideratë,

Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive

## Misioni, Objektivat, Funksionet Themelore

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) është autoritet mbikëqyrës e rregullator, i integruar i tregjeve financiare të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private vullnetare në Shqipëri, që në vijim do t'u referohemi si tregje financiare nën mbikëqyrje.

AMF u krijua në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", si institucion juridik publik, i pavarur që raporton në Kuvendin e Shqipërisë. Më 17 korrik 2014 hyri në fuqi Ligji nr. 54/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9572 datë 3.7.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare"", i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në maj 2014. Ndryshimet dhe shtesat në këtë ligj synojnë forcimin e rolit mbikëqyrës dhe rregullator të AMF-së në përmbushje të objektivave të tij, nëpërmjet forcimit të pavarësisë dhe të përgjegjshmërisë së tij.

**Dispozitat e Ligji nr. 54/2014:**

- Rivendosin kompetencat e Bordit të AMF-së në lidhje me qeverisjen e institucionit, për të qenë në gjendje për t'iu përgjigjur me efektivitet procesit mbikëqyrës dhe rregullator, në mbështetje të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë së tregjeve financiare;
- Forcojnë kërkesat për AMF në lidhje me marrëdhënien me autoritete të tjera mbikëqyrëse dhe ligj-zbatuese për çështje të luftës kundër pastrimit të parave, të siguruara nga burime të paligjshme dhe financimit të terrorizmit;
- Qartësojnë mekanizmin mbrojtës për anëtarin e Bordit dhe punonjësit e AMF-së gjatë ushtrimit të detyrës në mirëbesim, me synim forcimin e pavarësisë dhe integritetit të tyre në kryerjen e detyrës;
- Forcojnë pavarësinë dhe përgjegjshmërinë financiare të AMF-së duke parashikuar krijimin e fondit rezervë, duke përshkruar mekanizmin për grumbullimin e të ardhurave duke specifikuar më qartë grumbullimin e të ardhurave dhe kthimin e tepricave në subjektet e mbikëqyrura, si dhe duke mos parashikuar financim nga buxheti i shtetit.

### Misioni

Misioni i AMF-së është të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e sigurt të tregjeve financiare nën mbikëqyrje.

### Objektivat

Në përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave të parashikuara në ligj, AMF udhëhiqet nga këto objektiva:

- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve;
- Nxitja e transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare nën mbikëqyrje;
- Sigurimi i respektimit të ligjit.

**Funksionet kryesore të AMF-së**

Funksionet kryesore të veprimtarisë së AMF-së janë rregullimi dhe mbikëqyrja:

- e tregut të sigurimeve dhe e veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit, të risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin nga këto veprimtari;
- e tregut të letrave me vlerë dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen veprimtaritë e subjekteve të lidhura me investime në letra me vlerë e që veprojnë në këtë treg;
- e tregut të pensioneve vullnetare dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit të pensioneve vullnetare, të ofruara nga subjektet e licencuara për të operuar në këtë treg;
- e veprimtarive të tjera financiare jobankare, sipas përcaktimeve të bëra nga ligjet e veçanta të fushës.

## Bordi i AMF-së

Ndryshimi i ligjit të AMF-së çoi në ndryshim të strukturës qeverisëse të institucionit. Kështu, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" organi më i lartë vendimmarrës i Autoritetit është Bordi. Bordi përbëhej nga 7 anëtarë, kryetari i të cilit kishte dhe funksionet e drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv.

Bordi që funksionoi me këtë strukturë dhe që i ushtroi funksionet e tij deri në dhjetor 2014, kishte përbërjen e mëposhtme:

- Enkeleda Shehi — Kryetare
- Mati Pepa — Nënkryetar
- Enkela Idrizi — Nënkryetare
- Miranda Ramaj — Anëtare
- Riçard Marku — Anëtar
- Kestrin Katro — Anëtare
- Astrit Hado — Anëtar

Me Ligjin nr. 54/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare"" Bordi u rikonceptua. Ai përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët, një kryetar, një drejtor i përgjithshëm ekzekutiv, një nëndrejtor ekzekutiv dhe dy anëtarë të tjerë.

Të gjithë anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për një periudhë 5-vjeçare me një të drejtë rizgjedhjeje. Bordi i parë që emërohet pas hyrjes në fuqi të amendimeve është përcaktuar me mandatet e mëposhtme të shkallëzuara (neni 24 i amendimit):

- Kryetari i Bordit, 4 vjet;
- Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, 5 vjet;
- Nëndrejtori Ekzekutiv, 4 vjet;
- Anëtarët e tjerë, 3 vjet.

Me vendim të Kuvendit të Shqipërisë, më 24 dhjetor 2014 janë emëruar Znj. Enkeleda Shehi si Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv, Znj. Mimoza Kaçi si Nëndrejtor Ekzekutiv dhe Z Arian Salati, anëtar i Bordit, propozim i Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut.

Z. Pajtim Melani është emëruar Kryetari i Bordit në datën 12 Mars 2015. Mbetet ende për t'u emëruar anëtari tjetër i Bordit, propozim i Bankës së Shqipërisë.

# Përmbajtja


**Kapitulli 1**
**Ecuria e tregjeve financiare nën mbikëqyrje** **12**
- 1.1 Prirjet në tregjet financiare 12
- 1.2 Tregu i sigurimeve 13
- 1.3 Tregu i letrave me vlerë 41
- 1.4 Tregu i pensioneve private vullnetare 45
- 1.5 Masat korrigjuese dhe administrative 48

**Kapitulli 2**
**Rregullimi i tregjeve financiare nën mbikëqyrje** **51**
- 2.1 Veprimtaria e Bordit të AMF-së 51
- 2.2 Aktiviteti rregullator 52
- 2.3 Proceset integruese për tregjet nën mbikëqyrje 56

**Kapitulli 3**
**Qeverisja dhe mbrojtja e konsumatorit** **60**
- 3.1 Qeverisja dhe sjellja në treg 60
- 3.2 Mbrojtja dhe edukimi i konsumatorëve 66

**Kapitulli 4**
**Transparenca dhe bashkëpunimi institucional** **68**
- 4.1 Transparenca dhe marrëdhëniet me publikun 68
- 4.2 Bashkëpunimi institucional 70

**Kapitulli 5**
**Organizimi i brendshëm** **77**
- 5.1 Pasqyrat financiare 77
- 5.2 Struktura organizative e kualifikimi profesional 80
- 5.3 Kuadri rregullator i AMF-së 84
- 5.4 Teknologjia e informacionit 85

**Sfida dhe projekte të ardhshme, 2015-2016** **87**

**SHTOJCA** **92**

- A: Struktura e AMF-së
- B: Lista e institucioneve të mbikëqyrura
- C: Anëtarësime dhe marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara nga AMF
- D: Raporti i Ekspertit Kontabël të Regjistruar të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2014

# Kapitulli 1
# Ecuria e tregjeve financiare nën mbikëqyrje

## 1.1 Prirjet në Tregjet Financiare

Tregjet financiare që mbikëqyren nga AMF gjatë vitit 2014 ruajtën të njëjtën strukturë nga pikëpamja e totalit të aktiveve si në vitin 2013. Madje, ato përforcuan prirjen e vërejtur gjatë periudhës 2012-2013 në drejtim zgjerimit të aktivitetit dhe rritjes së peshës së tregut të fondeve të investimeve.

Në tërësi, tregjet financiare që mbikëqyren nga AMF kanë vijuar dinamikën e zgjerimit të tyre. Totali i aseteve të këtyre tregjeve në dhjetor 2014 arriti në 89.5 miliardë lekë, rreth 6.4% kundrejt Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) ose me rritje 22.4% kundrejt vitit 2013. Prirja e fortë e rritjes së tyre është vërejtur prej vitit 2012 dhe ka ruajtur ritmin e zgjerimit. Dinamika e zgjerimit vërehet për të tre tregjet kryesore që mbikëqyren nga AMF, por prej vitit 2012 ajo vijon të jetë më e theksuar në tregun e fondeve të investimeve.

Kështu, tregu i sigurimeve vijon me një ritëm relativisht të qëndrueshëm zgjerimi, me total aktivesh që luhatet në intervalin 1.3-1.6% e PBB-së për periudhën 2005-2013 dhe 1.8% e PBB-së në vitin 2014, si rrjedhojë e rritjes së volumit të primeve të shkruara bruto. Ndikimi kryesor ka ardhur nga rritja e primit të sigurimit, kryesisht në produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik. Por pavarësisht këtij zgjerimi të tregut të sigurime, pesha e tij në tregjet financiare që mbikëqyren nga AMF është në rënie të konsiderueshme. Kështu, nga pesha pothuaj 100% që zinte tregu i sigurimeve në tregjet që mbikëqyr AMF deri në vitin 2011, ky tregues është pakësuar në përkatësisht 56%, 30.3% dhe 27.7% për vitet 2012-2014. Kjo prirje është rrjedhojë e zgjerimit shumë më të shpejtë që ka pasur tregu i fondeve të investimeve.

Tregu i fondeve të investimeve e filloi aktivitetin në vitin 2012 dhe është zgjeruar me shpejtësi duke zënë përkatësisht 43.2%, 69.1% dhe 71.6% të peshës së tregjeve që mbikëqyren nga AMF, ose 1.2%, 3.7% dhe 4.6% e PBB-së për periudhën 2012-2014. Nisur nga treguesi i nivelit të aktiveve gjithsej ndaj PBB-së rezulton që në sistemin financiar shqiptar, tregu i dytë më i rëndësishëm pas tregut bankar konsiderohet tregu i fondeve të investimeve.

Përsa i takon tregut të fondeve të pensioneve vullnetare dhe veprimtarive të tjera financiare jobankare vërehet një prirje në rritje e qëndrueshme, por që gjithsesi mbetet modeste.

Ky profil strukturor i tregjeve financiare që mbikëqyren nga AMF dhe raporti i tyre me tregun bankar shërben për të ravijëzuar ndryshimin që po pësojnë rreziqet në tregjet financiare dhe reagimin mbi këtë bazë të Autoritetit.

Megjithëse profili i rrezikut të tregjeve që mbikëqyren nga AMF ka pasur ndikim relativ të ulët në sistemin financiar shqiptar, tashmë ai nuk mund të konsiderohet i papërfillshëm si disa vite më parë, e për rrjedhojë analizohet në kuadër të rreziqeve sistemike për sistemin financiar në tërësi, dhe është në vijimësi pjesë e diskutimeve që kryhen në kuadër të Grupit Këshillimor për Stabilitetin Financiar (GKSF).

AMF, si autoritet mbikëqyrës e rregullator për tregjet financiare të sigurimeve, letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve, si dhe pensioneve private vullnetare apo veprimtarive të tjera financiare jobankare, ka për mision të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë financiare. Kjo dikton nevojën e:

- Vijimit të zbatimit të *masave stabilizuese në tregun e sigurimeve* dhe vendosjes së standardeve të mirëpërcaktuara në lidhje me rezervat minimale, si dhe zbatimin e mbikëqyrjes me bazë rreziku.
- Forcimin e *rregullave të administrimit të rrezikut të fondeve të investimeve* në harmoni me evoluimin e rregullave të përshkruara në Direktivat përkatëse të BE-së, si dhe duke mbikëqyrur ngushtësisht respektimin e regjimit të informimit të klientëve të këtyre fondeve.
- *Konfigurimin e mbikëqyrjes së konsoliduar* me autoritete të tjera rregullatore, kryesisht me Bankën e Shqipërisë (BSH), dhe hartimit të kuadrit të integruar të masave për administrimin e situatave problematike/krizës për sistemin financiar në vend, në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF).

## 1.2 Tregu i Sigurimeve

Gjatë vitit 2014 tregu shqiptar i sigurimeve pati një rritje të ndjeshme nga pikëpamja e vëllimit total të primeve të shkruara bruto të cilat kapën shifrën 11.62 miliardë lekë, duke u rritur me afro 36.14% krahasuar[1] me vitin 2013 dhe me një rritje mesatare në pesë vitet e fundit prej 8.95%. Nga pikëpamja e numrit të shoqërive vepruese në këtë treg, gjatë vitit 2014, pati një zvogëlim të tyre që erdhi nga bashkimi me përthithje i dy shoqërive të sigurimeve, në një të vetme.

**Grafik 1: Ecuria e primeve të shkruara bruto dhe dëmeve të paguara bruto në vite** *(Në mln. lekë)*




| | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Dëme të paguara bruto* | 1,227 | 1,287 | 1,294 | 1,571 | 1,733 | 2,299 | 2,228 | 2,808 | 2,696 | 2,839 |
| *Prime të shkruara bruto* | 4,011 | 4,542 | 5,948 | 7,076 | 7,877 | 8,200 | 8,215 | 8,950 | 8,538 | 11,623 |

Shënim: [1]Të dhënat e primeve të shkruara bruto janë të dhëna statistikore, ku përfshihen edhe të dhënat e primeve të shkruara bruto për shoqërinë Interalbanian Vienna Insurance Group sh.a. deri në momentin e përthithjes nga Shoqëria SIgma Vienna Insurance Group sh.a.

Me qëllim rritjen e rezultateve ekonomike-financiare, forcimin e pozitave në treg dhe rritjen e performancës kundrejt klientit, në muajin gusht 2014, shoqëria e sigurimit "Sigma Vienna Insurance Group" sh.a. dhe shoqëria e sigurimit "Interalbanian Vienna Insurance Group" sh.a. shpallën bashkimin sipas mënyrës me përthithje.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, pas vlerësimit të nivelit të provigjoneve teknike, kufirit minimal të mjaftueshëm të aftësisë paguese, treguesve teknikë si aftësia paguese dhe aktivet në mbulim të provigjoneve teknike, integrimit të sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, si dhe dhënies së miratimit nga Autoriteti i Konkurrencës, në mbledhjen e datës 30.09.2014, vendosi miratimin e bashkimit me përthithje të shoqërisë "Interalbanian Vienna Insurance Group" sh.a. nga shoqëria "Sigma Vienna Insurance Group" sh.a.

Të gjitha policat dhe detyrimet e shoqërisë që u përthith (shoqëria "Interalbanian Vienna Insurance Group" sh.a.) u morën përsipër nga shoqëria përthithëse "Sigma Vienna Insurance Group" sh.a. me të njëjtat kushte të shitura nga shoqëria e përthithur.

Pas veprimeve në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit (QKR), në datën 9.10.2014, shoqëria "Interalbanian Vienna Insurance Group" sh.a., si shoqëri e përthithur, u vlerësua e prishur në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

**Tabela 1: Shoqëri sigurimi të licencuara sipas klasave të sigurimit, 2009-2014** *(Në numër)*

| *Emërtimi* | *2009* | *2010* | *2011* | *2012* | *2013* | *2014* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Sigurim Jo-Jetë[2] | 7 | 7 | 7 | 8 | 8 | 7 |
| Sigurim Jetë | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 |
| Miks (Jetë dhe Jo-Jetë)[3] | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |

Në strukturë, tregu vazhdoi të mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën rreth 90.94% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto në këtë treg. Ndërsa sigurimet e Jetës, sollën 8.83% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto. Gjatë 2014, sigurimet vullnetare zunë 40.47% dhe ato të detyrueshme zunë 59.53% të totalit të primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve.

Shënim: [2] Një nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës kryen edhe veprimtarinë e risigurimit. (SIGAL Uniqa Group Austria sh.a.)
[3] INSIG sh.a. - Shoqëria e vetme me kapital tërësisht shtetëror që ushtron veprimtarinë e sigurimit prej më shumë se 20 vitesh në tregun shqiptar, ushtron veprimtari në klasat e Jo-Jetës dhe Jetës.

**Grafik 2: Struktura e tregut të sigurimeve, 2014**




Gjatë vitit 2014, rritja e tregut të sigurimeve është e ndikuar kryesisht nga dinamika e rritjes së sigurimeve të detyrueshme motorike.

**Tabela 2: Primet e shkruara bruto të sigurimit dhe ndryshimi vjetor, 2012-2014**

| *Veprimtaria* | *Primet e shkruara bruto (mln. lekë)* | | | *Ndryshimi (në %)* | |
|---|---|---|---|---|---|
| | *2012* | *2013* | *2014* | *2013/2012* | *2014/2013* |
| Jeta | 880 | 960 | 1,026 | 9.08 | 6.90 |
| Jo-Jeta | 8,042 | 7,524 | 10,570 | (6.44) | 40.49 |
| Risigurimi | 28 | 54 | 27 | 91.12 | (49.36) |
| **Total** | **8,950** | **8,538** | **11,623** | **(4.61)** | **36.14** |

## Shpërndarja gjeografike e sigurimeve

Duke i hedhur një vështrim volumit të primeve të shkruara bruto, sipas shpërndarjes gjeografike, vihet re një përqendrim i tregut të sigurimeve në prefekturat e mëdha.

Një tregues i rëndësishëm i këtij tregu është primi për frymë, i cili për vitin 2014 është rreth 4,009 lekë për frymë me një rritje prej 1,080 lekë krahasuar me një vit më parë.

Përsa i përket primit për frymë sipas prefekturave, Prefektura e Tiranës me rreth 9,257 lekë për frymë zë vendin e parë e pasuar nga Prefektura Gjirokastër me rreth 3,843 lekë për frymë dhe më tej Durrësi dhe Vlora përkatësisht me rreth 3,306 lekë për frymë dhe 2,424 lekë për frymë

**Shpërndarja e primeve të sigurimit sipas prefekturave**




**Grafik 3: Dëmet e paguara sipas prefekturave, 2014**



## Analiza Financiare

Në zbatim të kuadrit rregullator ekzistues, edhe gjatë vitit 2014, AMF ka mbikëqyrur dhe analizuar tregun e sigurimeve, duke vlerësuar pozicionin financiar, rezultatet dhe treguesit teknikë të veprimtarisë së shoqërive të sigurimit. AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e kërkesës ligjore mbi fondin e garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij. Fondi i garancisë është një shumë në mjete monetare (vlera e së cilës është përcaktuar në Nenin 81 të Ligjit nr. 52/2014) e depozituar nga shoqëria e sigurimit ose e risigurimit në një llogari bankare qëllimore garancie, në bankat në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku shoqëria ka selinë qendrore të saj, e detyrueshme për t'u disponuar nga siguruesi që nga çasti i fillimit të veprimtarisë dhe në vazhdim. Shoqëritë e sigurimit zotërojnë fondin e garancisë të investuar në "depozita qëllimore" me afat 1-vjeçar pranë bankave të nivelit të dytë dhe bono thesari. Totali i fondit të garancisë për tregun është në vlerën 4.72 miliardë lekë më 31.12.2014.

**Tabelë 3: Struktura dhe dinamika e aktivit dhe pasivit të tregut të sigurimeve[4]**

| *Emërtimi* | *31.12.2012* | *31.12.2013* | *31.12.2014* |
|---|---|---|---|
| | | ***struktura (në %)*** | |
| Depozita | 41.38 | 37.81 | 36.26 |
| Toka dhe ndërtime | 9.56 | 9.25 | 7.93 |
| Aksione dhe pjesëmarrje | 12.90 | 12.11 | 10.92 |
| Bono thesari | 6.44 | 7.41 | 10.85 |
| Debitorë | 10.02 | 10.21 | 8.88 |
| Aktive të tjera | 19.70 | 23.22 | 25.16 |
| **Totali i Aktivit** | **100.00** | **100.00** | **100.00** |
| Provigjonet teknike bruto | 40.14 | 41.23 | 45.16 |
| Detyrime të tjera | 9.72 | 13.38 | 13.32 |
| Kapitalet e veta | 50.14 | 45.39 | 41.62 |
| **Totali i Pasivit** | **100.00** | **100.00** | **100.00** |

Shënim: [4] Pasqyrat e bilancit në këtë tabelë përfshijnë shoqëritë e sigurimeve të Jo-Jetës dhe Jetës. Raportimi i pasqyrave financiare të shoqërive të sigurimit bëhet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe mbështetur në bazën ligjore të AMF-së.

| *Emërtimi* | *31.12.2012* | *31.12.2013* | *31.12.2014* |
|---|---|---|---|
| | ***dinamika (në %) viti i mëparshëm = 100*** | | |
| Depozita | 96.43 | 97.94 | 107.20 |
| Toka dhe ndërtime | 109.80 | 103.69 | 95.82 |
| Aksione dhe pjesëmarrje | 101.10 | 100.60 | 100.84 |
| Bono thesari | 140.90 | 123.24 | 163.63 |
| Debitorë | 123.82 | 109.22 | 97.21 |
| Aktive të tjera | 119.86 | 126.32 | 121.09 |
| **Totali i Aktivit** | **106.98** | **107.18** | **111.76** |
| Provigjonet teknike bruto | 108.89 | 110.08 | 122.16 |
| Detyrime të tjera | 133.42 | 147.61 | 111.25 |
| Kapitalet e veta | 101.65 | 97.03 | 102.47 |
| **Totali i Pasivit** | **106.98** | **107.18** | **111.76** |

Nga vlerësimi i situatës financiare të shoqërive të sigurimit, me të dhënat e raportimit financiar të 31.12.2014 u vu re se:

Aktivet e tregut të sigurimeve më 31.12.2014 krahasuar me 31.12.2013, u rritën me 2.61 miliardë lekë ose 11.76%, me një ritëm rritjeje më të lartë krahasuar me vitet e mëparshme. Rritja e aktiveve të tregut reflektohet në rritjen e investimeve likuide si depozita në institucione krediti dhe bono thesari në masën 16.45%. Gjithashtu, rritje kanë pësuar edhe zërat si parapagime e të ardhura të llogaritura, provigjoni teknik i risiguruesit dhe aktive të tjera. Investimet në depozita në institucione krediti dhe bono thesari dominuan në totalin e aktiveve të shoqërive të sigurimit me 47.11%.

Kapitalet e veta për tregun e sigurimeve u rritën me 2.47% krahasuar me 31.12.2013 si rrjedhojë e mbajtjes së fitimit të periudhës. Rritja në detyrimet e tjera në masën 11.25% ose në vlerën 334 milionë lekë krahasuar me 31.12.2013 është kryesisht rezultat i rritjes në kontratat dhe marrëdhëniet e shoqërive të sigurimit me risiguruesit. Ndërkohë, provigjonet teknike bruto në 31.12.2014 janë rritur me 22.16% ose 2.03 miliardë lekë krahasuar me 31.12.2013.

**Tabelë 4: Disa të dhëna mbi tregun e sigurimeve** *(Në mln. lekë)*

| *Periudha Ushtrimore* | | *2010* | *2011* | *2012* | *2013* | *2014* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Totali i aktiveve** | | **18,039** | **19,368** | **20,720** | **22,209** | **24,820** |
| | Jeta | 2,473 | 2,884 | 3,207 | 3,788 | 4,008 |
| | Jo-Jeta | 15,556 | 16,484 | 17,513 | 18,421 | 20,812 |
| **Totali i investimeve** | | **11,855** | **12,839** | **14,209** | **14,672** | **16,589** |
| | Jeta | 1,832 | 1,992 | 1,996 | 2,812 | 3,050 |
| | Jo-Jeta | 10,023 | 10,847 | 12,213 | 11,860 | 13,539 |
| **Provigjonet teknike bruto** | | **6,171** | **7,638** | **8,317** | **9,155** | **11,185** |
| | Jeta | 644 | 853 | 942 | 1,175 | 1,522 |
| | Jo-Jeta | 5,527 | 6,785 | 7,375 | 7,980 | 9,663 |
| **Totali i kapitalit** | | **10,413** | **10,221** | **10,389** | **10,081** | **10,330** |
| | Jeta | 1,764 | 1,791 | 1,899 | 2,195 | 1,988 |
| | Jo-Jeta | 8,649 | 8,430 | 8,490 | 7,886 | 8,342 |
| **Totali i kapitalit të nënshkruar** | | **6,684** | **7,607** | **8,617** | **9,022** | **8,522** |
| | Jeta | 1,278 | 1,283 | 1,284 | 1,351 | 1,355 |
| | Jo-Jeta | 5,406 | 6,324 | 7,333 | 7,671 | 7,167 |
| **Totali i investimeve të huaja** | | **3,587** | **3,472** | **3,597** | **3,435** | **3,619** |
| | Jeta | 347 | 380 | 398 | 458 | 442 |
| | Jo-Jeta | 3,240 | 3,092 | 3,199 | 2,977 | 3,177 |
| **Primi i fituar neto** | | **6,680** | **6,792** | **6,736** | **6,101** | **7,763** |
| | Jeta | 636 | 819 | 823 | 890 | 957 |
| | Jo-Jeta | 6,044 | 5,973 | 5,913 | 5,211 | 6,806 |

Bazuar në sistemin e treguesve të paralajmërimit të hershëm, është vërejtur se:

**Norma e rritjes së primeve**[5] në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës për vitin 2014 është 39.85%. Kjo normë ka pasur një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2013, kur kjo normë ishte negative, në nivelin -6.10%. Ky tregues reflekton rritjen e të ardhurave për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës gjatë vitit 2014 krahasuar me vitin e kaluar, periudhë e cila u karakterizua nga konkurrenca e ashpër që mbizotëroi në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës për produktet e detyrueshme të sigurimit motorik, shoqëruar edhe me rënien e çmimeve gjatë vitit 2013.

**Raporti i mbajtjes neto** në tregun shqiptar të sigurimeve të Jo-Jetës është në masën 78.13%. Ky raport është rritur në krahasim me periudhat paraardhëse, duke qenë brenda kufijve të lejuar.

**Raporti i kombinuar** për tregun shqiptar të sigurimeve të Jo-Jetës është në masën 93.56%, tregues ky i rezultateve financiare pozitive të tregut të Jo-Jetës në aktivitetet operacionale. Ky raport gjatë këtij viti është futur brenda kufijve të lejuar.

**Raporti dëme/prime** për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës në 31.12.2014 ka arritur në 35.75% duke pësuar një rënie në krahasim me vitin e kaluar. Faktorët që kanë ndikuar në uljen e këtij raporti gjatë vitit 2014 është rritja e lartë në volumin e primeve të fituara neto. Në këtë të fundit ka ndikuar rritja e volumit të primeve të shkruara bruto për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës, kryesisht si rezultat i aplikimit të tarifave më të larta në sigurimet e detyrueshme gjatë këtij viti.

**Raporti i shpenzimeve** për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës në 31.12.2014 është në masën 57.81%. Ndonëse ky raport ka pasur një tendencë në rënie gjatë vitit 2014, përsëri tejkalon normat e përcaktuara ndërkombëtare. Peshën më të madhe në strukturën e shpenzimeve të shoqërisë e zënë shpenzimet operative të veprimtarisë, në masën 64.28% për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës. Faktorët që ndikojnë në vlerën në rënie të këtij raporti për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës janë rritja e volumit të primeve të shkruara bruto dhe si pasojë edhe rritja në volumin e primeve të shkruara neto krahasuar me periudhën paraardhëse.

**Raporti i kapitalit ndaj Provigjoneve Teknike,** për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës, ka pasur një tendencë në ulje gjatë vitit 2014. Në 31.12.2014 ky raport është ulur në 43.93%.

Shënim: [5] Kjo normë është llogaritur duke marrë në konsideratë primet e shkruara bruto nga shoqëria Interalbanian VIG sh.a. deri në momentin e përthithjes së saj nga shoqëria Sigma VIG sh.a.

**Tabelë 5: Teste IRIS për tregun e sigurimeve Jo-Jetë** *(Në %)*

| *Raporti* | *31.12.2012* | *31.12.2013* | *31.12.2014* | *Kufiri* | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *MIN* | *MAX* |
| Norma e rritjes së primit | 10.94 | -6.10 | 39.85 | -40 | 40 |
| Raporti i mbajtjes neto | 76.89 | 67.45 | 78.13 | 40 | 80 |
| Raporti dëme/prime neto | 34.27 | 49.87 | 35.75 | 50 | 80 |
| Raporti i shpenzimeve | 62.78 | 79.94 | 57.81 | 25 | 50 |
| Raporti i kombinuar | 97.05 | 129.81 | 93.56 | 85 | 105 |
| Të ardhurat nga investimet | 6.37 | 10.81 | 5.88 | 4 | 8 |
| Raporti operativ | 88.76 | 117.49 | 82.28 | n/a | 100 |
| Raporti i kapitalit | 55.30 | 43.76 | 31.13 | 20 | 50 |
| Raporti i provigjoneve teknike | 73.43 | 52.31 | 43.93 | 10 | 30 |
| Raporti i aftësisë paguese | 346.00 | 290.05 | 196.27 | 150 | 300 |

**Grafik 4: Treguesit IRIS (sipas shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës)** *31.12.2014*









## Inspektimi në shoqëritë e sigurimeve

Në korrik 2014 hyri në fuqi Ligji nr. 52/2014, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", sipas së cilit Autoriteti ushtron funksionet e tij mbikëqyrëse bazuar në legjislacionin në fuqi dhe metodologjinë e re të mbikëqyrjes, atë me fokus rrezikun. Kështu që gjatë vitit 2014 procesi i inspektimeve në vend, në tregun e sigurimeve, u nda në dy periudha.

Gjatë periudhës përpara miratimit të ligjit të ri, AMF ka realizuar 9 inspektime në vend në shoqëritë e sigurimit të Jetës dhe Jo-Jetës, nga të cilat tetë inspektime të planifikuara janë kryer në shoqëritë e sigurimit dhe një inspektim tematik i paplanifikuar tek agjentët. Këto inspektime bazoheshin në metodologjinë tradicionale *(rule-based)*, sipas bazës së mëparshme ligjore. Inspektimet sipas metodologjisë tradicionale të kryera në shoqëritë e sigurimit trajtuan çështje që lidheshin me:

- Verifikimin e disa zërave të pasqyrave financiare (të evidentuara gjatë procesit të analizave financiare të tregut të sigurimeve);
- Analizën e përgjegjësive të kontraktuara nga shoqëritë për vitin e mbyllur financiar;
- Risigurimet dhe pagesat e risiguruesve;
- Praktikat e provigjonimit të kontratave me këste të sigurimit apo risigurimit;
- Procedurat e brendshme të shoqërive të sigurimit lidhur me rakordimet e të dhënave të raportuara në sistemin AMF In-Reg të shitjes së policave të sigurimit dhe regjistrimit të dëmeve për kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik dhe sigurimit vullnetar;
- Verifikimin e efektivitetit dhe sigurisë për sistemet e informacionit.

Në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve, në këto inspektime u verifikuan edhe procedurat e ndjekura nga shoqëritë e sigurimit për trajtimin e dëmeve të paguara dhe atyre të mbetura pezull, kryesisht te dëmet në proces gjyqësor dhe dëmet e refuzuara. Proceset e vlerësimit, administrimit dhe praktikat e provigjonimit të tyre nga shoqëritë e sigurimit vazhdojnë të jenë në fokus të inspektimeve.

Nga inspektimet e kryera në shoqëritë e sigurimit janë evidentuar çështjet e mëposhtme që lidhen me:

- Raportimin e pasaktë dhe jo në kohë reale të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik, në bazën e të dhënave të regjistrit të shitjes *online* në AMF të këtyre policave. Ky fenomen sjell anomali në identifikimin dhe verifikimin e policave të shitura në sistemin e shitjeve *online* në AMF, në rastet e kërkesës për konfirmim të vlefshmërisë së këtyre policave;
- Administrimin e rreziqeve të kontraktuara nga shoqëritë e sigurimit;
- Trajtimin jo të drejtë dhe përtej afateve kohore të palës së dëmtuar në rast të ndodhjes së dëmit, duke cenuar vlerën e dëmshpërblimit që i takon kësaj pale sipas kërkesave ligjore në fuqi;
- Provigjonimin jo të saktë të dëmeve, veçanërisht të atyre që janë në proces gjyqësor;
- Mosrespektimin e të gjitha kërkesave të përcaktuara në vendimet e Bordit të AMF-së, që lidhen me marrjen e masave korrigjuese nga inspektimi mbi dëmet në shoqëritë e sigurimit;
- Transaksionet financiare me palë të lidhura.

AMF u ka komunikuar shoqërive të sigurimit gjetjet dhe rekomandimet përkatëse të inspektimit nëpërmjet raportit në formën e "Letrës për drejtuesit", duke vendosur edhe afate kohore për zbatimin e rekomandimeve të lëna në këtë raport. Zbatimi i këtyre rekomandimeve ndiqet në vijimësi nga Autoriteti në inspektimet dhe raportimet e ardhshme financiare.

Inspektimi tematik tek agjentët konsistoi në verifikimin në vend të të dhënave të policave të sigurimit TPL të shitura dhe të raportuara në sistemin e shitjeve *online* në AMF, duke përfshirë këtu edhe të dhënat e transaksioneve bankare të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik të shitura dhe të raportuara në AMF. Nga ky inspektim rezultuan çështje të raportimit të pasaktë dhe jo në kohë reale në regjistrin e shitjeve *online* të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik, të kodit të raportimit të AMF-së dhe kodit të transaksionit bankar të policës fizike të sigurimit TPL.

Shoqëria përkatëse e sigurimit i reflektoi brenda afateve kohore, rekomandimet e dhëna nga Autoriteti duke raportuar saktë, në vijimësi dhe në kohë reale informacionin në regjistrin e shitjeve *online* të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik.

## Mbikëqyrja me bazë rrezikun

Për zbatimin e metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus rrezikun, Bordi i AMF-së me Vendimin nr. 137, datë 31.10.2014, miratoi Manualin e Mbikëqyrjes së shoqërive të sigurimit, objektivi i të cilit është që të krijojë një pikë referimi të rëndësishme për AMF. Ky manual nga ana tjetër nuk synon dhënien e të gjitha zgjidhjeve të gatshme që t'i përshtaten të gjitha çështjeve të përditshme që do të hasen në mbikëqyrjen e siguruesve në Shqipëri. Gjatë zbatimit të kësaj metodologjie mbeten në fokus konceptet themelore dhe parimet bazë në mbikëqyrjen e sigurimeve.

Në nëntor 2014, AMF nisi inspektimin në vend në një nga shoqëritë e sigurimit sipas metodologjisë së re me fokus rrezikun. Ky inspektim për vetë specifikën e tij u shtri edhe gjatë muajve të parë të vitit 2015. Në kryerjen e këtij inspektimi, specialistët e mbikëqyrjes së AMF-së u asistuan edhe nga ekspertë të huaj të fushës së mbikëqyrjes së sigurimeve, në kuadrin e një projekti me mbështetjen e FSVC. Ata ishin pjesërisht të pranishëm gjatë inspektimit në shoqëri duke dhënë eksperiencën e tyre të gjatë në mbikëqyrjen me fokus rrezikun. Ata u përqendruan në strukturimin e procedurave të inspektimit dhe hartimin e planit të intervistave me të gjitha nivelet e menaxhimit të shoqërisë. Gjatë inspektimit u diskutua lidhur me rreziqet e pranishme në shoqëri sipas aktiviteteve të biznesit, si edhe administrimin e tyre nga drejtuesit e lartë të shoqërisë.

Objekti i këtij inspektimi u përqendrua në:

- Vlerësimin e rrezikut të kreditit në marrëdhënie me risiguruesit, mbledhjen e primeve dhe të tjera aktivitete të lidhura me to;
- Vlerësimin e rrezikut të sigurimit, duke u përqendruar kryesisht tek marrja në sigurim dhe risqet e përgjegjësive, si edhe të tjera aktivitete të lidhura me to;
- Vlerësimin e rrezikut operacional, duke u përqendruar tek provigjonet, vlerësimi i dëmeve, procedurat e trajtimit të dëmeve, sistemet e teknologjisë së informacionit, performanca operacionale, si edhe të tjera aktivitete të lidhura me to;
- Vlerësimin e rrezikut rregullator dhe strategjik, në drejtim të vlerësimit të Fondit të Garancisë;
- Vlerësimin e fuqisë së kapitalit dhe cilësisë së fitimeve;
- Vlerësimin e elementëve të veçantë të aktiveve të pasqyrave financiare të shoqërisë;
- Administrimin e rrezikut, sistemet e kontrollit të brendshëm, përfshirë edhe mbikëqyrjen nga drejtimi të veprimtarisë së shoqërisë.

Në fund të këtij procesi, Autoriteti hartoi profilin e rrezikut për këtë shoqëri, që përfaqëson vlerësimin e tij për secilin nga rreziqet e shoqërisë, brenda kontekstit të sektorit të sigurimeve në përgjithësi. Qëllimi i këtij inspektimi sipas metodologjisë me fokus rrezikun

e përqendron përgjegjësinë në ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit financiar të shoqërisë së sigurimit aty ku duhet – tek këshilli mbikëqyrës dhe menaxhimi i lartë i saj. Ndërkohë që detyrë e shoqërisë së sigurimit është t'i përmbahet politikave dhe praktikave të përshtatshme për administrimin e rrezikut, për të zbutur rreziqet e konsiderueshme që shoqërojnë biznesin.

Ky proces do të zbatohet për të gjitha shoqëritë e tregut të sigurimeve, duke krijuar kështu një bazë të dhënash në nivel tregu, e cila ndihmon në vlerësimin e rrezikut të secilës shoqëri sigurimi.

Zbatimi i kësaj metodologjie është një sfidë e madhe jo vetëm për tregun e sigurimeve, por edhe për Autoritetin dhe punonjësit e tij të mbikëqyrjes. Kjo pasi krahasuar me qasjen tradicionale, mbikëqyrja me fokus rrezikun kërkon që mbikëqyrësi të kuptojë shumë mirë konceptet financiare, të ketë njohuri të thella për operacionet e siguruesit, të kuptojë shumë mirë rreziqet e biznesit dhe sigurimit. Njëkohësisht ajo kërkon që mbikëqyrësi dhe ekipi drejtues i shoqërive të mbikëqyrura, të koordinojnë operacionet e biznesit dhe planet e ardhshme, meqenëse këta janë drejtuesit, vendimet e të cilëve do të ndikojnë në rezultatin e ardhshëm të kësaj shoqërie.

**Inspektime të përbashkëta për mbikëqyrje të konsoliduar të tregjeve financiare**

Në kuadër të bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë, dhe në zbatim të rekomandimeve të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP) për një mbikëqyrje të konsoliduar të tregjeve financiare, AMF ka kryer gjatë vitit 2014, tre inspektime të përbashkëta në bankat e nivelit të dytë. Fokusi i AMF-së në inspektimet e përbashkëta për tregun e sigurimeve ishin verifikimet lidhur me:

- Ekspozimin agregat të shoqërive të sigurimit për produktet e sigurimit të garancive bankare;
- Depozitat, kreditë e marra nga shoqëritë e sigurimit pranë bankave të nivelit të dytë, si edhe kolateralet e garantuara prej tyre;
- Verifikimin e praktikave të dëmeve pezull që rrjedhin nga të gjitha llojet e policave të sigurimit me përfitues bankat.

Inspektime të përbashkëta u kryen edhe për tregjet e tjera nën mbikëqyrjen e AMF-së që pasqyrohen në kapitujt përkatës.

## Provigjonet Teknike

Në kuadrin e analizës financiare, AMF vlerëson nëse provigjonet teknike janë të mjaftueshme dhe në përputhje me nivelin e rrezikut të kontraktuar nga shoqëritë. Mjaftueshmëria e provigjoneve teknike, vlerësohet në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe mospërmbushja e këtij detyrimi përbën shkelje të rregullave të administrimit të rrezikut.

Ecuria në nivel tregu e provigjoneve teknike, ndër vite, shfaq një tendencë në rritje. Peshën më të lartë nga pikëpamja e veprimtarisë së ushtruar e mbajnë provigjonet teknike bruto të shoqërive të Jo-Jetës, duke reflektuar edhe strukturën e tregut të sigurimeve në Shqipëri.

### Provigjoni Teknik

Provigjoni teknik është shuma e llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas mënyrave aktuariale të caktuara, e cila mbahet nga siguruesi, për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit. Provigjonet teknike, mbështetur edhe në Ligjin e ri nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", përfshijnë:

- Provigjonet për prime, të cilat përbëhen nga provigjonet për primet e pafituara dhe për rreziqe të paskaduara. Këto provigjone krijohen në përpjesëtim me primet e shkruara që lidhen me mbulimet e sigurimit, të cilat janë ende të vlefshme pas përfundimit të periudhës financiare gjatë së cilës janë krijuar këto provigjone;
- Provigjonet për bonuse dhe rabate, të cilat krijohen në nivel të njëjtë me shumën e pagesave që merr i siguruari bazuar në të drejtën për përfitimet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, të drejtën për reduktim të pjesshëm të primit të sigurimit (rabat) si dhe të drejtën e rimbursimit të një pjese të primit të sigurimit në rast të përfundimit të parakohshëm të kontratës së sigurimit;
- Provigjonet teknike të dëmeve, të cilat krijohen në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit para përfundimit të periudhës së sigurimit të kontratës së sigurimit dhe vlerësimi i tyre bëhet në nivel të njëjtë me përgjegjësitë e marra përsipër nga shoqëria e sigurimit nëpërmjet kontratës së sigurimit;
- Provigjone për mbrojtjen për rrezikun ndaj investimit;
- Provigjone të tjera teknike. Këto provigjone krijohen nga shoqëritë e sigurimit me qëllim për të mbuluar përgjegjësitë e pritshme dhe rreziqet për dëme të mëdha, të cilat rrjedhin nga sigurimi i përgjegjësisë për humbje nga rreziqe bërthamore, përgjegjësinë e prodhuesit të produkteve farmaceutike si dhe rreziqet e përmbytjes dhe tërmetit.

Provigjonet matematike krijohen në nivel të njëjtë me vlerën aktuale të detyrimeve të ardhshme që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të Jetës, duke zbritur vlerën aktuale të parashikuar për primet e ardhshme për t`u paguar sipas kontratës.

Nga të dhënat në nivel tregu, të pasqyruara në grafikun e mëposhtëm, vihet re tendenca në rritje e treguesit të provigjonit teknik të dëmeve dhe primeve, duke reflektuar edhe përpjekjet e vazhdueshme të Autoritetit në drejtim të përmirësimit të këtij treguesi. AMF në mënyrë të vazhdueshme ka dhënë rekomandime për përmirësimin në rritje të treguesit të provigjonit teknik të dëmeve në përputhje me rritjen e aktivitetit të tregut të sigurimeve. Këto rekomandime janë bazuar në analizat e të dhënave të shoqërive të sigurimit, në gjetjet e konstatuara gjatë inspektimeve në vend, si dhe nga informacioni i marrë nga palë të treta (gjykatat për dëmet në proces gjyqësor) lidhur me detyrimet dhe rrezikun ndaj të cilit janë të ekspozuara shoqëritë.

**Grafik 5: Provigjoni Teknik Bruto** *(Në mln. lekë)*




Të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm tregojnë gjithashtu se peshën më të lartë nga komponentët e këtij treguesi e përbën provigjoni teknik bruto nga aktiviteti i Jo-Jetës, në linjë dhe me zhvillimin aktual të tregut të sigurimeve në Shqipëri.

## Sigurimi i Detyrueshëm Motorik

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë vitit 2014, shënoi rritje të primeve të shkruara bruto me rreth 78.97% krahasuar me vitin 2013, duke vazhduar të zërë peshën kryesore në këtë treg. Sigurimi i detyrueshëm motorik solli pjesën më të madhe të të ardhurave, ose 65.46% të totalit të primeve të shkruara bruto të sigurimeve të Jo-Jetës.

**Grafik 6: Struktura e primeve të shkruara bruto të tregut të Jo-Jetës, 2014** *(Në mln. lekë)*




Efekti i ndryshimit të MTPL së brendshme, me një rritje prej 88.83% të volumit të primeve të shkruara bruto krahasuar me vitin 2013, ka qenë përcaktues për këtë hop të madh në rritje të sigurimi motorik.

**Grafik 7: Sigurimi motorik, primet e shkruara bruto 2005-2014** *(Në mln. lekë)*




Nga krahasimi i të dhënave të primit mesatar për sigurimin e detyrueshëm motorik me vendet e tjera të rajonit, Shqipëria ka një nivel primi që është ndër më të ultët në rajon.

**Grafik 8: Primi mesatar i sigurimit të detyrueshëm motorik[6]** *(Në euro)*




## Dëmet

Gjatë vitit 2014, shoqëritë e sigurimeve paguan rreth 2.84 miliardë lekë dëme[7], ose rreth 5.29% më shumë se në vitin 2013. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimeve motorike me rreth 2.30 miliardë lekë, apo 81.02% të totalit.

**Grafik 9: Dëmet e paguara bruto të sigurimit të detyrueshëm motorik** *(Në mln. lekë)*




Shënim: [6]Të dhënat janë marrë nga faqja online www.xprimm.com
[7]Të dhënat e dëmeve të paguara bruto janë të dhëna statistikore, ku përfshihen edhe të dhënat e dëmeve të paguara bruto për shoqërinë Interalbanian Vienna Insurance Group sh.a. deri në momentin e përthithjes nga Shoqëria Sigma Vienna Insurance Group sh.a.

## Byroja Shqiptare e Sigurimeve (BSHS)

AMF, edhe gjatë vitit 2014, ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e detyrimeve të BSHS, lidhur me zbatimin e Marrëveshjes Uniforme dhe të Rregullores së Brendshme të Këshillit të Byrove.

Gjatë vitit 2014, nuk ka pasur të raportuar asnjë Thirrje Garancie për Byronë Shqiptare të Sigurimit, nga byrotë homologe pranë Këshillit të Byrove.

### Byroja Shqiptare e Sigurimeve

BSHS është person juridik, e krijuar jo për qëllime fitimi, në përbërje të së cilës në fund të viti 2014 ishin anëtarë 8 shoqëri sigurimi. Byroja është përfaqësuese kombëtare në Këshillin e Byrove (Shoqata Ndërkombëtare e Byrove Kombëtare të Siguruesve Motorik) dhe është përgjegjëse për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia në sistemin e Kartonit Jeshil.

Objekt i veprimtarisë së Byrosë është përmbushja e funksioneve, detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga dispozitat e Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", Ligjit 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime, "Rregullorja e brendshme e Këshillit të Byrove" dhe Statuti i saj.

Autoriteti, në funksion të mbikëqyrjes së BSHS dhe me qëllim mbrojtjen e interesave të konsumatorit, ka ndjekur me përparësi detyrimet e shoqërive të sigurimit ndaj Byrosë për financimin e Fondit të Kompensimit (FK) dhe kryerjen e pagesave të dëmeve objekt i këtij Fondi.

### Fondi i Kompensimit

Qëllimi për krijimin dhe mbajtjen e FK-së është pagesa e dëmeve pasurore dhe jopasurore të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, në rastet e dëmeve të shkaktuara nga përdorimi i një mjeti të pasiguruar, të paidentifikuar dhe në rastet e mbylljes apo falimentimit të një shoqërie sigurimi. Burimet e financimit të Fondit të Kompensimit parashikohen në nenin 45 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 dhe krijohen nga:

- Kontributi i përvitshëm i shoqërive të sigurimit, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimin e detyrueshëm motorik, (i financuar në përpjesëtim të drejtë me primet bruto, të shkruara në këto lloj sigurimesh, në vitin paraardhës);
- Arkëtime nga rimbursimi i shumave nga personat përgjegjës për dëmet te Byroja;
- Gjobat e vëna pronarit të mjetit të transportit të cilët nuk kanë lidhur kontratat e sigurimit të detyrueshëm;
- Burime të tjera të cilat nuk ndalohen me ligj.

**Grafik 10: Fondi i Kompensimit i miratuar nga AMF për vitet 2010-2014** *(Në mln. lekë)*




Nisur nga situata e detyrimeve të Fondit të Kompensimit për periudhat që prej vitit 2001, AMF në shkurt të vitit 2014, ka miratuar Fondin e Kompensimit në masën 450 milionë lekë, të ndarë përkatësisht:

- Fond për shlyerjen e detyrimeve për dëme pezull deri më 31.12.2013, në vlerën 430 milionë lekë;
- Fond për pagesat e dëmeve për vitin 2014, në vlerën 20 milionë lekë.

Totali i detyrimeve për pagesat e dëmeve pezull nga Fondi i Kompensimit deri më 31.12.2013 ishte në vlerën rreth 1,348,126,732 lekë, dhe ky detyrim sipas vendimit të mësipërm do të shlyhet brenda tre viteve si më poshtë:

Viti 2014 – 430,000,000 lekë

Viti 2015 – 450,000,000 lekë

Viti 2016 – 468,126,732 lekë

Bordi i Autoritetit çdo muaj është informuar lidhur me situatën e pagesave të praktikave objekt i Fondit të Kompensimit. Autoriteti ka monitoruar nivelin e pagesave, duke përcjellë pranë çdo shoqërie kërkesën për vijimin me ritme të shpejta të këtij procesi.

Sipas informacionit të marrë nga Byroja Shqiptare e Sigurimit, pagesat e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit nga shoqëritë e sigurimit, gjatë vitit 2014, janë realizuar në masën 105%, duke përmbushur kështu detyrimin për pagesat e dëmeve sipas vendimeve të Bordit të AMF-së.

### Mbi zbatimin e masave stabilizuese në tregun e sigurimeve

Paketa e masave stabilizuese e miratuar për tregun e sigurimeve përfshin:

- Rivendosjen e menjëhershme të financimit të Fondit të Kompensimit duke i kërkuar shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës të financojnë detyrimet e papaguara;
- Vendosjen e kërkesave ligjore për mbajtjen dhe financimin e një rezerve monetare në llogari qëllimore që do të përdoret vetëm për pagesat e dëmeve të produktit MTPL.

Gjatë vitit 2014 është ndjekur pagesa e detyrimeve të papaguara nga Fondi i Kompensimit dhe raportimi i tyre në pasqyrat financiare sipas detyrimeve për secilën nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës përcaktuar me Vendim Bordi nr. 17 datë 28.2.2014.

Gjithashtu, në lidhje me përcaktimin e rregullave për pagesën nga rezerva monetare të dëmeve që mbulohen nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit, gjatë vitit 2014 është përgatitur Rregullorja miratuar me Vendim Bordi nr. 18 datë 10.03.2014. Departamenti i Mbikëqyrjes ka ndjekur me frekuencë mujore raportimin e zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës.

### Provigjoni teknik bruto për sigurimin e detyrueshëm motorik

Provigjoni teknik bruto për produktin e MTPL zë peshën më të madhe specifike në totalin e provigjoneve teknike të tregut të Jo-Jetës. Për 31.12.2014 ky tregues paraqitet në rritje krahasuar me fund vitin e kaluar, në 79% të totalit të provigjonit teknik bruto.

**Tabelë 6: Provigjoni teknik i sigurimit të detyrueshëm**

| *Emërtimi* | *31.12.2012* | *31.12.2013* | *31.12.2014* |
|---|---|---|---|
| Provigjone Teknike Bruto, MTPL *(në mln. lekë)* | 4,903 | 5,876 | 7,606 |
| Provigjone Teknike Bruto, Jo-Jetë *(në mln. lekë)* | 7,375 | 7,980 | 9,663 |
| **Raporti i provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm ndaj totalit të provigjoneve teknike të tregut** *(në %)* | **66** | **74** | **79** |

**Tabelë 7: Struktura e provigjonit teknik bruto** *(Në %)*

| *Emërtimi* | *2011* | *2012* | *2013* | *2014* |
|---|---|---|---|---|
| Provigjoni Teknik Bruto - Dëme MTPL | 62 | 56 | 52 | 53 |
| Provigjoni Teknik Bruto - Primi i Pafituar MTPL | 38 | 44 | 48 | 47 |
| Provigjone Teknike Bruto - MTPL | 100 | 100 | 100 | 100 |

## Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik

Ruajtja e infrastrukturës së shërbimeve dhe pasurimi i sistemeve informatike të teknologjisë së informacionit (TI) me elementë të rinj kanë qenë gjithnjë ndër synimet kryesore të AMF-së, duke i shërbyer mbikëqyrjes dhe analizës sa më efektive të tregut. Kështu në vazhdimësi të bashkëpunimit me BB, në kuadër të projektit mbi Liberalizimin e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në Shqipëri, *(The Road Ahead for Albanian Motor TPL Market)* pranë Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik edhe gjatë vitit 2014 ka vazhduar integrimi me sistemin bankar i regjistrit të policave. Integrimi me sistemet bankare mundëson zhvillimin dhe kontrollin e tregut të sigurimeve motorike dhe jep mundësinë e krijimit të standardeve në veprimet financiare që nga lëshimi i policave të sigurimit të detyrueshëm motorik e deri në pagesën e dëmeve si rrjedhojë e tyre.

Në Qendrën e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, gjatë viti 2014, përfundoi zbatimi teknik i sistemit *Bonus-Malus.* Ky sistem bën të mundur tarifimin me fokus rrezikun në sigurimin motorik. Sistemi mundëson edhe integrimin e lidhjes me regjistrin e automjeteve nga i cili shoqëritë e sigurimit mund të marrin të dhënat e mjetit, të cilat e vendosin atë në një kategori të caktuar e cila nuk mund të ndryshohet. Kjo kufizon mundësitë e abuzimeve dhe gabimeve duke përmirësuar procesin e lëshimit të policës. Në fund të vitit 2014 është përfunduar teknikisht dhe integrimi i lidhjes me regjistrin e gjendjes civile, i cili garanton saktësinë e të dhënave të pronarit-drejtues të automjetit, numrit të tij personal i cili do të jetë çelës në kërkimin e historikut të *Bonus-Malus.*

## Sistemi Bonus-Malus

Sistemi *Bonus-Malus* prezanton një skemë universale të vlerësimit të tarifës për policat e sigurimit të detyrueshëm motorik, ku për çdo rinovim të policës së sigurimit, për cilindo të siguruar, në varësi të dëmeve të ndodhura gjatë periudhës së mëparshme të sigurimit, përllogaritet koeficienti që do të aplikohet mbi tarifën bazë të sigurimit. Ky koeficient do të ndikojë në rritjen ose uljen e vlerës së tarifës së sigurimit, respektivisht nëse i siguruari ka bërë dëme ose jo gjatë periudhës së siguruar.

AMF përfundoi integrimin e sistemit të regjistrimit të automjeteve që mundësojnë tarifimin me bazë rreziku. Aktualisht agjentët e shitjeve të policave të sigurimit mund të kërkojnë të dhëna mbi automjetin dhe pronarin e automjetit nëpërmjet targës dhe numrit të shasisë. Në këtë fazë, përveç të dhënave të mësipërme të automjetit, sistemi gjeneron dhe dërgon edhe të dhëna rreth kategorisë së automjetit sipas informacionit bazuar në Regjistrin Kombëtar të Automjeteve, por agjentët nuk kanë të drejtë t'i ndryshojnë të dhënat duke parandaluar në këtë mënyrë abuzime të ndryshme.

Një fazë tjetër e cila ka përfunduar është integrimi në kohë reale me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile i cili ofron numrin personal të pronarit të mjetit si çelës për kërkimin e historikut *Bonus-Malus* dhe kategorizimin e saktë të pronarëve në nivelet e rrezikut. Kompanitë e sigurimit janë duke e përdorur këtë integrim i cili është bërë funksional prej datës 3 mars 2015.

Me përfundimin e dy fazave sistemi është plotësisht funksional dhe parametrat e rrezikut, që janë numri i dëmeve dhe numri i viteve të plota TPL dërgohen drejt sistemeve të shoqërive të sigurimit duke bërë të mundur tarifimin me bazë rreziku.

**Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik**, përbën infrastrukturën bazë për zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemit *Bonus-Malus*. Ajo administrohet nga AMF dhe përbëhet nga:

- Regjistri Elektronik *Online* i Shitjeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike, i cili është një platformë raportimi dhe identifikimi në kohë reale të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik në formën e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, Kartonit Jeshil dhe Sigurimit Kufitar.
- Regjistri i Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike, i cili është një platformë raportimi e dëmeve të ndodhura në kuadër të sigurimeve të detyrueshme motorike.

Gjithashtu, sistemet e TI në AMF janë në bashkëveprim të vazhdueshëm me këto sisteme pranë shoqërive të sigurimit për të parë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e manualit të mbikëqyrjes lidhur me sistemet TI të tregut të sigurimeve.

## Sistemi i Administrimit të Informacionit

AMF dhe shoqëritë e sigurimeve që veprojnë në treg kanë në përdorim të vazhdueshëm sistemin "AMF In-Reg" i cili përbëhet nga një platformë raportimi online, nëpërmjet së cilës operatorët e subjekteve të mbikëqyrura raportojnë të dhënat e kërkuara nga Autoriteti në mënyrë elektronike nëpërmjet internetit.



Gjatë vitit 2014, AMF ka saktësuar mënyrat e funksionimit dhe ka punuar në ndërtimin e pjesëve të reja të sistemit. Kështu, janë plotësuar formatet e raportimit për subjektet e mbikëqyrura, si edhe janë ndërtuar raporte të reja analitike bazuar në të dhënat e mbledhura në sistem nga shoqëritë.

## Licencime në tregun e sigurimeve

Dinamika e shpejtë e zhvillimeve që tregoi tregu i sigurimeve, gjatë vitit 2014 janë reflektuar edhe në ndryshime në numrin e subjekteve që veprojnë në këtë treg.

### Ndërmjetësimi në sigurime

Në procesin licencues të ndërmjetësve në sigurime, AMF në vazhdimësi është kujdesur që kërkesat dhe procedurat e zbatuara për subjektet që kërkojnë të ushtrojnë aktivitet në fushën e ndërmjetësimit të jenë të qarta, objektive dhe transparente. Veprimtaria e ndërmjetësimit në sigurime ushtrohet nga agjentë ose shoqëri agjentësh, brokera dhe shoqëri brokerimi.

### Broker në sigurime

Zhvillimet në tregun e sigurimeve dhe nevoja për mbrojtjen e interesave të bizneseve dhe individëve në procesin sigurues kanë rritur interesin e subjekteve për licencim në tregun e ndërmjetësimit, veçanërisht në atë të brokerimit.

Gjatë vitit 2014, Autoriteti miratoi licencimin e një subjekti të ri për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në sigurime dhe risigurime, për klasat e Jo-Jetës dhe Jetës. Ndërkohë, numri i brokerave fizikë u rrit në 14 në fund të vitit 2014, nga 13 që ishte në fund të vitit 2013.

**Tabelë 8: Të dhëna mbi brokera të licencuar në sigurime** *(Në numër)*

| *Statusi i brokerit* | *Të licencuar në fund të vitit 2013* | *Licenca të reja në 2014* | *Rinovim licence në 2014* | *Tërhequr licenca në 2014* | *Të licencuar[8] në fund të vitit 2014* |
|---|---|---|---|---|---|
| *Shoqëri brokerimi* | 8 | 1 | - | 1 | 8 |
| *Broker fizikë* | 13 | 1 | - | - | 14 |

Sipas llojit të licencës, shoqëritë e brokerimit klasifikohen si më poshtë:

**Tabelë 9: Shoqëri brokerimi sipas produkteve të sigurimit** *(Në numër)*

| | *2009* | *2010* | *2011* | *2012* | *2013* | *2014* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *Shoqëri brokerimi Jo-Jetë* | 3 | 7 | 5 | 5 | 5 | 4 |
| *Shoqëri brokerimi Jetë dhe Jo-Jetë* | - | - | - | 1 | 2 | 2 |
| *Shoqëri brokerimi Jetë, Jo-Jetë dhe Risigurimi* | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 2 |
| ***Totali*** | **4** | **8** | **6** | **7** | **8** | **8** |

Veprimtaria e shoqërive të brokerimit konsiston në ndërmjetësimin e produkteve të sigurimit të Jetës ashtu dhe të Jo-Jetës si: *Shëndeti në Udhëtim, Garanci Oferte dhe Kontratë, Kasko, TPL, Karton Jeshil, Sigurimi Kufitar, Sigurimi i karburanteve, Sigurimi nga zjarri, Sigurimi CAR dhe Sigurimi i Jetës me Kursim, Sigurim prone për kredi*, etj.

Nga raportimet e shoqërive të brokerimit mbi të dhënat statistikore për veprimtarinë që ato kryejnë, rezulton se në fund të nëntëmujorit të vitit 2014, totali i primeve bruto të tregut të sigurimeve që shiten me ndërmjetësimin e brokerave është rreth 48.51% e primeve totale të tregut. Rritja e nivelit të ndërmjetësimit në vitin 2014 në krahasim me vitet e tjera është rezultat i shitjes me ndërmjetësim të produkteve të sigurimit të detyrueshëm motorik.

Shënim: [8]Numri gjithsej i brokerëve të licencuar në fund të vitit 2014 llogaritet si shumë e brokerave të licencuar në fund të vitit 2013 + licenca të reja në 2014 + rinovim licence në 2014 – licencat që u ka përfunduar afati në fund të vitit 2014.

## Agjentë në sigurime

Gjatë vitit 2014 vazhdoi licencimi i personave fizikë për ushtrimin e veprimtarisë si agjentë në sigurime të Jo-Jetës në emër dhe për llogari të dy shoqërive të sigurimit: shoqërisë "Insig" sh.a. dhe "Sigal Uniqa Group Austria" sh.a.

**Tabelë 10: Të dhëna mbi agjentët e licencuar** *(Në numër)*

| Statusi i agjentit | Të licencuar në fund të vitit 2013 | Rinovim licence 2014 | Licenca të reja 2014 | Përfunduar afati i licencës 2014 | Tërheqje licence 2014 | Të licencuar[9] në fund të vitit 2014 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Persona juridikë | 3 | 1 | - | 1 | - | 3 |
| Persona fizikë | 315 | 95 | 55 | 161 | 4 | 300 |

## Vlerësuesit e dëmeve në sigurime

Gjatë vitit 2014, AMF licencoi 9 vlerësues të tjerë të dëmeve në sigurime, si edhe rinovoi 18 licenca ekzistuese.

**Tabelë 11: Të dhëna mbi vlerësuesit e licencuar, sipas llojit të licencës dhe statusit** *(Në numër)*

| Vlerësues dëmesh në sigurime | Të licencuar në fund të vitit 2013 | Licencime të reja 2014 | Rinovim Licence 2014 | Përfunduar afati i licencës 2014 | Të licencuar 2014 |
|---|---|---|---|---|---|
| Sipas statusit të vlerësuesit | | | | | |
| I pavarur | 20 | 7 | 7 | 3 | 31 |
| I punësuar | 24 | 1 | 11 | 7 | 29 |
| Licenca jo aktive | 5 | 1 | - | 1 | 5 |
| Sipas llojit të licencës | | | | | |
| Për dëme materiale | 6 | - | - | - | 6 |
| Për dëme shëndetësore | 6 | 1 | 3 | 1 | 9 |
| Për dëme materiale dhe shëndetësore | 37 | 8 | 15 | 10 | 50 |
| **Gjithsej vlerësues të licencuar** | **49** | **9** | **18** | **11** | **65** |

Shënim: [9]Numri gjithsej i agjentëve të licencuar në fund të vitit 2014 llogaritet si shumë e agjentëve të licencuar në fund të vitit 2013 + licenca të reja në 2014 + rinovim licence në 2014 – licencat që u ka përfunduar afati në fund të vitit 2014 – tërheqjet e licencave.

## Risigurimet

Bazuar në kuadrin ligjor, shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të risigurojnë në një shoqëri risigurimi pjesën e rrezikut të siguruar që tejkalon limitin e lejuar. Kjo lidhet me ato kontrata sigurimi, vlera e rreziqeve të së cilave tejkalon mbulimin maksimal, prej 10% të vlerës së kapitalit.

Shoqëritë e sigurimit, edhe gjatë vitit 2014, kanë kontraktuar rreziqe të cilat i përkasin produkteve të sigurimit vullnetar dhe sigurimit të detyrueshëm motorik për automjetet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si edhe në vendet e tjera anëtare të sistemit të Kartonit Jeshil. Për portofole të veçanta sigurimi, shoqëritë kanë kryer transferim të rrezikut me kontrata risigurimi për të zbutur efektet financiare të dëmeve të mundshme. Ky transferim është realizuar nëpërmjet bashkësigurimit (kalimit të një pjese të rrezikut të kontratës së sigurimit në një shoqëri tjetër sigurimi), kalimit në risigurim të portofoleve të sigurimit në tërësi dhe mbulimit me risigurim fakultativ për kontrata të veçanta.

Në bazë të kërkesave rregullatore, shoqëritë e sigurimit, raportojnë në Autoritet programin e risigurimit. Bazuar në funksionin e saj mbikëqyrës, AMF ndjek ecurinë e zbatimit të këtij programi dhe kontratave specifike të lidhura, duke synuar të sigurojë stabilitetin e vazhdueshëm financiarnë lidhje me standardet e mbajtjes së rrezikut nga këto shoqëri sigurimi dhe kritereve të lidhura me cilësinë e risiguruesve.

### Risigurimi Fakultativ

Risigurimi Fakultativ nënkupton transferimin e një pjese të një rreziku të veçantë të siguruar nga shoqëria e sigurimit, te shoqëria e risiguri mit sipas një kontrate të veçantë të risigurimit.

Marrëveshjet risiguruese në portofolet e sigurimit të Jo-Jetës kanë qenë të formës jo proporcionale të tipit *Excess of Loss* (Tejkalim Humbje) dhe të formës proporcionale të tipit *Quota Share e Surplus*. Në sigurimin e Jetës, mbulimi me risigurim është kryer nëpërmjet marrëveshjeve risiguruese të formës proporcionale të tipit *Surplus* dhe të tipit *Quota Share.*

Primet e ceduara në risigurim për vitin 2014 rezultojnë:

- Për totalin e tregut të sigurimeve në masën në masën e 21.34% e vlerës së primeve të shkruara bruto;
- Për sigurimin e Jo-Jetës në masën e 21.87% e vlerës së primeve të shkruara bruto;
- Për sigurimin e Jetës në masën e 2.92% e vlerës së primeve të shkruara bruto.

Ecuria e raportit të primeve të ceduara në risigurim mbi primet e shkruara bruto gjatë viteve 2011-2014 jepet si më poshtë:

**Grafik 11: Primi i ceduar në risigurim/prime të shkruara bruto, totali i tregut** *(Në %)*




**Grafik 12: Primi i ceduar në risigurim/prime të shkruara bruto, Jo-Jeta** *(Në %)*



**Grafik 13: Primi i ceduar në risigurim/prime të shkruara bruto, Jeta** *(Në %)*




Ndër pjesëmarrësit kryesorë në programet e risigurimit, gjatë vitit 2014 për sigurimin e Jo-Jetës mund të përmendim VIG Re, UNIQA Re, Munich Re, Hannover Re, Swiss Re, Partner Re, Scor, Lloyd's Syndicates, etj. Për sigurimin e Jetës, shoqëria e vetme risiguruese e përfshirë në këtë program është Scor Global Life. Më shumë se 90% e partnerëve risigurues të shoqërive të sigurimit kanë klasifikim më të lartë se BB- nga Standard & Poors, nga ku mbi 50% kanë klasifikim më të lartë se A.

## 1.3 Tregu i Letrave me Vlerë

### Fondet e Investimeve

Tregu i sipërmarrjeve të investimeve kolektive, gjatë vitit 2014, ka pësuar rritje. Në këtë treg ushtrojnë aktivitetin e tyre dy fonde investimi, përkatësisht Fondi i Investimeve "Raiffeisen Prestigj" i licencuar më datë 13.12.2011 dhe Fondi i Investimeve "Raiffeisen Invest Euro" i licencuar më datë 26.09.2012, të cilat administrohen nga shoqëria "Raiffeisen Invest".

Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 31.12.2014, vlera neto e aseteve të tyre arriti në rreth 63.74 miliardë lekë me një rritje prej 13.41 miliardë lekë ose 26.64% krahasuar me 31.12.2013.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në obligacione qeveritare të cilat përbëjnë 78.85% të aseteve të fondeve. Ndërkohë, numri i anëtarëve që kanë investuar në fondet e investimit më 31.12.2014 është 32,669, me një rritje prej 14.94% krahasuar me 31.12.2013. Nga anëtarët në fond, rreth 99.97% e zënë investitorët individualë.

**Tabelë 12: Tregues për vlerat e kuotave të fondeve të investimeve** *(Në lekë)*

| *Përshkrimi* | *Vlera fillestare e vlerës neto të aseteve për kuotë* | *Vlera neto e aseteve për kuotë 31.12.2013* | *Vlera neto e aseteve për kuotë 31.12.2014* |
|---|---|---|---|
| Raiffeisen Prestigj | 1,000[10] | 1,148 | 1,207 |
| Raiffeisen Invest EURO[11] | 4,000[12] | 14,538 | 15,024 |

**Tabelë 13: Tregues të detajuar nga pasqyrat financiare të fondeve të investimeve, sipas periudhave tremujorëve, 2014** *(Në mln. lekë)*

| *Përshkrimi* | *Vlera (në mln. lekë)* | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **31.03.'14** | **31.06.'14** | **30.09.'14** | ***31.12.'14*** |
| **Asetet neto të fondit** | **59,447** | **65,071** | **63,796** | **63,736** |
| Totali i aseteve të fondit | 59,725 | 65,274 | 64,151 | **64,041** |
| *nga të cilat:* | | | | |
| Obligacione qeveritare | 48,312 | 51,757 | 49,710 | 50,499 |
| Bono thesari | 5,218 | 6,717 | 8,357 | 8,568 |
| Investime të tjera | 285 | 433 | 439 | 589 |
| Mjete monetare | 5,015 | 5,190 | 4,564 | 3,411 |
| Asete të tjera | 895 | 1,177 | 1,081 | 974 |
| **Totali i detyrimeve të fondit** | **277** | **203** | **354** | **306** |

Shënim: [10] Vlera fillestare në 31.03.2012.
[11] Vlerat e Raiffeisen Invest EURO janë konvertuar me kursin 1euro = 140 lekë.
[12] Vlera fillestare në 22.11.2012.

**Tabelë 14: Tregues të detajuar nga pasqyrat financiare të fondeve të investimeve, 31.12.'13-31.12.'14** *(Në mln. lekë)*

| *Përshkrimi* | *Vlera (në mln. lekë)* | | *Ndryshimi (në %)* | *Pjesa ndaj totalit në %* | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Periudha** | **31.12.'13** | **31.12.'14** | **31.12.'13-31.12.'14** | **31.12.'13** | **31.12.'14** |
| **Asetet neto të fondit** | **50,329** | **63,736** | **26.64** | | |
| ***Totali i aseteve të fondit*** | ***50,507*** | ***64,041*** | ***26.80*** | ***100.00*** | ***100.00*** |
| *nga të cilat:* | | | | | |
| Obligacione qeveritare | 42,410 | 50,499 | 19.07 | 83.97 | 78.85 |
| Bono thesari | 4,640 | 8,568 | 84.66 | 9.19 | 13.38 |
| Investime te tjera | - | 589 | - | - | 0.92 |
| Mjete monetare | 2,583 | 3,411 | 32.08 | 5.11 | 5.33 |
| Asete të tjera | 874 | 974 | 11.42 | 1.73 | 1.52 |
| **Totali i detyrimeve të fondit** | **178** | **306** | **71.42** | **0.35** | **0.48** |

**Grafik 14: Struktura e aseteve të fondeve të investimeve 31.12.2013** *(Në %)*




**Grafik 15: Struktura e aseteve të fondeve të investimeve 31.12.2014** *(Në %)*




## Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2014 u dominua në masën 77.74% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 22.26% nga instrumente afatgjatë (obligacione). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 98.35% e të gjitha transaksioneve të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Transaksionet “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” dominojnë tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2014. Ato arritën përkatësisht në masën 61.87% dhe 19.95% kundrejt volumit të përgjithshëm të transaksioneve.

Investitorët individualë dominojnë në këtë treg duke kryer rreth 97.67% të të gjitha transaksioneve në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë.

**Tabelë 15: Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë**

| | *Lloji i Transaksionit* | *Vlera nominale (mln. lekë)* | | *Ndryshimi (në %)* |
|---|---|---|---|---|
| | | ***2013*** | ***2014*** | ***`14/`13-1*** |
| A | **Blerje në tregun primar** | **46,342** | **37,058** | **(20.03)** |
| | *Individë* | *8,310* | *12,137* | *46.05* |
| | *Persona juridikë* | *38,031* | *24,921* | *(34.47)* |
| B | **Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar** | **5,217** | **7,190** | **37.82** |
| | *Individë* | *4,912* | *5,879* | *19.69* |
| | *Persona juridikë* | *305* | *1,311* | *329.91* |
| C | **Blerje para afatit të maturimit** | **2,876** | **3,330** | **15.77** |
| | *Individë* | *2,442* | *2,959* | *21.15* |
| | *Persona juridikë* | *435* | *372* | *(14.49)* |
| D | **Vendosje e bonos si kolateral** | **105** | **372** | **255.49** |
| | *Individë* | *78* | *45* | *(42.14)* |
| | *Persona juridikë* | *26* | *326* | *1,140.68* |
| E | **Shlyerje e vlerës nominale në maturim** | **16,955** | **11,952** | **(29.51)** |
| | *Individë* | *14,696* | *10,675* | *(27.36)* |
| | *Persona juridikë* | *2,258* | *1,277* | *(43.48)* |

Gjatë vitit 2014, AMF filloi përdorimin e sistemit të raportimit elektronik, AMF In–Reg, për subjektet e licencuara që ushtrojnë veprimtari në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë. Sistemi synon informatizimin e procesit të raportimit në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, duke rritur efektivitetin dhe duke garantuar siguri dhe besueshmëri në analizën e tyre.

Format e raportimit elektronik, për aktivitetin në tregun e letrave me vlerë të Qeverisë, u testuan nga subjektet dhe po ashtu edhe nga AMF, gjatë vitit 2014, për të parë ecurinë e raportimit. AMF synon që ta shtrijë plotësisht këtë sistem gjatë vitit 2015 për të gjeneruar raporte mbi tregun.

## Platforma GSRM (Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë)

Gjatë vitit 2014, platforma GSRM, vazhdoi të funksionojë dhe të përmbushë rolin e saj duke siguruar rritje të transparencës në kuotimet dhe transaksionet në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë. Në treg veprojnë 10 operatorë të licencuar nga AMF për të tregtuar letrat me vlerë të Qeverisë. AMF, duke synuar mbrojtjen më të mirë të interesave të investitorëve, monitoron veprimtarinë e këtyre operatorëve dhe kujdeset që informacioni të jetë i përditësuar dhe në kohë reale. Platforma përfshin edhe një bazë të dhënash historike, e cila u vjen në ndihmë personave të cilëve u nevojiten të dhëna për qëllime statistikore apo akademike.

Platforma e GSRM-së jep një informacion të plotë për publikun dhe investitorët institucionalë në lidhje me kërkesat dhe ofertat ditore në tregun me pakicë të instrumenteve të borxhit të Qeverisë.

Gjatë vitit 2014, në platformën GSRM janë kryer 19,196 klikime, duke zënë 6.08% të të gjithë vizitave në faqen zyrtare të AMF-së.

## Aktiviteti licencues në tregun e letrave me vlerë

Gjatë vitit 2014 nuk pati ndryshim në numrin e operatorëve që ushtrojnë veprimtarinë në tregun e letrave me vlerë. Numri i shoqërive komisionere të licencuara në këtë treg vazhdon të jetë 13 dhe numri brokerave fizikë të punësuar në shoqëritë komisionere është 18.

Pjesa më aktive e tregut të letrave me vlerë është tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë shqiptare. Në këtë treg operojnë kryesisht bankat, të licencuara nga AMF për të kryer këtë veprimtari.

**Tabelë 16: Subjekte të licencuara që operojnë në tregun e letrave me vlerë** *(Në numër)*

| *Subjekte* | *2010* | *2011* | *2012* | *2013* | *2014* |
|---|---|---|---|---|---|
| Shoqëri komisionere | 12 | 13 | 13 | 13 | 13 |
| Broker fizik në shoqëri komisionere | 16 | 17 | 18 | 18 | 18 |
| Kujdestarë të titujve të Qeverisë së R.Sh. | 7 | 8 | 8 | 8 | 8 |
| Regjistrues aksionesh | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| Shoqëri këshillimi për investime në tituj | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 |
| Këshilltar për investime në tituj | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 |

### Miratimi i ofertës private të obligacioneve

Gjatë vitit 2014, Autoriteti miratoi prospektet respektive për 4 emetime obligacionesh me ofertë private, të ofruara nga 2 shoqëri në shumën 2 miliardë e 960 milionë lekë.

#### Ofertë private e obligacioneve

Tregu i obligacioneve u ofron shoqërive aksionare mundësi për sigurimin e fondeve të financimit për biznesin e tyre.

Ligji nr. 9879 datë 21.2.2008 "Për titujt" dhe Ligji nr. 10158 datë 15.10.2009 "Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore" përbëjnë bazën ligjore për rregullimin e emetimit dhe të tregtimit të obligacioneve.

Kjo bazë ligjore mbështet krijimin e një tregu aktiv dhe efektiv obligacionesh në Shqipëri.

## 1.4 Tregu i Pensioneve Private Vullnetare

Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare në fund të vitit 2014 tregon një total asetesh neto prej 629.14 milionë lekë dhe me një rritje prej afro 194.32 milionë lekë (44.69%), krahasuar me fundin e vitit 2013.

Gjatë vitit 2014 numri i operatorëve të tregut të pensioneve private vullnetare nuk pati ndryshime. Në këtë treg ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni vullnetar të administruar nga tri shoqëri administruese, përkatësisht "Raiffeisen Invest, shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive" sh.a., e cila administron Fondin e Pensionit Vullnetar Raiffeisen, "Shoqëri administruese e fondeve të SIGAL–Life Uniqa Group Austria" sh.a., e cila administron Fondin e Pensionit Vullnetar Sigal, si dhe "Shoqëri administruese e fondit të pensionit SiCRED" sh.a., e cila administron Fondin e Pensionit Vullnetar SiCRED.

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve në fund të vitit 2014 ishte 8,491 anëtarë, duke shënuar rritje prej 7.66% krahasuar me fundin e vitit 2013.

**Tabelë 17: Tregues të fondeve të pensioneve**

| Përshkrimi | Vlera *(mln. lekë)* | | Ndryshimi *(në %)* |
|---|---|---|---|
| ***Periudha*** | ***31.12.'13*** | ***31.12.'14*** | ***31.12.'13-31.12.'14*** |
| Asetet neto të FP | 434.82 | 629.14 | 44.69 |

**Tabelë 18: Asetet neto dhe numri i anëtarëve sipas fondeve të pensioneve** *31.12.2014*

| *Fond Pensioni* | *Numri i anëtarëve në FP* | *Asete Neto (mln. lekë)* |
|---|---|---|
| SIGAL | 4,027 | 310.56 |
| RAIFFEISEN | 2,540 | 232.85 |
| SiCRED PENSION | 1,924 | 85.73 |
| **TOTAL** | **8,491** | **629.14** |

**Grafik 16: Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensioneve** *31.12.2014*



**Grafik 17: Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensioneve** *31.12.2014*




Asetet e fondeve të pensioneve janë investuar në obligacione të thesarit të Republikës së Shqipërisë. Totali i investimeve për 31.12.2014 ka qenë 581.71 milionë lekë, duke shënuar një rritje me 37.95% krahasuar me fundin e vitit 2013.

**Tabela 19: Vlera e investimeve të tregut të fondeve të pensioneve** *(Në mln. lekë)*

| *Periudha* | *31.12.'12* | *31.12.'13* | *31.12.'14* |
|---|---|---|---|
| Totali i investimeve të FP | 275.38 | 421.68 | 581.71 |

Sipas neneve 88–91 të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" parashikohen lehtësira tatimore të kontribuesve si anëtarë të fondeve të pensioneve private vullnetare. Edhe gjatë vitit 2014, skemat e pensioneve private vullnetare nuk kanë mundur të tërheqin shumë anëtarë, pasi lehtësirat fiskale të parashikuara në ligjin "Për fondet e pensionit vullnetar", nuk janë zbatuar nga legjislacioni tatimor.

## Inspektime në bankat depozitare të fondeve të pensioneve dhe investimeve

Gjatë vitit 2014, AMF ka kryer inspektime të përbashkëta me BSH në bankat depozitare të fondeve të pensioneve dhe investimeve. Objekt i inspektimeve në vend tek bankat depozitare ishte administrimi i llogarive të posaçme të aseteve të fondeve të pensioneve dhe investimeve, procedurat e brendshme që ndiqen nga depozitari për fondet e pensioneve dhe investimeve, duke filluar nga blerja e kuotave deri në riinvestimin dhe shlyerjen e tyre në favor të mbajtësve të kuotave.

Në këto inspektime u verifikuan edhe metodologjia e përdorur nga depozitarët për rivlerësimin e aseteve të fondeve të pensioneve dhe investimeve.

Pjesë e rëndësishme e këtij inspektimi ishte verifikimi  i sistemeve që përdor depozitari, siguria e sistemeve në llogaritjen e vlerës neto të aseteve të fondeve të pensioneve dhe investimeve, frekuenca e informimit të shoqërisë administruese, si edhe procedura e rakordimit të kësaj vlere me regjistrimet e shoqërisë administruese. Autoriteti iu komunikoi këtyre subjekteve gjetjet përkatëse nga inspektimet e kryera, duke lënë rekomandime dhe afate për respektimin e tyre.

## 1.5 Masat Korrigjuese dhe Administrative

Legjislacioni që rregullon veprimtarinë e AMF-së dhe të subjekteve financiare nën mbikëqyrjen e tij parashikon masa korrigjuese dhe administrative me qëllim parandalimin dhe eliminimin e shkeljeve në kohën e duhur, duke bërë të mundur ndërprerjen e veprimeve që përbëjnë shkelje të ligjit, mbrojtjen konsumatore dhe forcimin e rolit të AMF-së.

Gjatë vitit 2014, AMF në disa raste ka proceduar në marrjen e masave parandaluese dhe korrigjuese dhe në disa raste të tjera ka kërkuar plane për parandalimin e problemeve. Këto plane kanë përfshirë hapa të detajuar për zgjidhjen e problematikave të konstatuara brenda një afati të caktuar kohor.

Për shoqëritë që veprojnë në tregun e sigurimeve, Bordi i AMF-së, gjatë vitit 2014, ka marrë gjithsej 5 vendime për masa administrative si rezultat i konstatimeve të bëra nga analizimi i treguesve financiare ashtu edhe nga inspektimet në vend të kryera nga Autoriteti.

Vendimet e detajuara sipas llojit të masave administrative paraqiten në tabelën më poshtë:

**Tabela 20: Masa administrative të marra nga AMF në tregun e sigurimeve, 2014** *(Në numër)*

| *Urdhër për eliminim shkeljeje* | *Plan biznesi* | *Plan masash për eliminim të shkeljeve* | *Rekomandim për rritje kapitali* | *Rekomandim për keshillin mbikëqyrës* |
|---|---|---|---|---|
| *5* | *1* | *1* | *1* | *1* |

Gjatë vitit 2014 janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Rrethit Gjyqësor Tiranë 4 vendime të Bordit të AMF-së dhe 11 procese gjyqësore që lidhen me çështje gjyqësore të mbartura nga vitet e kaluara. Gjatë vitit 2014 ka përfunduar procesi i gjykimit për 5 çështje, nga të cilat tri çështje janë fituar nga AMF, një çështje është humbur dhe një çështje është e fituar pjesërisht.

Bordi i AMF-së, bazuar në rekomandimet e BB dhe FMN, me qëllim marrjen e masave për stabilizimin dhe rritjen e pagesave të dëmeve të tregut MPTL, me vendimin nr. 18, datë 10.03.2014 ka miratuar rregulloren për krijimin e një rezervë monetare bazuar në të dhënat e tregut mbi dëmet e ndodhura si dhe sigurimin për financimin e mjaftueshëm të kësaj rezerve. Ky vendim i Autoritetit u ankimua në Gjykatën Administrative të Rrethit Gjyqësor Tiranë nga dy shoqëri sigurimi. Gjykimi i kësaj çështjeje, u pushua nga Gjykata pasi shoqëritë nuk shprehën interes për vijim e gjykimit duke hequr dorë nga ankimi dhe u procedua me zbatimin e vendimit të Bordit të AMF-së.

Një tjetër çështje gjyqësore lidhej me kërkesën e AMF-së për nxjerrjen e një urdhëri ekzekutimi. Çështja u pushua nga gjykata për arsye se vendimi i Autoritetit u ekzekutua para përfundimit të gjykimit të çështjes.

Një vendim i Bordit të Autoritetit që lidhej me mosmiratimin e kandidatit për pozicionin e Drejtorit të Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, u ankimua në Gjykatën Administrative të Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata në përfundim të gjykimit vendosi rrëzimin e kërkesë-padisë, duke mos pranuar ankimin.

Çështja e humbur nga AMF lidhet me një ankim ndaj vendimit të Bordit për vendosjen e sanksionit me gjobë ndaj një shoqërie sigurimi. Sanksioni lidhej me mospërmbushjen e detyrimit kontraktual për pagesën e dëmshpërblimit nga ana e shoqërisë së sigurimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit kanë pranuar ankimin, duke shfuqizuar vendimin e Bordit të AMF-së. AMF ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Apelit.

AMF ka ndjekur me rigorozitet proceset e ankimit dhe mbrojtjes gjyqësore në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor.

**Tabela 21: Proceset gjyqësore të ndjekura nga AMF, 2014** *(Në numër)*

| *Totali* | *Të përfunduara* | *Në proces* |
|---|---|---|
| *15* | *5* | *10* |

Referuar masave administrative të marra, Autoriteti ka ndjekur zbatimin e tyre, nga ku rezulton se janë zbatuar të gjitha afatet për depozitimin e raporteve që përfshijnë masa korrigjuese sipas shkeljeve të konstatuara.

Përsa i përket urdhërit për eliminimin e shkeljeve, gjatë verifikimit të masave me afat të përcaktuar brenda vitit 2014, rezulton se subjektet kanë zbatuar urdhërat për eliminimin e shkeljeve të konstatuara, duke veçuar vetëm një shoqëri sigurimi e cila ka zbatuar pjesërisht vendimin e Autoritetit.

Ndërsa, përsa i përket masave administrative me sanksion me gjobë, gjatë vitit 2014, Bordi nuk ka marrë masa të tilla.

# Kapitulli 2
# Rregullimi i tregjeve financiare nën mbikëqyrje

## 2.1 Veprimtaria e Bordit të AMF-së

Bordi i AMF-së, në përmbushje të funksioneve të tij, gjatë vitit 2014 ka zhvilluar 14 mbledhje dhe ka marrë 163 vendime. Tabela më poshtë pasqyron numrin e vendimeve të Bordit të AMF-së të ndarë sipas llojeve.

**Tabelë 22: Ndarja e vendimeve të Bordit të AMF-së sipas llojit të vendimit**

| *Llojet e vendimeve* | *Numër* |
|---|---|
| Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e sigurimeve | 125 |
| Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e letrave me vlerë | 16 |
| Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e pensioneve private vullnetare | 9 |
| Vendime për masa administrative e korrigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura | 5 |
| Vendime për kuadrin rregullues të AMF-së | 8 |
| **Vendime në tërësi** | **163** |

Vendimet e Bordit kanë synuar përmbushjen e objektivave të Autoritetit, kryesisht nxitjen e qëndrueshmërisë financiare dhe rritjen e besueshmërisë së tregjeve që mbikëqyren. Ndër vendimet më të rëndësishme që zënë edhe pjesën më të madhe janë ato që lidhen me rregullimin e tregut të sigurimit, duke përfshirë dhe vendimet për marrjen e masave korrigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura si dhe vendimet për rregullimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit në këtë treg. Vendime të tjera janë miratuar me qëllim përmirësimin e kuadrit të brendshëm rregullativ dhe rritjen e efektshmërisë së funksioneve të AMF-së.

Në plotësim të kuadrit ligjor dhe zbatim të ligjit të ri të sigurimeve janë miratuar rregulloret "Për bashkimin ose ndarjen e shoqërive të sigurimit", "Për procedurat dhe parimet minimale në lidhje me sistemin e kontrollit te brendshëm dhe aspekte të tjera të sistemit të informimit të shoqërisë së sigurimit", "Për veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm dhe komitetit të auditimit në shoqërinë e sigurimit", "Për njoftimin, korrigjimin apo ndalimin e informacionit promocional" si edhe "Manuali i mbikëqyrjes së shoqërive të sigurimit".

Në zbatim të ndryshimeve që pësoi ligji për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare u miratua edhe rregullorja "Për përcaktimin e elementeve të përllogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre". Me qëllim rritjen e transparencës dhe mbrojtjen e investitorit, Bordi i Autoritetit miratoi rregulloren "Për informacionin kryesor që duhet t'i vihet në dispozicion investitorit të skemave të investimeve kolektive". Vendime të tjera janë ndërmarrë për miratim statuti apo prospekti si edhe për përzgjedhjen e strukturave drejtuese të subjekteve që mbikëqyren, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

## 2.2 Aktiviteti rregullator

Gjatë vitit 2014, Kuvendi i Shqipërisë miratoi **Ligjin nr. 52/2014, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".**

*Risitë e Ligjit "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit"*

Ligji i ri nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit. Ai i shërben përmirësimit të kuadrit ligjor për t'iu përshtatur zhvillimeve të tregut të sigurimeve dhe risigurimeve. Ky ligj është rezultat i punës disa vjeçare të Autoritetit në kuadër të zbatimit të MSA-së dhe rekomandimeve të Progres Raporteve të BE, si edhe të BB dhe FMN në kuadër të shënimeve teknike të programit FSAP. Ky ligj është edhe në përputhje me synimin e AMF-së për të rritur më tej shkallën e përputhshmërisë dhe zbatimin e Parimeve Bazë të Sigurimeve (Insurance Core Principles, ICP) të IAIS. Po kështu në hartimin e këtij ligji u mor parasysh kuadri rregullator evropian i Solvency I, dhe specifikisht direktivat: 73/239/KEE, 73/240/KEE, 87/344/KEE, 87/343/KEE, 88/357/KEE, 92/49/KEE, 2002/13/KE, 98/78/KE, 2002/92/KE, 2005/68/KE, 2002/83/KE, 2001/17/KE dhe 84/641/KEE.

Në ndryshim nga ligji i mëparshëm, Ligji nr. 52/2014, sjell një koncept të ri për personat drejtues dhe për kriteret që duhet të plotësojnë ata në drejtimin dhe administrimin e shoqërisë së sigurimit, duke parashikuar kriteret e profesionalitetit dhe integritetit, si kushte mjaft të rëndësishme në realizimin e këtyre funksioneve. Në këtë mënyrë, ligji ka synuar rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së personave, të cilët administrojnë dhe drejtojnë shoqërinë e sigurimit.

Në përmbushje të rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë, ligji vendos për herë të parë konceptin e mbikëqyrjes me fokus rrezikun, koncepti bazë i metodologjisë së re të mbikëqyrjes. Objektivi i mbikëqyrjes me fokus rrezikun është paralajmërimi dhe parandalimi i problemeve financiare përpara se këto të ndodhin, në vend që të punohet për zgjidhjen e tyre.

Një tjetër risi e këtij ligji është edhe rregullimi i mbikëqyrjes së grupit, nëpërmjet përfshirjes të koncepteve të reja që lidhen me grupin në sigurime, duke zgjeruar mbikëqyrjen e AMF-së jo vetëm te shoqëria e sigurimit, por edhe ndaj grupit në të cilin bën pjesë shoqëria e sigurimit.

*Ndryshimi i Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar"*

Gjatë vitit 2014, me asistencën e ekspertëve të Bankës Botërore në kuadër të Programit First Initiative ka vazhduar puna për ndryshimet në Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar".

Krahas ndryshimeve të propozuara nga ekspertët e BB gjatë vitit 2014, AMF hartoi dhe dërgoi pranë Ministrisë së Financave propozimin për disa ndryshime në Paketën Fiskale me qëllim harmonizimin e dispozitave të Ligjit nr. 10197, "Për fondet e pensionit vullnetar" me aktet ligjore që rregullojnë tatimin mbi të ardhurat. Këto propozime kanë hyrë në fuqi prej muajit janar 2015.

Qëllimi i këtyre ndryshimeve është përfshirja në paketën fiskale si dhe njohja nga organet tatimore të lehtësirave fiskale që parashikon ligji për fondet e pensionit vullnetar dhe që deri më tani nuk janë zbatuar nga organet tatimore. Miratimi i këtyre ndryshimeve do të mundësojë zbatimin real dhe efektiv të dispozitave të këtij ligji, të cilat parashikojnë lehtësi tatimore të aplikuara mbi kontributet e anëtarit të fondit të pensionit, kontributet e punëdhënësit dhe kontributet që çdo person derdh në emër dhe për llogari të anëtarit të fondit të pensionit.

Pjesë e propozimit të Autoritetit për ndryshimin e paketës fiskale është edhe trajtimi fiskal i kthimit nga investimi i aseteve të fondit të pensionit.

## Aktet nënligjore në fushën e sigurimeve

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" Autoriteti vijoi punën për hartimin dhe miratimin e akteve në zbatim të këtij ligji. Gjatë 2014, u hartua dhe u miratuan 6 aktet të reja të Autoritetit.

- Ndër më të rëndësishmet përmendim miratimin e "Manualit të Mbikëqyrjes së Shoqërive të Sigurimit", objekti i të cilit është përcaktimi i metodologjisë me fokus rreziku për mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë. Manuali i mbikëqyrjes së shoqërive të sigurimit u përafrua pjesërisht me Direktivën 2009/138/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 nëntorit 2009 për themelimin dhe vazhdimin e veprimtarisë në sigurime dhe risigurime.
- Rregullore nr. 154, datë 23.12.2014 "Për njoftimin, korrigjimin apo ndalimin e informacionit promocional", kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe procedurave për njoftimin, korrigjimin apo ndalimin e informacionit promocional.

- Rregullore nr. 153, datë 23.12.2014, "Për veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm dhe komitetit të auditimit në shoqërinë e sigurimit", objekti i së cilës është përcaktimi i normave të përgjithshme që rregullojnë funksionet e njësisë së auditimit të brendshëm dhe komitetit të auditimit, si dhe raportet e ndërsjella ndërmjet tyre në shoqëritë e sigurimit.

- Rregullore nr. 135, datë 31.10.2014 "Për procedurat dhe parimet minimale në lidhje me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe aspekte të tjera të sistemit të informimit të shoqërisë së sigurimit", objekt i së cilës është përcaktimi i procedurave dhe parimeve minimale lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe aspekte të tjera të sistemit të informimit të shoqërive së sigurimit që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

- Rregullore nr. 109, datë 29.08.2014 "Për kushtet dhe procedurat e bashkimit ose ndarjes së shoqërisë së sigurimit", kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e kushteve dhe procedurave për bashkimin dhe ndarjen e shoqërive të sigurimit.

- Rregullore nr. 18, datë 10.03.2014 "Për përcaktimin e rregullave për pagesën nga rezerva monetare të dëmeve që mbulohen nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit", e cila ka si objekt përcaktimin e rregullave për krijimin e një rezervë në mjete monetare bazuar në të dhënat e tregut mbi dëmet e ndodhura si dhe sigurimin për financimin e mjaftueshëm të kësaj rezerve. Krijimi i kësaj rezerve do të realizohet nëpërmjet fazave të ndryshme në kohë deri në arritjen e përmirësimeve të dukshme të tregut MTPL.

Gjithashtu me qëllim ushtrimin e një mbikëqyrje sa më efektive të aktivitetit të tregut dhe operatorëve, Autoriteti përmirësoi aktet ekzistuese me anë të ndryshimeve dhe shtesave. Aktet e Autoritetit të ndryshuara paraqiten si më poshtë:

- Ndryshime dhe shtesa në Rregulloren nr. 67, datë 27.7.2009, "Mbi licencimin e aktuarëve të autorizuar të shoqërive të sigurimit", ndryshuar me Vendim Bordi nr.3, datë 23.1.2014.

- Ndryshime në Rregulloren nr. 18, datë 10.03.2014 "Për përcaktimin e rregullave për pagesën nga rezerva monetare të dëmeve që mbulohen nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit", ndryshuar me Vendim Bordi nr. 98, datë 25.6.2014.

- Ndryshime në Rregulloren nr. 53, datë 25.06.2009 "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", ndryshuar me Vendim Bordi nr. 148, datë 20.11.2014.

## Aktet nënligjore në fushën e letrave me vlerë

Gjatë vitit 2014, edhe tregu i letrave me vlerë ka pasur zhvillime të rëndësishme në kuadër të forcimit dhe rregullimit të bazës ligjore. AMF në zbatim të detyrave të lëna nga misioni i FMN dhe BB për plotësimin e bazës rregullative të fondeve të investimeve si dhe harmonizimin e mëtejshëm me direktivat e BE-së miratoi dy akte të reja nënligjore si dhe ndryshoi një akt ekzistues. Më konkretisht:

Të miratuara:

- Rregullore nr. 96, datë 25.06.2014 "Për formën, llogaritjen dhe shumën e kapitalit që duhet të ketë detyrimisht shoqëria administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive", qëllimi i së cilës është përcaktimi i formës, llogaritjes dhe shumës së kapitalit që duhet të ketë detyrimisht dhe në çdo kohë shoqëria administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Kjo rregullore u përafrua me Direktivën 2009/65/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 korrik 2009 "Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative që lidhen me ndërmarrjet për investimet kolektive të titujve të transferueshëm (UCITS), Direktivën 2006/49/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e datës 14 qershor 2006 "Për mjaftueshmërinë e kapitalit të firmave të investimit dhe institucioneve të kreditit", Direktivën 2006/48/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e datës 14 qershor 2006 "Për krijimin dhe funksionimin e sipërmarrjes së institucioneve të kreditit".

- Rregullore nr. 97, datë 25.06.2014 "Për informacionin kryesor që duhet t'i vihet në dispozicion investitorit të skemave të investimeve kolektive". Kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e rregullave për dhënien e detyrueshme të informacionit kryesor për investitorin nga shoqëria administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, për përmbajtjen e detajuar të informacionit kryesor dhe për kushtet që duhet të plotësojë ky informacion. Kjo rregullore u përafrua pjesërisht me Direktiva 2009/65/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, 13 korrik 2009 "Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative lidhur me sipërmarrjet për investimet kolektive në letrat me vlerë të transferueshme (UCITS)" si edhe Rregulloren e BE nr. 583/2010, nxjerrë në zbatim të Direktivës 2009/65.

- Po kështu u miratuan edhe ndryshime dhe shtesa në Rregulloren nr. 131, datë 06.10.2011 "Mbi kodin e sjelljes të shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive", ndryshuar me Vendim Bordi nr. 136, datë 31.10.2014. Qëllimet e këtyre ndryshimeve konsistojnë në qartësimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të përmbajtjes si edhe përshtatjen me parashikimet e Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009, "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive". Me konkretisht, në rregullore është shtuar detyrimi i shoqërisë administruese të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive të njohë investitorin, të monitorojë likuiditetin, të respektojë rregullat e transparencës si dhe rregullat e etikës në informimin e investitorëve.

## 2.3 Proceset integruese për tregjet nën mbikëqyrje

Komisioni Evropian publikoi në muajin qershor raportin "Për progresin e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe reformën në drejtësi", ku mbi bazën e konstatimeve, konfirmoi rekomandimin për dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë. Më datë 9 tetor 2014, Komisioni Evropian publikoi Raport Progresin për Shqipërinë, i cili përshkruan progresin e bërë nga Shqipëria gjatë periudhës tetor 2013-shtator 2014. Pjesë e këtij Raporti janë edhe vlerësimet për Kapitullin 9 - Shërbimet Financiare, ku Komisioni Evropian ka vlerësuar pozitivisht disa përparime në fushën financiare jobankare.

**Konkluzionet e Progres Raportit të KE-së (tetor 2013-shtator 2014)**
*(Kapitulli 9-Shërbimet Financiare)*

"Janë bërë disa përparime në fushën e shërbimeve financiare, kryesisht në kuadrin legjislativ për mbikëqyrjen e sektorëve bankar dhe jobankar. Përgatitjet në fushën e tregjeve të letrave me vlerë dhe të sigurimeve mbeten në fazë të hershme. Punë e mëtejshme nevojitet për ta përafruar legjislacionin me *acquis*. Në tërësi, përgatitjet në këtë fushë kanë avancuar në masë të moderuar."

Hartimi i Raport Progresit nga ana e KE-së mbështetet edhe në kontributet e përgatitura nga qeveria e Shqipërisë mbi përparimin dhe arritjet e institucioneve publike shqiptare në procesin e integrimit Evropian të Shqipërisë, ku për Kapitullin 9 "Shërbimet Financiare" AMF është institucioni koordinues. Autoriteti në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë ka pasqyruar qartësisht zhvillimet aktuale si përsa i përket përafrimit të kuadrit ligjor, aktiviteteve zbatuese, zhvillimeve dhe reformave në sektorin financiar për tregjet nën mbikëqyrje. AMF po në këtë proces ka dhënë kontributin e vet edhe në kapitullin "Kriteri Ekonomik".

Gjatë vitit 2014, AMF ka vazhduar bashkëpunimin me **Ministrinë e Integrimit Evropian** si institucioni koordinues i të gjitha përpjekjeve të vendit drejt integrimit evropian. AMF ka përgatitur raporte të cilat pasqyrojnë progresin e arritur dhe ka dhënë kontributin e tij në hartimin e dokumenteve që lidhen me procesin e Stabilizim-Asociimit. AMF ka marrë pjesë në hartimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2014-2020 për Kapitullin 9 "Shërbimet Financiare", si dhe në përditësimin e këtij plani për vitin 2015 e në vazhdim. Plani Kombëtar shërben si bazë për planifikimin e procesit të integrimit evropian të Shqipërisë.

AMF ka përcjellë në Ministrinë e Integrimit raporte periodike për monitorimin e realizimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2014-2020 për kapitujt "Shërbimet Financiare" dhe "Kriteri Ekonomik". Po kështu AMF, ka përgatitur dhe prezantuar informacione pranë Komisionit Evropian në kuadrin e zhvillimit të takimeve periodike

midis Shqipërisë dhe BE-së, konkretisht takimi i pestë i Komitetit të Stabilizim – Asociimit BE Shqipëri në mars 2014 dhe i Nënkomitetit BE–Shqipëri për "Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën" në prill 2014.

**Direktiva MiFID II (Direktiva 2014/65/BE)**

Direktiva MiFID *(Market in Financial Instruments Directive)* zbatimi i së cilës ka filluar që prej vitit 2007 është direktiva bazë, më e rëndësishme e rregullimit të tregjeve financiare të BE-së.

Kjo direktivë mundësoi për herë të parë konkurrencën në tregtimin e titujve midis firmave dhe tregjeve të ndryshme të investimit që operojnë në BE dhe ju dha atyre "një pasaportë" për të tregtuar kudo në BE, bazuar vetëm në autorizimin e shtetit të tyre anëtar. Direktiva gjithashtu përfshiu dhe masa të ndryshme për mbrojtjen e investitorëve.

Në tetor 2011, mbas konsultimeve për reformimin e kësaj direktive, Komisioni Evropian publikoi propozimet legjislative të cilat morën formën e MiFID II dhe rregullores së re MiFIR *(Market in Financial Instruments Regulation)*.

*Të dyja MiFID II dhe MiFIR hynë në fuqi në 2 korrik 2014 dhe duhet të aplikohen në janar 2017.*

Synimet e MiFID II janë:

- Të krijojë një treg financiar të sigurt, të shëndoshë, më shumë transparent dhe të përgjegjshëm;
- Të sigurojë më shumë integritet, konkurrencë eficente të tregut financiar të BE-së;
- Të mundësojë angazhimin e G20-s për të trajtuar pjesët më pak të rregulluara dhe të paqarta të sistemit financiar (kryesisht në Instrumentet Tregtare mbi Banak);
- Të kontribuojë në krijimin e një rregulloreje të vetme për tregjet financiare të BE-së;
- Të ndihmojë zhvillimin e mëtejshëm të një fushe loje të barabartë midis shteteve anëtare dhe pjesëmarrësve në treg;
- Të përmirësojë mbikëqyrjen dhe zbatueshmërinë;
- Të ulë kostot e pjesëmarrësve, të përmirësojë kushtet e aksesit dhe të rrisë konkurrencën globale.

### Direktiva mbi abuzimin në treg (Market Abuse)

Direktiva mbi abuzimin në treg, e miratuar në 2003, është një nga direktivat kryesore në tregun e titujve, e cila është hartuar për të ndihmuar plotësimin e një tregu të vetëm për shërbimet financiare në BE. Qëllimi kryesor i kësaj direktive është ngritja e një kuadri bazë për parandalimin e abuzimeve në treg, rritjen e besimit të investitorëve dhe integritet më të lartë në sistemit financiar. Realiteti i zhvillimeve në treg si: platformat e reja të tregtimit, tregtimi i Tregjeve Mbi Banak *(Over The Counter)* dhe Teknologjitë e Tregtimit me Frekuenca të Larta *(High Frequency Trading)* e kanë tejkaluar kuadrin rregullator aktual.

Propozimet e reja, që u paraqitën fillimisht në tetor 2011, kishin si qëllim adoptimin e rregullave të BE-së për realitetin e ri të tregut, sidomos duke zgjeruar fushëveprimin e instrumenteve financiare të tregtuara vetëm në platformat e reja dhe ato të tregtuara mbi banak, që më parë nuk mbuloheshin nga legjislacioni i BE-së, dhe adoptimi i rregullave për teknologjinë e re.

Në prill 2014 Këshilli i BE-së miratoi zyrtarisht rregulloren e re mbi abuzimin në treg dhe direktivën mbi sanksionet penale për abuzimet në treg, duke kompletuar procesin legjislativ për rregullat e reja.

### Direktiva UCITS (Direktiva 2009/65/KE)

Në korrik 2014, Komisioni Evropian miratoi Direktivën 2014/91KE “Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative lidhur me sipërmarrjet për investimet kolektive në letrat me vlerë të transferueshme (UCITS)” *(Undertakings collective investment in transferable securities)* për funksionet e depozitarit, politikave të shpërblimeve dhe sanksioneve.

Kjo direktivë përcakton rregulla të reja për sa i përket depozitarëve të UCITS të tilla si: subjektet e përshtatshme për të marrë përsipër këtë rol, detyrat e tyre, delegimi i funksioneve të tyre dhe përgjegjësitë e depozitarëve, si dhe parimet e përgjithshme të shpërblimit që aplikohen për menaxherët e fondeve.

**Solvency II (Direktiva 2009/138/KE)**

Direktiva 2013/58/EU ka përcaktuar një datë të re të zbatimit të Direktivës së *Solvency II,* pikërisht 31 Mars 2015 si datë të transpozimit të dispozitave të kësaj direktive në legjislacionin kombëtar të vendeve anëtare të BE-së dhe datën 1 Janar 2016 si datë të zbatimit të saj nga shoqëritë e sigurimit (data e mëparshme ishte 1 Janar 2014).

Në tetor 2014, Komisioni adoptoi një akt të deleguar për zbatimin e rregullave të *Solvency II.* Ky akt do të hyjë në fuqi menjëherë sapo Parlamenti Evropian dhe Këshilli ta aprovojnë atë.

Rregullat përfshijnë ndër të tjera:

- Vlerësimin e aseteve dhe përgjegjësive;
- Rregulla për vendosjen e nivelit të kapitalit që një sigurues mund të investojë për klasat e aseteve;
- Përshtatshmërinë e zërave të fondeve të veta të siguruesve për të mbuluar kërkesat për kapital;
- Rregulla se si kompanitë e sigurimeve duhet të qeverisen;
- Rregulla në lidhje me grupet e sigurimit;
- Njehsimin e vlerësimit të regjimeve të *Solvency* për vendet e treta.

# Kapitulli 3
# Qeverisja dhe mbrojtja e konsumatorit

## 3.1 Qeverisja dhe sjellja në treg

### Tregu i sigurimeve

Gjatë vitit 2014, Autoriteti ka miratuar ndryshime apo riemërime në përbërjen e këshillave mbikëqyrës në tetë shoqëri sigurimi, si dhe ka miratuar emërime në organet drejtuese në katër shoqëri sigurimi dhe drejtorin ekzekutiv të BSHS.

**Grafik 18: Skema e strukturës aktuale të drejtimit të shoqërive të sigurimit**




**Tabelë 23: Qeverisja e shoqërive të sigurimit – Statistika** *(Në numër)*

| | *2007* | *2008* | *2009* | *2010* | *2011* | *2012* | *2013* | *2014* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. mesatar i aksionarëve | 6.0 | 4.5 | 4.2 | 4.4 | 4.2 | 3.7 | 3.6 | 3.6 |
| Nr. mesatar i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës | 5.0 | 3.6 | 3.4 | 3.6 | 4.0 | 4.2 | 4.1 | 4.1 |
| Nr. mesatar i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës që nuk janë aksionarë | 2.0 | 2.8 | 2.7 | 3.1 | 3.5 | 3.7 | 3.6 | 3.7 |
| Nr. i Drejtorëve Ekzekutivë me pjesëmarrje influencuese mbi 10% | 3.0 | 3.0 | 2.0 | 2.0 | 3.0 | 3.0 | 3.0 | 3.0 |

**Tabelë 24: Të dhëna për aksionarët e shoqërive të sigurimit** *(Në numër)*

| *Emërtimi* | *2010* | *2011* | *2012* | *2013* | *2014* |
|---|---|---|---|---|---|
| Shoqëri sigurimi | 10 | 10 | 11 | 11 | 10 |
| *Aksionarë gjithsej* | 44 | 42 | 41 | 40 | 36 |
| *Klasifikimi i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese:* | | | | | |
| *nën 10%* | 28 | 23 | 21 | 22 | 20 |
| *mbi 10% nën 20%* | 4 | 5 | 6 | 4 | 4 |
| *mbi 20% nën 33 %* | 2 | 3 | 1 | 3 | 2 |
| *mbi 33% nën 50%* | 1 | 1 | 3 | 1 | 1 |
| *mbi 50%* | 9 | 10 | 10 | 10 | 9 |
| *Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës:* | | | | | |
| *Aksionarë të huaj* | 4 | 3 | 3 | 3 | 3 |
| Aksionarë vendas | 40 | 39 | 38 | 37 | 33 |
| *Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit:* | | | | | |
| Aksionarë individë | 36 | 33 | 32 | 31 | 28 |
| Aksionarë shoqëri | 7 | 8 | 8 | 8 | 7 |
| Aksionarë shteti | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |

**Grafik 19: Të dhëna për aksionarët sipas pjesëmarrjes influencuese** *(Në %)*



**Grafik 20: Të dhëna për aksionarët sipas vendit të origjinës** *(Në %)*




**Grafik 21: Të dhëna për aksionarët sipas statusit** *(Në %)*




## Prania e kapitalit të huaj në shoqëritë e sigurimit

Gjatë vitit 2014, në tregun shqiptar të sigurimeve nuk pati ndryshime në numrin e aksionarëve të huaj që zotërojnë aksione në shoqëritë shqiptare të sigurimit dhe aktualisht në tregun shqiptar të sigurimeve operojnë:

- *Vienna Insurance Group AG Wiener Versicherung Gruppe* me seli qendrore në Vienë, Austri;
- *Uniqa International Beteiligungs-Verwaltungs GmbH* me seli qendrore në Vienë, Austri;
- Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve.

### Miratime të ndryshimeve statutore të shoqërive të sigurimit

Gjatë vitit 2014, AMF ka miratuar kërkesat e shoqërive të sigurimit në lidhje me ndryshimet statutore, si më poshtë:

**Tabelë 25: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutore** *(Në numër shoqërish)*

| *Arsyeja e ndryshimit të statutit* | *2008* | *2009* | *2010* | *2011* | *2012* | *2013* | *2014* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Statut i ri e ndryshime të tjera | 2 | 2 | 2 | 6 | 6 | 2 | 6 |
| Ritje kapitali | 9 | 4 | 2 | 4 | 4 | 3 | 5 |
| Ndryshim i strukturës aksionare | 2 | 2 | 5 | 3 | 2 | 2 | 3 |

### Tregu i pensioneve vullnetare

Gjatë vitit 2014, Autoriteti ka miratuar ndryshime apo riemërime në përbërjen e këshillave mbikëqyrës në dy shoqëri administruese të fondeve të pensioneve vullnetare, si dhe ka miratuar emërime në organet drejtuese në dy shoqëri administruese të fondeve të pensioneve vullnetare.

**Grafik 22: Skema e strukturës aktuale të drejtimit të shoqërive administruese të fondeve të pensioneve vullnetare**



### Tabelë 26: Qeverisja e shoqërive administruese të fondeve të pensioneve – Statistika

| *Arsyeja e ndryshimit të statutit* | *2011* | *2012* | *2013* | *2014* |
|---|---|---|---|---|
| Nr. mesatar i aksionarëve | 1.7 | 1.7 | 1.7 | 1.7 |
| Nr. mesatar i anëtarëve të Këshillit të Administrimit | 5.3 | 5.3 | 5.3 | 5.6 |
| Nr. mesatar i anëtarëve të Këshillit të Administrimit që nuk janë aksionarë | 5.3 | 5.3 | 5.3 | 5.6 |
| Nr. i Administratorëve me pjesëmarrje influencuese mbi 10% | - | - | - | - |

### Tabelë 27: Të dhëna për aksionarët e shoqërive administruese të fondeve të pensioneve vullnetare

| *Emërtimi* | *Numër* |
|---|---|
| Shoqëri administruese | 3 |
| Aksionarë gjithsej | 5 |
| *Klasifikimi i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese* | |
| nën 10% | 0 |
| mbi 10% nën 20% | 1 |
| mbi 20% nën 33 % | 0 |
| mbi 33% nën 50% | 1 |
| mbi 50% | 3 |
| *Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës* | |
| Aksionarë të huaj | 0 |
| Aksionarë vendas | 5 |
| *Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit:* | |
| Aksionarë individë | 1 |
| Aksionarë shoqëri | 4 |

**Grafik 23: Të dhëna për aksionarët sipas pjesëmarrjes influencuese** *(Në %)*




**Grafik 24: Të dhëna për aksionarët sipas statusit** *(Në %)*




## Miratime të ndryshimeve statutore të shoqërive të fondeve të pensioneve vullnetare

Gjatë vitit 2014, AMF ka miratuar kërkesat e shoqërive të sigurimit në lidhje me ndryshimet statutore, si më poshtë:

**Tabelë 28: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutore** *(Në numër shoqërish)*

| *Arsyeja e ndryshimit të statutit* | *2012* | *2013* | *2014* |
|---|---|---|---|
| Statut i ri e ndryshime të tjera | 0 | 0 | 1 |
| Rritje kapitali | 1 | 1 | 1 |
| Ndryshim i strukturës aksionare | 0 | 1 | 1 |

## 3.2 Mbrojtja dhe edukimi i konsumatorëve

Një objektiv shumë i rëndësishëm i AMF-së është mbrojtja e konsumatorit në tregjet financiare në mbikëqyrjen e AMF-së. Për realizmin e këtij objektivi, Autoriteti ka një njësi funksionale të specializuar për trajtimin e problematikave që kanë konsumatorët në përputhje me kuadrin ligjor rregullator në fuqi.

Gjatë vitit 2014, në Autoritet kanë ardhur 34 ankesa, nga persona fizikë, ente shtetërore apo subjekte juridikë. Ankesat lidhen kryesisht me pretendime për pagesën e dëmshpërblimeve në sigurime që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm, apo për pagesa nga Fondi i Kompensimit, si edhe kërkesa për interpretime.

**Grafik 25: Ankesat dhe zgjidhjet 2007-2014** *(Në numër)*




AMF përdor forma të ndryshme komunikimi dhe informimi të konsumatorit, pasurimi në vazhdimësi i të cilave inkurajon dhe rrit besimin e konsumatorit në rolin e AMF-së.

**Mekanizmat e AMF-së për realizimin e transparencës, komunikimit efektiv me publikun dhe edukimin financiar**

- Sistemi telefonik i ndihmës së konsumatorëve. Ky sistem përfshin numrin e komunikimi me telefoninë fikse, (355 4 2257 557) numrin e telefonit jeshil pa pagese për konsumatorin (0800 6969), sistemin e sms falas për kontaktet (355 694060671) dhe adresën elektronike të e-mail (konsumatori@amf.gov.al).
- Faqja *online* e AMF-së www.amf.gov.al pasqyron në mënyrë të vazhdueshme informacionin lidhur me bazën ligjore të përditësuar për tregjet nën mbikëqyrje, njoftimet për veprimtarinë vendimmarrëse të Bordit të Autoritetit.
- Faqja *online* pasqyron informacion për subjektet që veprojnë në tregjet e mbikëqyrura duke dhënë formën e organizmit dhe stafin drejtues ekzekutiv.
- Në rubrika të veçantë në faqen *online* pasqyrohen informacione edukuese për konsumatorin si edhe njoftime për zhvillimet e reja në vendet e rajonit për këto tregje, nëpërmjet publikimeve të përmuajshme të lajmeve.

# Kapitulli 4
# Transparenca dhe bashkëpunimi institucional

## 4.1 Transparenca dhe marrëdhëniet me publikun

Aktiviteti i AMF-së është pasqyruar në mënyrë të vazhdueshme në median e shkruar dhe elektronike, por më gjerësisht në gazetat me tirazh më të lartë. Informacionet mbi tregun e sigurimeve kanë qenë të përhershme në media dhe sidomos ato që lidheshin me ndryshimet në tarifat e sigurimit të detyrueshëm motorik dhe ecurinë e proceseve teknike për të filluar tarifimin me bazë rreziku, mundësinë e zbatimit të sistemit *Bonus-Malus*, etj. Informacionet mbi tregun e sigurimeve gjatë vitit 2014 u zgjeruan edhe me pasqyrimin e projektit të filluar për sigurimin ndaj katastrofave natyrore dhe mundësitë që ofron tregu i sigurimeve në këtë drejtim, në Shqipëri. Pasqyrim në media kanë pasur edhe informacionet mbi pensionet private vullnetare, ecuria e fondeve të investimeve dhe tregtimi i letrave me vlerë. Ky mbulim mediatik është shprehur në mbi 250 prezantime në gazetat e përditshme, si edhe 50 informacione në edicionet e lajmeve në televizionet me mbulim kombëtar dhe rajonal. Këto shifra pasqyrojnë edhe rritjen e interesit dhe pasqyrimit në media nga viti në vit me mbi 76% të aktiviteteve të AMF-së dhe situatës së tregjeve nën mbikëqyrje krahasuar me vitin 2013.

Komunikimet e Drejtores së Përgjithshme Ekzekutive me subjektet aktive në tregjet nën mbikëqyrje dhe grupet e interesit kanë pasur vëmendje të veçantë. Në këto takime është theksuar roli i tregjeve që AMF mbikëqyr dhe pesha e tyre në tregun financiar të vendit si edhe zhvillimet legjislative me hyrjen në fuqi të ndryshimeve në ligjin për AMF-në dhe e ligjit për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit. Në Forumin e II-të Financiar, në mars 2014, me pjesëmarrjen e ekspertëve të BB, FMN e institucione të tjera, Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së prezantoi perspektivat e zhvillimit për tregun e letrave me vlerë dhe të pensioneve private vullnetare në Shqipëri.

Krahas komunikimit të drejtpërdrejtë me median, AMF komunikon edhe përmes faqes zyrtare të internetit, buletineve mujore informuese për tregjet e mbikëqyrura, botimeve periodike vjetore, fletëpalosjeve, etj. Faqja zyrtare e AMF-së www.amf.gov.al është pasuruar me informacion të përditësuar me zhvillimet më të fundit të tregjeve. Këto informacione janë mjaft të vlefshme si për shoqëritë e sigurimit ashtu edhe për publikun si konsumator i këtyre shërbimeve.

Gjatë vitit 2014 në faqen *online* të AMF-së ka pasur 315,785 klikime dhe rreth 33% e tyre kanë qenë vizitorë të rinj, që kanë hyrë për herë të parë. Duke ju referuar informacioneve të vendosur në faqen *online,* pjesa më e madhe e përdoruesve lexojnë lajmet në faqen kryesore si njoftimeve periodike, publikime dhe informacionet statistikore për tregjet nën mbikëqyrje. Këto informacione janë vrojtuar nga mbi 70% e vëzhguesve të faqes *online.* Legjislacioni, rregulloret, procedurat, vendimit e Bordit të AMF-së janë vrojtuar nga mbi 16% e vizitorëve të faqes *online.*

**Grafik 26: Struktura e klikimeve në faqen online të AMF-së, 2014** *(Në %)*




Faqja është e organizuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht dhe në këtë mënyrë ajo i shërben edhe investitorëve apo analistëve të huaj si burim informacioni për strukturën dhe zhvillimin e tregjeve financiare të sigurimeve, pensioneve private dhe letrave me vlerë në Shqipëri. Mbi 10% e vizitorëve në faqe *online* kanë hyrë nga vende si nga Bullgaria, SHBA, Italia, Anglia, Austria, Greqia e Gjermania.

**Botimet e AMF-së**

- Raporti Vjetor
- Raporti i Mbikëqyrjes
- Gjeografia e Sigurimeve
- Buletini Zyrtar
- Fletëpalosje për tregjet nën mbikëqyrje

**Publikime elektronike të AMF-së**

- Periodiku mujor informativ
- Buletini Statistikor i tregut të sigurimeve
- Buletini Statistikor i tregut të letrave me vlerë
- Buletini Statistikor i tregut të pensioneve private vullnetare

## 4.2 Bashkëpunimi institucional

### Bashkëpunimi me institucionet e vendit

Rritja e bashkëveprimit të rregullatorëve të ndryshëm ekonomikë dhe financiarë është vënë në qendër të proceseve që promovojnë nxitjen e shëndoshjen financiare të tregjeve. Nisur nga ky këndvështrim AMF ka bashkëpunuar ngushtësisht me institucionet e tjera ekonomike të vendit, rajonit e më gjerë për zhvillimin e rregullimin e tregut të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private vullnetare.

Në funksion të forcimit të tregut të sigurimeve, dhe specifikisht për sigurimet e detyrueshme motorike, AMF ka punuar ngushtësisht me **Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit si edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor.** Në sajë edhe të marrëveshjeve të realizuara më parë me këto institucione, bashkëpunimi ka mundësuar kontrollin e zbatimit të legjislacionit për sigurimin e detyrueshëm, evidentimin e saktë dhe pajisjen e mjeteve motorike që lëvizin në territorin e Republikës së Shqipërisë me kontrata sigurimi të vlefshme.

Në kuadrin e liberalizimit të tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik, AMF ka vënë në dispozicion gjithë informacion e kërkuar nga **Autoriteti i Konkurrencës** për ta ndihmuar atë në punën investiguese në tregun e sigurimeve.

Ndërkohë peshën kryesore e ka pasur bashkëpunimi dypalësh ndërmjet AMF-së dhe Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave apo Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, si dhe shumëpalësh ndërmjet tyre në kuadër të GKSF-së (takimet tremujore) dhe të grupit teknik (takimet mujore). Thelbi i procesit të bashkëpunimit gjatë vitit 2014 ka qenë ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve të FSAP-it, veçanërisht i atyre rekomandimeve zbatimi i të cilave bie në fushën e veprimit të këtyre institucioneve, siç ishin paketa ligjore; trajtimi fiskal i produkteve të sigurimeve dhe të pensioneve; masat stabilizuese, etj.

### Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare

AMF është anëtare e **Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve, (IAIS)**, që prej vitit 2001. Ky anëtarësim ka synuar të ndihmojë në thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar mes autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve.

Gjatë vitit 2014, AMF vazhdoi pjesëmarrjen në mënyrë aktive në aktivitetet e IAIS. Kryetarja e AMF-së është anëtare e Nënkomitetit të Përfshirjes Financiare *(Financial Inclusion Subcommittee)* i cili promovon në veçanti tregjet dhe ekonomitë në zhvillim lidhur me zbatimin e Parimeve Themelore të sigurimeve për të mbështetur rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve të sigurimeve dhe forma të tjera të veçanta të sigurimit.

**Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me IAIS**

- Mbledhje të Nënkomiteteve të Punës, mars;
- Seminar: *"Vlerësimi i mjaftueshmërisë së kapitalit të siguruesve në një regjim me bazë rrezikun"*, mars;
- Seminari: *"Grupet e sigurimeve dhe dobësitë e sistemit në tërësi"*, qershor;
- Konferenca aktuariale për mbikëqyrësit e sigurimeve, qershor;
- Seminari i 10-të Ndërkombëtar mbi *"Çështje bazë të mbikëqyrjes"*, korrik;
- Seminar Rajonal: *"Mbikëqyrja me bazë rrezikun për tregje të shëndetshme e transparente në sigurime"*, tetor;
- Konferenca Vjetore, 2014 *"Rritja e mbrojtjes konsumatore dhe stabilitetit financiar përmes qeverisjes dhe menaxhimit të rrezikut"*, tetor.

AMF është anëtare me të drejta të plota në **Organizatën Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë, (IOSCO)** dhe njëkohësisht nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të IOSCO-s që prej vitit 2009. Ajo ka qenë e angazhuar në plotësimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja në këtë organizatë dhe vazhdon të plotësojë kuadrin rregullator me qëllim përafrimin me standardet e parimet e IOSCO-s. AMF është gjithashtu pjesëmarrëse aktive në Komitetin Evropian të IOSCO *(European Regional Committee, ERC)* dhe e Komitetin e Tregjeve në Rritje e Zhvillim *(Growth and Emerging Markets Committee, GEM)*.

**Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me IOSCO**

- Mbledhje të Komitetit Rajonal Evropian, shkurt, maj, dhjetor;
- Seminar: "*Progresi: sfidat në kuadrin rregullator të letrave me vlerë dhe zgjidhjet praktike për kalimin e këtyre sfidave*", qershor;
- Seminar: *"Bashkëpunimi rregullator në lidhje me shkeljet globale dhe ndërkufitare në fushën e letrave me vlerë, si dhe roli e përdorimi i MMoU-së"*, tetor;
- Mbledhja Vjetore, 2014 *"Financimi në bazë të tregut për rritjen globale ekonomike-një qasje për të ecur përpara"*, tetor;
- Seminar: *"Çështje të librit të shitjeve dhe infrastruktura e tregut"*, tetor;
- Seminar: *"Zhvillimi i tregjeve të obligacioneve të korporatave në vendet në zhvillim"*, nëntor.

AMF është anëtare e **Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve, (IOPS),** që prej vitit 2006.

**Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me IOPS**

- Mbledhje të Komiteteve Ekzekutive dhe Teknike, shkurt;
- Seminar i përbashkët IOPS/ IAIS: *"Sfidat Rregullatore dhe Mbikëqyrëse në Industrinë e Pensioneve në Islandë"*, shkurt;
- Mbledhje të Komiteteve Ekzekutive dhe Teknike, qershor;
- Mbledhja e përbashkët e Grupit të Punës së OECD/IOPS mbi Pensionet Private, qershor;
- Mbledhja e Komitetit Teknik, Mbledhja e Përgjithshme Vjetore dhe Forumi Global OECD/IOPS mbi pensionet private, tetor.

Pjesëmarrja e AMF-së në këto aktivitete konsiston në angazhimin për hartimin e dokumenteve politikë dhe studimorë. Gjatë vitit 2014, AMF ka kontribuar si pjesëmarrëse në grupin e punës për materialin e diskutimit të IOPS "Roli i përllogaritjeve aktuariale në mbikëqyrjen e pensioneve", duke dhënë informacion lidhur me praktikat e ndjekura aktualisht në tregun shqiptar të pensioneve private.

**Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare, financiare dhe donatorët**

Projektet strategjike dhe rritja e kapaciteteve institucionale të AMF-së është mbështetur edhe gjatë vitit 2014 nga bashkëpunimi dhe marrëdhëniet efektive me institucionet ndërkombëtare, financiare dhe donatorët.

Në kuadër të mbikëqyrjes së Shqipërisë nga **Komiteti MONEYVAL** i Këshillit të Evropës, mbi masat e marra në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit, AFM mori pjesë në Sesionin e 45-të të Komitetit MONEYVAL mbi masat e marra në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit. AMF raportoi pranë Komitetit MONEYVAL për masat e marra dhe shkallën e përmbushjes së tyre në drejtim të vlerësimit të rreziqeve të pastrimit të parave dhe luftës kundër terrorizmit, si pjesë e punës së këtij institucioni për monitorimin e rekomandimeve të dhëna. Rreziqet e identifikuara janë duke u shqyrtuar në vazhdimësi për të vlerësuar ndryshimet përkatëse, si dhe për identifikimin e zonave të reja të mundshme që kërkojnë vëmendje të mëtejshme nga AMF.

**Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare (FSVC/USAID)**, ndër vite ka ndihmuar AMF në projekte të ndryshme, në forcimin e rolit mbikëqyrës dhe rregullator, si edhe për zhvillimin e burimeve njerëzore. Ky organizëm vazhdon të mbetet një ndër partnerët kryesorë të AMF-së, në drejtim të asistencës teknike.

Gjatë 2014 FSVC mbështeti projektin: *"Sistemi i paralajmërimit të hershëm në zbatim të metodologjisë me fokus rrezikun"*, që synon forcimin e mëtejshëm të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve në Shqipëri. Ky sistem do të mbështesë metodologjinë e re të mbikëqyrjes me fokus rrezikun. Në kuadër të këtij projekti e në vazhdimësi janë zhvilluar takime pune me ekspertë të këtij institucioni dhe puna do të vazhdojë deri në finalizimin e tij me asistencën e FSVC.

Me mbështetjen e FSVC-së në muajin maj u zhvillua vizita studimore me takime pune të nivelit të lartë në disa institucione të rëndësishme financiare gjermane dhe ndërkombëtare si: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Federale të Gjermanisë (BaFin), Shoqata e Siguruesve të Gjermanisë (GDV), Agjencia Federale për Stabilitetin e Tregjeve Financiare Gjermane (FMSA), Banka Qendrore Evropiane (ECB) si dhe Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA). Eksperiencat e institucioneve të specializuar lidheshin me tematikat si zhvillimi i tregut të sigurimeve dhe organizimi efikas i fondit të kompensimit, stabiliteti financiar dhe bashkërendimi i veprimtarisë së autoriteteve rregullatore financiare, administrimi i situatave në raste të krizave, zhvillimi i standardeve mbikëqyrëse në kuadër të organizmave evropiane dhe ndikimi i tyre në tregjet që aspirojnë të jenë pjesë e BE-së si rasti i Shqipërisë.

Gjatë vitit 2014, me mbështetjen e FSVC specialistë të mbikëqyrjes në AMF morën pjesë në trajnimin për të mbështetur luftën kundër pastrimit të parave. Në këtë trajnim i cili u zhvillua në bashkëpunim me **Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)** u diskutuan specifikat e punës së këtyre dy institucioneve në luftën kundër pastrimit të parave në tregun e sigurimit. Kjo i shërben forcimit të rolit mbikëqyrës të AMF-së në inspektimet në vend, për të ndjekur përputhshmërinë e veprimtarisë së shoqërive me dispozitat e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave si edhe programet që duhet të kenë shoqëritë në këtë drejtim.

**Banka Botërore** mbetet një partner i rëndësishëm strategjik që mbështet Autoritetin në përmbushje të misionit themelor. Në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të FSAP, në korrik 2014 nisën dy projekte të asistencës teknike, mbështetur nga Programi **First Initiative**. Projektet shtrihen në dy tregje që mbikëqyren nga AMF, konkretisht tregu i sigurimeve dhe tregu i fondeve të pensioneve private vullnetare. Objektivi kryesor në të dy tregjet është forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së, bazuar në rrezik. Si objektiva të tjerë këto projekte kanë nxitjen e zhvillimit të këtyre tregjeve. Gjatë periudhës korrik – dhjetor 2014, për të dyja projektet u bënë vlerësimet diagnostikuese të gjendjes së tregjeve dhe nevojave që ka AMF.

Gjithashtu, për shkak të rritjes së peshës së tregjeve financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së dhe ndërthurjes së rreziqeve me sistemin bankar, çështjet në këto tregje, veçanërisht në tregun e fondeve të investimeve janë përfshirë për herë të parë edhe në axhendën e diskutimeve të rregullta që mbahen me FMN-në dhe misioneve të tij të asistencës teknike.

## Bashkëpunimi rajonal

Edhe gjatë vitit 2014, bashkëpunimi me institucionet homologe të rajonit ka qenë mjaft i rëndësishëm në drejtim të përmbushjes së rolit të AMF-së për një mbikëqyrje sa më efektive të tregjeve financiare jobankare.

Një partner mjaft i rëndësishëm i AMF-së në zhvillimin e tregjeve financiare nën mbikëqyrje prej vitesh është **Autoriteti i Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA).** Bashkëpunimi me FMA, është konsoliduar ndër vite edhe materializuar me takime të shpeshta të drejtuesve të lartë të institucioneve, si edhe të stafeve teknike. Prej vitit 2009, të dy institucionet kanë një marrëveshje mirëkuptimi, e lidhur menjëherë pas investimeve të grupeve austriake të sigurimeve në Shqipëri. Mbi këtë bazë janë ndërtuar marrëdhënie të suksesshme ndërmjet dy institucioneve, duke u konkretizuar me shkëmbim përvoje dhe punë të përbashkët në mbikëqyrjen e grupeve austriake që operojnë në Shqipëri.

Në këtë kuadër, Z. Peter Braumüller, Drejtor Ekzekutiv në FMA, përgjegjës për mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit, bëri një vizitë pune në muajin korrik pranë zyrave të AMF-së dhe zhvilloi takime me drejtues të AMF. Objekti i takimit lidhej me vlerësimin e sistemit financiar në juridiksionet respektive si dhe drejtimet kryesore të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve. Po kështu, u diskutuan çështje të përbashkëta për mbikëqyrjen e grupeve austriake të sigurimeve, të cilat kanë prezencë dominuese në tregun shqiptar të sigurimeve, proces ky që koordinohet tashmë në nivel rajonal nga FMA. Kështu, me ftesë të FMA-së, që prej vitit 2014, AMF është pjesëmarrëse e rregullt e kolegjeve mbikëqyrëse për këto grupe dhe ekspertët e departamentit të mbikëqyrjes të AMF-së morën pjesë në mbledhjet e Kolegjit të Mbikëqyrjes për shoqërinë UNIQA Insurance Group (UIG) dhe Vienna Insurance Group (VIG).

AMF ka bashkëpunuar ngushtë me **Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë (ISA)**. Marrëveshja e Mirëkuptimit midis të dy institucioneve që është në veprim prej vitit 2010 ndikon pozitivisht në efikasitetin e mbikëqyrjes dhe rregullimit të industrisë së sigurimeve të të dy vendeve sidomos në kushtet e shtrirjes së veprimtarisë të kompanive shqiptare të sigurimit në territorin e Maqedonisë. Përfaqësues nga AMF morën pjesë në Konferencën Aktuariale organizuar nga ISA të zhvilluar në qershor, në Ohër. Konferenca e vuri theksin në te gjitha aspektet e punës së aktuarit në një shoqëri sigurimesh si edhe roli i aktuarit në qeverisjen e  korporatave në sigurimeve.

**Veprimtaritë kryesore të bashkëpunimit institucional**

**CESEE –** "Nisma Rajonale e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve"

- Takimi i 7-të - Fokus në krijimin e një strukture mbikëqyrëse efektive, shkëmbimin e përvojave me mekanizma alternative të zgjidhjes së kontestimeve në sigurime, luftën kundër pastrimit të parave, rolin e auditit të jashtëm në sigurime, vendimet mbikëqyrëse dhe sfidat, zbatueshmërinë, Ohër, Maqedoni, qershor;
- Takimi i 8-të - Fokus në krijimin e një strukture mbikëqyrëse efektive bazuar në rrezik, shkëmbimin e përvojave në zbatimin e standardeve ndërkombëtare, sigurimi i detyruar i pronës dhe skemat e garancisë si një mekanizëm për mbrojtjen nga rreziqet, Chisinau, Moldavi, tetor.

**USAID/FSVC**

- Seminar: *"Pastrimi i parave në tregjet financiare"* shtator.

**BB**

- Konferenca e 6-të ndërkombëtare mbi Pensionet dhe Kursimet, prill;
- Fillon projekti i asistencës teknike për reformën në tregun e sigurimeve, korrik;
- Fillon projekti i asistencës teknike për mbikëqyrjen dhe zgjerimin e tregut të pensioneve private vullnetare në vend, korrik.

**Europa Re**

- Konferencën e dytë Rajonale me temë *"Gjenerata e re dhe zgjidhjet në sigurime"*, tetor.

**EIOPA & BB**

- Seminar: *"Mbikëqyrja me bazë rrezikun"*, shtator.

**EIOPA/ICIR/BB/Universiteti St. John (St. John's University)**

- Konferenca mbi mbikëqyrjen globale të sigurimeve, shtator.

"Iniciativa Rajonale për Mbikëqyrjen e Tregut të Sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore", **(CESEE)**, ka vazhduar të mbështesë shkëmbimin e informacionit dhe përvojave më të mira midis stafeve të autoriteteve rregullatore në tregun e sigurimeve. Gjatë 2014 janë zhvilluar takimi i shtatë dhe i tetë i kësaj iniciative. Në takimin e 7-të të Iniciativës CESEE çështjet e trajtuara lidhen me krijimin e një strukture mbikëqyrëse efektive, shkëmbimin e përvojave me mekanizma alternative të zgjidhjes së kontestimeve në sigurime, luftën kundër pastrimit të parave, rolin e auditit të jashtëm në sigurime, etj. Në takimin e 8-të u trajtuan problematikat lidhur me krijimin e një strukture

mbikëqyrëse efektive bazuar në rrezik, shkëmbimin e përvojave në zbatimin e standardeve ndërkombëtare, sigurimin e detyruar të pronës dhe skemat e garancisë si mekanizëm për mbrojtjen nga rreziqet.

## Bashkëpunimi me institucione homologe

AMF mban një komunikim të vazhdueshëm me autoritetet homologe nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimtaritë e organizuara për përditësimin me tendencat më të fundit rregullative dhe mbikëqyrëse dhe shkëmbimit të përvojave të ndërsjella.

Gjatë vitit 2014, AMF thelloi bashkëpunimin me **Autoritetin Federal të Mbikëqyrjes Financiare të Gjermanisë (BaFin)** në drejtim të rritjes së kapaciteteve mbikëqyrëse në fushën e fondeve të investimeve. Në mars 2014 u organizuan konsultime mbi mbikëqyrjen e fondeve të investimeve në bashkëpunim me BaFin dhe me mbështetjen e FSVC. Konsultimet u fokusuan tek mbikëqyrja e likuiditetit të fondeve të investimit, studimi i disa praktikave të manipulimit të tregut, kuadri rregullator në BE, etj.

Në përputhje me strategjinë për forcimin e bashkëpunimit me institucione homologe në rajon, AMF ka krijuar bashkëpunim me **Autoritetin e Shërbimeve Shtetërore të Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Gjeorgjisë (LEPL)**. Në nëntor një delegacion nga LEPL dhe Parlamenti i Gjeorgjisë zhvilluan një vizitë pune pranë zyrave të AMF-së. Vizita u iniciua nga Autoriteti i Gjeorgjisë me synimin për të marrë eksperiencën shqiptare në drejtim të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregut të sigurimeve, më specifikisht zhvillimet në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik. Për këtë qëllimi u zhvillua *workshopi* me pjesëmarrje nga përfaqësuesit e AMF-së dhe Autoritetit të Gjeorgjisë lidhur me sigurimi motorik, regjistrin elektronik *online* të shitjeve dhe dëmeve, aspektet aktuariale në përllogaritjen e primeve dhe sistemi *Bonus-Malus*, aktiviteti në mbrojtjen e konsumatorëve, analiza financiare e treguesve të shoqërive të sigurimit, metodologjia e përdorur dhe treguesit e paralajmërimit të hershëm, inspektimi në vend i shoqërive të sigurimit, organizimi dhe funksionimi i autoritetit mbikëqyrës, etj.

# Kapitulli 5
# Organizimi i brendshëm

## 5.1 Pasqyrat Financiare

### Auditimi

Duke nisur nga viti 2007 e në vazhdim, pasqyrat financiare vjetore të AMF-së auditohen nga ekspertë kontabël të autorizuar, pavarësisht se një gjë e tillë nuk buronte nga detyrime ligjore. Bazuar në ndryshimet e Ligjit nr. 54/2014, datë 29.05.2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", Bordi miraton ekspertin kontabël ose shoqërinë audituese të Autoritetit.

Funksioni i auditimit të brendshëm në AMF kryhet nga një specialist auditimi, i pajisur me certifikatën e audituesit të brendshëm të sektorit publik, i cili raporton te Kryetari dhe te Bordi i Autoritetit. Në vitin 2014, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përmbushur të gjitha angazhimet e planifikuara të auditimit. Në bazë të gjetjeve të auditimeve të kryera, gjatë vitit 2014, janë dhënë 11 rekomandime, të cilat u janë raportuar njësive të audituara, si dhe Bordit të AMF-së. Urdhëri i Kryetarit është nxjerrë për të gjitha rekomandimet e lëna nga auditimi i brendshëm dhe mbi 91% e tyre janë vënë në zbatim.

### Buxheti

Përcaktimi i buxhetit bazohet në dispozitat ligjore në fuqi dhe konkretisht Ligjit nr. 54/2014, datë 29.05.2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare". AMF edhe gjatë vitit 2014 ka vazhduar të financohet tërësisht nga burimet e veta.

Të ardhurat gjithsej të AMF-së për vitin 2014 ishin 225.58 milionë lekë ose 61% më shumë krahasuar me vitin 2013. Pothuajse të gjitha të ardhurat e realizuara, 222.95 milionë lekë përftohen nga veprimtaria e vitit, nga tarifat e derdhura nga subjektet e mbikëqyrura, pjesa tjetër ka ardhur nga gjobat dhe interesat bankare, në masën 2.63 milionë lekë.

Kontributi kryesor brenda grupit të të ardhurave të veprimtarisë i përket të ardhurave të përfituara nga tarifat e paguara prej subjekteve të tregut të sigurimeve, të cilat përbëjnë 79.70% të të ardhurave gjithsej. Niveli i realizimit të të ardhurave nga këto tarifa është rreth 48.50% më shumë se viti 2013, si rrjedhojë e rritjes së volumit të primeve të shkruara bruto në këtë treg.

**Tabelë 29: Burimet e fondeve të AMF-së** *(Në mijë lekë)*

| *Emërtimi* | | *2013* | *2014* |
|---|---|---|---|
| **1. Të ardhura nga veprimtaria** | | **139,420** | **222,951** |
| 1.1 | Të ardhura nga tregu i sigurimeve | 120,841 | 179,538 |
| | 1.1.1 Të ardhura nga kontributet e shoqërive të sigurimit | 119,176 | 177,383 |
| | 1.1.2 Të ardhura nga licencime në tregun e sigurimit | 1,665 | 2,155 |
| 1.2 | Të ardhura nga tregu i letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve | 18,384 | 43,083 |
| 1.3 | Të ardhura nga kontributet e shoq. admin. të fondeve të pensioneve private | 195 | 330 |
| **2.** | **Të ardhura nga gjobat dhe interesat bankare** | **306** | **2,635** |
| Totali (1+2) | | 139,726 | 225,586 |

**Grafik 27: Struktura e të ardhurave sipas tregjeve nën mbikëqyrjen e AMF-së, 2012-2014** *(Në %)*



**Tabelë 30: Përdorimi i fondeve të AMF-së** *(Në mijë lekë)*

| *Emërtimi* | *2013* | *2014* |
|---|---|---|
| **1. Shpenzime funksionimi** | **110,430** | **108,251** |
| 1.1 Paga, shpërblime, sigurime shoqërore | 70,888 | 70,664 |
| 1.2 Shpenzime operative | 39,542 | 37,587 |
| **2. Investime** | **3,446** | **3,012** |
| 3. Fond rezervë | - | 70,398 |
| 4. Fonde të regjistruara për periudhat e ardhshme | 25,850 | 43,925 |
| **Totali (1+2+3+4)** | **139,726** | **225,586** |

Gjatë vitit 2014 të ardhurat e përdorura gjithsej ishin 111.26 ose 5% më pak se një vit më parë. Shpenzimet e funksionimit përbëjnë përdorimin kryesor të të ardhurave të AMF-së, duke zënë 97.29% të shpenzimeve gjithsej. Për vitin 2014 ato janë realizuar në masën 108.25 milionë lekë ose 5% më pak se viti 2013. Shpenzimet për investime në vitin 2014 janë realizuar në masën 3.01 milionë lekë ose 11.10% më pak se në vitin 2013.

**Grafik 28: Dinamika e ndryshmit të të ardhurave dhe shpenzimeve të AMF-së, 2012-2014**[13] *(Në %)*




Shënim: [13]Në grafik viti 2011 është konsideruar si viti bazë, prandaj vlerat e tij paraqiten me 0.

Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, AMF krijoi për herë të parë, në vitin 2014, Fondin Rezervë. Në këtë fond do të alokohet diferenca pozitive ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit ushtrimor, që për vitin 2014 është afërsisht në masën 70.40 milionë lekë.

Në zbatim të planit të investimeve, AMF ka hartuar e zbatuar edhe planin e prokurimeve, i cili gjatë vitit 2014, përmbante 5 procedura prokurimi me tenderim, ndërsa mbulimi i nevojave të tjera është realizuar me prokurime me vlera të vogla. Të gjitha procedurat e planifikuara të prokurimit janë realizuar.

## 5.2. Struktura organizative e kualifikimi profesional

AMF funksionon në bazë të strukturës së miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me Vendim nr. 98, datë 30.04.2007 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare", me propozim të Bordit të Autoritetit dhe ka 58 punonjës. Në fund të vitit 2014, shkalla e plotësimit të vendeve të punës në AMF, e matur me numrin e vendeve të punës sipas strukturës së miratuar dhe për të cilat janë punësuar punonjësit, ka arritur në 87%.

Numri i punonjësve që i përkasin njësive që kryejnë funksione kryesore të AMF-së, të tilla si licencimi, rregullimi e mbikëqyrja gjatë vitit 2014 zinte rreth 80%. Në këtë grup janë përfshirë edhe të emëruarit në nivelet drejtuese. Pjesa tjetër, rreth 20% janë punonjës të angazhuar në funksionet mbështetëse, që mundësojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të institucionit.

**Grafik 29: Struktura e punonjësve të funksioneve kryesore sipas njësive** *(Në %)*



**Grafik 30: Struktura e punonjësve sipas profesionit** *(Në %)*




Struktura aktuale organizative ka mundësuar ruajtjen e një hierarkie të përshtatshme për punonjësit dhe mbulimin e funksioneve të AMF-së. Megjithatë, prirjet e zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje dhe sfidat që shtrohen për mbikëqyrjen dhe rregullimin e tyre, sjellin domosdoshmërinë për ndryshime strukturore. Zhvendosja në kohë e konstituimit të Bordit të ri të Autoritetit, mbështetur në ndryshimet në Ligjin nr. 54/2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" nuk mundësoi miratimin e strukturës së Autoritetit, e cila ishte parashikuar të miratohej brenda vitit 2014.

Garantimi i një strukture organizative fleksibël si dhe forcimi i kapaciteteve administrative të AMF-së është dhe mbetet një kërkesë e vazhdueshme e Bankës Botërore dhe Komisionit Evropian, në funksion të një mbikëqyrjeje efektive.

**Grafik 31: Struktura e punonjësve të AMF-së sipas grupmoshës** *(Në %)*



**Grafik 32: Struktura e punonjësve sipas diplomimit** *(Në %)*




AMF edhe gjatë vitit 2014, është kujdesur të ruajë raporte optimale në strukturën e punonjësve bazuar në tiparet e tyre si arsimimi apo mosha. Ruajtja prej disa vitesh e nivelit të moshës mesatare në 39 vjeç, ka sjellë harmonizimin më të mirë të cilësive të brezave të ndryshëm dhe ka siguruar transmetim të pandërprerë të njohurive dhe përvojës.

## Politikat e burimeve njerëzore dhe kualifikimi profesional

Zhvillimi i burimeve njerëzore në AMF i shërben rritjes së kapacitetit profesional të punonjësve në përputhje me misionin dhe objektivat strategjikë të Autoritetit. Gjatë vitit 2014, janë shfrytëzuar mekanizmat nxitës dhe motivues siç janë sistemi i ndihmave ekonomike, sistemi i diferencuar i shpërblimeve për arritjen e rezultateve në punë, vijimi i planit profesional të pensionit vullnetar për punonjësit e Autoritetit.

Me qëllim rritjen e ekspertizës profesionale, edhe gjatë vitit 2014 u ruajt përgjithësisht linja e specializimit të punonjësve në profilin ku ata punojnë. Rreth 75% e stafit teknik ka marrë pjesë aktive në trajnime, seminare, si dhe mbledhje e konferenca të organizuara brenda dhe jashtë vendit, duke arritur një tregues me rreth 4 ditë pjesëmarrje në aktivitete për çdo punonjës.

Programi i trajnimeve është ndërtuar në përshtatje me objektivat e institucionit dhe objektivat individualë për punonjësit. Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2014, brenda dhe jashtë vendit, kanë konsistuar në pjesëmarrje në trajnime, seminare, konferenca, takime, si dhe vizita në shkëmbimin e përvojave më të mira profesionale, mbështetur në asistencën e institucioneve prestigjioze ndërkombëtare në fushën financiare si: Banka Botërore, Këshilli i Evropës, USAID nëpërmjet Programit të Zhvillimit të Sektorit Financiar në Shqipëri. Pjesëmarrje në trajnime ka pasur edhe në aktivitetet e shoqatave ndërkombëtare të rregullatorëve ku AMF është anëtare si IAIS, IOSCO, IOPS, si edhe Shoqatës Kombëtare

të Komisionerëve të Sigurimeve e SHBA-së (NAIC), Komisionit të Letrave me Vlerë, të SHBA-së *(Securities and Exchange Commission, SEC)* etj.

Trajnimet kanë pasur si tematikë kryesore tregun e sigurimeve, pasi ai është edhe tregu më i madh në vend. Po ashtu trajnime janë zhvilluar edhe në tregjet e tjera që AMF mbikëqyr. Në kuadër të asistencës për tregun e sigurimeve dhe pensioneve, AMF në bashkëpunim me BB ka zhvilluar disa projekte të rëndësishme që lidhen drejtpërsëdrejti me funksionet mbikëqyrëse dhe rregulluese të tregjeve nën mbikëqyrje.

Prej disa vitesh radhazi, AMF përdor trajnimin *online* të programit *"FSI Connect"*. Nëpërmjet 5 pozicioneve përdoruesish *online* të këtij programi, AMF ka synuar dhënien e njohurive të reja dhe thellimi më tej të tyre, për të gjitha nivelet e punonjësve në AMF në drejtim të mbikëqyrjes në fushën e sigurimeve.

**Tematikat kryesore të trajnimeve gjatë vitit 2014**

- Mbikëqyrja efektive e tregjeve të kapitalit, shkurt;
- Sfidat rregullatore dhe mbikëqyrëse në industrinë e pensioneve, shkurt;
- Bashkëpunimi rregullator në lidhje me shkeljet globale dhe ndërkufitare në fushën e letrave me vlerë, shkurt.
- Vlerësimi i mjaftueshmërisë së kapitalit të siguruesve në një regjim me bazë rrezikun, mars;
- Mbikëqyrja me fokus rrezikun, maj;
- Standardet kombëtare të kontabilitetit, qershor;
- Progresi, sfidat në kuadrin rregullator të letrave me vlerë dhe zgjidhjet praktike, qershor;
- Mbikëqyrja me bazë rrezikun për tregje të shëndetshme e transparente në sigurime, tetor;

## 5.3 Kuadri rregullues i AMF-së

Gjatë vitit 2014, Kuvendi i Shqipërisë miratoi **Ligjin nr. 54/2014, datë 29.05.2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare"**

Ndryshimet dhe shtesat në këtë ligj synojnë forcimin e rolit mbikëqyrës dhe rregullator të Autoritetit në përmbushje të objektivave të tij, nëpërmjet forcimit të pavarësisë dhe ndërthurjes me përgjegjshmërinë e tij. Ato kanë si qëllim:

- Mbrojtjen e mëtejshme të konsumatorëve;
- Nxitjen e zhvillimin e tregjeve financiare;
- Nxitjen e qëndrueshmërisë së tregjeve financiare;
- Rritjen e shkallës së zbatimit të standardeve dhe kritereve ndërkombëtare të mbikëqyrjes.

Dispozitat e ligjit:

- Rivendosin kompetencat e Bordit të AMF në lidhje me qeverisjen e institucionit, për të qenë në gjendje për t'iu përgjigjur me efektivitet procesit mbikëqyrës dhe rregullator, në mbështetje të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë së tregjeve financiare;
- Forcojnë kërkesat për AMF në lidhje me marrëdhënien me autoritete të tjera mbikëqyrëse dhe ligjzbatuese për çështje të luftës kundër pastrimit të parave, të siguruara nga burime të paligjshme dhe financimit të terrorizmit;
- Qartësojnë mekanizmin mbrojtës për anëtarin e Bordit dhe të punonjësit të AMF-së gjatë ushtrimit të detyrës në mirëbesim, me synim forcimin e pavarësisë dhe integritetit të tyre në kryerjen e detyrës;
- Forcojnë pavarësinë dhe përgjegjshmërinë financiare të AMF-së duke parashikuar krijimin e fondit rezerve, duke specifikuar më qartë grumbullimin e të ardhurave dhe kthimin e tepricave në subjektet e mbikëqyrura, si dhe duke mos parashikuar financim nga buxheti i shtetit.

Ligji i ri nr. 54/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare"" u përafrua me standardet ndërkombëtare dhe Parimet Bazë të IAIS-it, (ICP 1, 2).

Për të rregulluar funksionimin e veprimtarisë së Autoritetit si dhe me qëllim forcimin e rolit të tij mbikëqyrës Bordi miratoi Rregulloren nr. 155, datë 23.12.2014 "Për përcaktimin e elementeve të përllogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre", objekti i së cilës është

përcaktimi i elementeve të përllogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura nga Autoriteti, si dhe procedurat e arkëtimit e rakordimit të tyre.
Gjithashtu u miratuan disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 12, datë 30.01.2013, "Për hartimin, ndjekjen, miratimin dhe zbatimin e buxhetit për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", ndryshuar me Vendim Bordi nr. 156, datë 23.12.2014. Ndryshimet në këtë rregullore erdhën si pasojë e miratimit të ndryshimeve ligjore në Ligjin nr. 54/2014, datë 29.05.2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare".

## 5.4 Teknologjia e Informacionit

Teknologjia e Informacionit (TI) në AMF është zhvilluar në përputhje me strategjinë kombëtare të informatizimit, si pjesë e pandarë e institucionit duke pasur si objekt pune zhvillimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e strukturës informatike.

Gjatë vitit 2014, sistemet kryesore të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në AMF kanë vijuar funksionimin duke siguruar mbështetjen e funksioneve bazë të Autoritetit si mbikëqyrja dhe rregullimi. Sistemet e TI në AMF kanë siguruar edhe koordinimin e punës me institucionet me të cilat AMF ka bashkëpunim për shkëmbimin e informacionit. Gjithashtu, është synuar edhe në zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve të brendshme të instaluara në AMF.

Gjatë vitit 2014 ka vijuar projekti për menaxhimin e dokumentacionit dhe përmbledhja e materialeve të mbledhjeve të Bordit të AMF-së.

Përveç detyrave funksionale të lidhura ngushtësisht me funksionet e mbikëqyrjes, inspektimit dhe rregullimit, gjatë vitit 2014 AMF realizoi:

- Mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës teknike të Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik (Regjistri Elektronik *Online* të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, Regjistri i Dëmeve, përshtatja për aplikimin e strategjisë dhe sistemit *Bonus-Malus*);
- Mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së shërbimeve ndërinstitucionale të dhëna nga AMF;
- Përgatitjen dhe konfigurimin e mëtejshëm të infrastrukturës së brendshme të shërbimeve të AMF;
- Monitorimin e përditësimin e faqes zyrtare *online* të AMF-së;
- Zgjerimin e mirëmbajtjen e lidhjeve Internet dhe shkëmbimit të të dhënave të AMF-së në kuadër të përdorimit në rritje të sistemeve TI;

- Hartimin dhe zbatimin e programeve të sigurisë, duke ruajtur konfidencialitetin, integritetin dhe besueshmërinë e informacioneve të AMF-së.

Gjatë vitit 2014 është projektuar një investim cilësor në *hardware* tek serverat e AMF-së, si bërthama e sistemeve informatike të lidhur ngushtësisht me zhvillimin dhe forcimin tregut. Ky projekt do të vazhdojë zgjerimin e tij edhe gjatë gjashtëmujorit të parë të 2015. Projekti aplikon teknologjinë e gjeneratës së fundit *hyper-v cluster* në çdo komponent përbërës të saj, duke përfunduar *clusterin* e ndërtuar në vitin 2014. Ky përmirësim i aktivitetit të brendshëm, siguron administrimin e vazhdueshëm në nivel *hardware,* aplikimesh, bazë të dhënash, menaxhimin e sigurisë, duke realizuar kështu një ndër objektivat kryesorë të AMF-së për t'i shërbyer sa më mirë konsumatorit në tregjet nën mbikëqyrje.

Gjithashtu është planifikuar edhe zëvendësimi i teknologjisë ekzistuese të telefonisë me teknologjinë VOIP e cila rrit cilësinë dhe redukton kostot e shërbimit.

## Sfida dhe projekte të ardhshme, 2015-2016

Në thelb drejtimet kryesore për zhvillim për periudhën afatmesme (2015-2016) në lidhje me tregjet financiare që mbikëqyren, mbeten të përqendruara te:

- Stabilizimi i tregjeve;
- Zhvillimi dhe nxitja e qëndrueshmërisë së tregjeve;
- Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve, nëpërmjet mbikëqyrjes me fokus rrezikun.

Brenda këtij kuadri të përgjithshëm, AMF për çdo vit zhvillon dhe përsos aspekte të ndryshme, që synojnë në përmbushjen e objektivave kryesore.

Në vitin 2015 vëmendja do të vijojë të përqendrohet në **masat stabilizuese për tregun e sigurimeve,** ku përfshihen specifikisht (i) masa e stabilizimit të financimit dhe përmirësimit të administrimit të fondit të kompensimit dhe (ii) masa e mbajtjes së rezervës monetare në shoqëritë e sigurimit. Të dyja këto masa stabilizuese kanë për qëllim edhe përmirësimin e pagesave për palët përfituese, në përfitim të konsumatorëve.

**Nxitja e zhvillimit dhe qëndrueshmërisë së tregjeve financiare nën mbikëqyrje,** pritet të mbështetet nga masat lehtësuese të miratuara në legjislacionin tatimor gjatë vitit 2014, kryesisht për tregun e sigurimeve dhe të pensioneve vullnetare. Në vijim AMF po ofron bashkëpunimin me institucione të tjera të qeverisë për hartimin e legjislacioneve përkatëse për zgjerimin e gamës së produkteve në fushën e sigurimeve. Në fushën e pensioneve vullnetare po shqyrtohen mënyrat për rritjen e vetëdijësimit të punëdhënësve dhe punëmarrësve për të përdorur produktet që ofron tregu i pensioneve vullnetare. Ndërsa në fushën e fondeve të investimeve, AMF po ndjek me kujdes përmirësimin e komunikimit e të informimit të investitorëve. Gjithashtu, AMF ka për objektiv të hartojë protokollin e mbikëqyrjes së përbashkët me Bankën e Shqipërisë për të mundësuar mbikëqyrjen e konsoliduar në ato veprimtari të institucioneve financiare ku përgjegjësia mbikëqyrëse është e të dy autoriteteve. Me përmbushjen e këtij objektivi synohet të reduktohen mundësitë e transferimit të rrezikut nga një segment në një tjetër të sistemit financiar, apo që rreziqe të caktuara të mbeten pa u mbikëqyrur. Pra në thelb kontribuohet në rritjen e qëndrueshmërisë financiare.

**Mbikëqyrja me fokus rrezikun** në shoqëritë e sigurimit, si dhe shtrirja e metodologjisë në tregjet e letrave me vlerë dhe pensioneve. Në vitin 2014 u hartua baza e nevojshme ligjore dhe rregullatore e mbikëqyrjes me fokus rrezikun në tregun e sigurimeve, si dhe u krye inspektimi i parë sipas kësaj metodologjie. Në vijim mbikëqyrja me fokus rrezikun do të shtrihet në të gjitha shoqëritë e tregut të sigurimeve. Po kështu, në vitin 2015 do të zhvillohen edhe dy testime të rëndësishme:

- Testimi për ndërtimin e sistemit të administrimit dhe të vlerësimit të rrezikut nga shoqëritë e sigurimeve, në bashkëpunim dhe nën orientimin e AMF-së, me synim aplikimin e tyre në vitin 2016;
- Testimi pjesor për vënien në përdorim të sistemit të paralajmërimit të hershëm në AMF, si mjet për administrimin më të mirë të burimeve të mbikëqyrjes.

Përsa i takon tregut të pensioneve vullnetare, AMF po punon për ndërtimin e manualit të mbikëqyrjes me fokus rrezikun që përfshin hapat e identifikimit, përkufizimit, klasifikimit dhe reagimit ndaj rreziqeve në këtë treg.

Ndërsa në fushën e fondeve të investimeve, AMF po punon për plotësimin e kuadrit rregullator për të përmirësuar administrimin e rreziqeve, veçanërisht rrezikut të likuiditetit, dhe vlerësimit të aseteve të tyre sipas praktikave ndërkombëtare.

Në tërësi, vëmendja do të jetë në **forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse** në periudhë afatmesme, të cilat pritet të realizohen përmes:

- Përdorimit në praktikë të pavarësisë së dhënë AMF-së me paketën ligjore të miratuar në vitin 2014. Në vitin 2015 vëmendja do të përqendrohet në ristrukturimin e AMF-së, për të krijuar një strukturë pune dhe ndarje detyrash që të përputhet me objektivat, si dhe duke punësuar një forcë pune në madhësi optimale për të përballuar sasinë e punës që diktojnë këto objektiva;
- Përdorimit në praktikë të pavarësisë financiare të dhënë AMF-së për të trajnuar dhe specializuar punonjësit, si dhe për të bërë të qëndrueshme forcën e punës së institucionit, masë me efekt afatmesëm në afatgjatë.

Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse do të përmbushet edhe nga zbatimi i tre projekteve të asistencës teknike që ka përftuar AMF nga Banka Botërore, për të tre tregjet që mbikëqyren dhe më konkretisht:

- Projekti i asistencës teknike për reformën në tregun e sigurimeve.
- Projekti i asistencës teknike për zgjerimin e tregut dhe mbikëqyrjen pensioneve.
- Projekti i asistencës teknike për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse me fokus zhvillimin e tregut të kapitaleve.

**Projekti i asistencës teknike për reformën në tregun e sigurimeve.** Projekti ka një kohëzgjatje prej 24 muajsh dhe është strukturuar në tre komponentë kryesorë, si më poshtë:

1. *Sigurimi MTPL.* Në këtë komponent synohet të hartohen kërkesa rregullatore për përcaktimin e rezervave për produktin MTPL, që janë të përshtatshme nga ana aktuariale dhe për t'i inkuadruar ato me praktikat e mbikëqyrjes në vend. Objektivat e këtij komponenti janë: (i) të sigurohet për konsumatorët kryerja e pagesave të duhura dhe në kohë në lidhje me dëmet për produktin MTPL; (ii) të ndiqen të njëjtat standarde në sigurimin MTPL; dhe (iii) të sigurohet vlerësim i përshtatshëm i aftësisë paguese për të gjitha shoqëritë e sigurimit.
2. *Mbikëqyrja e sigurimeve të përgjithshme.* Në këtë komponent synohet zhvillimi i kuadrit ligjor në zbatim të ligjit të miratuar për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit, paketës së manualeve të mbikëqyrjes në vend dhe kuadrit rregullator për sigurimin e jetës. Objektivi i këtij komponenti është forcimi i kapacitetit mbikëqyrës institucional të AMF-së.
3. *Programi kombëtar i sigurimit nga tërmetet.* Në këtë komponent synohet plotësimi i bazës ligjore dhe rregullatore me elementët e sigurimit nga tërmeti. Objektivat e këtij komponenti janë: (i) Mbështetja e stabilizimit të tregut të sigurimeve, duke reduktuar ndikimet negative në likuiditetin e shoqërive të sigurimit që krijohen nga reforma në sigurimin e MTPL; (ii) Kontribuimi në zhvillimin dhe rritjen e shëndoshë të sektorit të pazhvilluar të sigurimeve; dhe (iii) Reduktimi i konsiderueshëm i ekspozimit fiskal kundrejt humbjeve që pësohen nga ngjarje tërmetesh të forta.

**Projekti i asistencës teknike për zgjerimin e tregut dhe mbikëqyrjen e pensioneve.** Projekti ka një kohëzgjatje prej 16 muajsh dhe është strukturuar në dy komponentë kryesorë, si më poshtë:

1. *Rregullimi dhe mbikëqyrja.* Në këtë komponent objektivi është të hartohet kuadri i mbikëqyrjes me bazë rrezikun, si elementi bazë për zbatimin e kësaj metodologjie mbikëqyrjeje në fushën e pensioneve.
2. *Zgjerimi i tregut të pensioneve.* Objektivi në këtë komponent është zgjerimi i mbulimit me pensione të punëmarrësve në Shqipëri.

**Projekti i asistencës teknike për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse me fokus zhvillimin e tregut të kapitaleve.** Projekti ka një kohëzgjatje prej 36 muajsh dhe është strukturuar në dy komponentë kryesorë, si më poshtë:

1. *Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për mbikëqyrjen dhe rregullimin e fondeve të investimeve.* Në këtë komponent synohet të kryhen vlerësimet diagnostikuese, të zhvillohet paketa e mbikëqyrjes (metodologjia, manualet dhe mjetet), si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore.

2. *Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për t'u përgatitur për emetimet e obligacioneve të shoqërive aksionare dhe atyre të qeverisë vendore*. Në këtë komponent synohet të kryhen vlerësimet diagnostikuese, si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në fushën e instrumenteve dhe tregjeve të borxhit.

**Sistemi i Menaxhimit të Informacionit.** Zbatimi i metodologjisë së re të mbikëqyrjes me fokus rreziku kërkon mbështetje teknologjike. Në këto, kushte prioritet i AMF do të jetë zhvillimi i formateve të reja në sistemin AMF In-Reg, në zbatim të metodologjisë së re të mbikëqyrjes dhe të dedikuara për inspektimin me fokus rreziku. Automatizimi i procesit të komunikimit të brendshëm synon rritjen e transparencës dhe rrit cilësinë e dokumentimit të gjykimit gjatë vlerësimit me bazë rrezikun. Gjithashtu në fokus të AMF do të jetë dhe shtrirja e kësaj platforme të raportimit elektronik edhe në segmente të tjera të tregjeve financiare, si në tregun e letrave me vlerë dhe pensioneve private.

**Zhvillimi teknologjik për të mbështetur aktivitetin mbikëqyrës konsiston në këto veprime:**

- Në funksion të rritjes së cilësisë së raportimit në Qendrën e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, AMF po vlerëson mundësinë e ndryshimeve në Regjistrin e Dëmeve për të bërë të mundur raportimin e dëmeve në kohë reale nga sistemet e shoqërive të sigurimit. Ky zhvillim do t'i jepte mundësi tregut dhe AMF të ndërtojnë një bazë cilësore të dhënash, jo vetëm për qëllime aktuariale, por duke e shndërruar atë në një bazë të dhënash kombëtare për aksidentet e ndodhura nga përdorimi i mjeteve motorike.
- Në kuadër të zbatimit të sistemit *bonus-malus*, AMF do ketë në fokus transparencën për konsumatorët. Për këtë qëllim, AMF ka projektuar dhe synon të verë në zbatim ndërtimin e një platforme për konsumatorët, të cilët mund të shohin dhe të verifikojnë historikun e tyre të dëmeve dhe të kategorizimit të rrezikut. Kjo platformë do bëjë të mundur ankesat si dhe trajtimin e tyre nga staf i autorizuar, nën kujdesin e AMF.

**Rregullimi efektiv i tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik.** AMF ka në vëmendje të vazhdueshme zhvillimet në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik. Si segmenti me peshën kryesore në tregun e sigurimeve, qëndrueshmëria e këtij portofoli përcakton shëndetin financiar të tregut në tërësi. Fokusi i AMF është tek provigjonimi i kujdesshëm dhe praktikat e tarifimit, duke i orientuar ato mbi bazën e rrezikut, në përputhje me kushtet e tregut të lirë. Drejtimet kryesore të punës së AMF do të jenë si më poshtë:

- Pas përmbylljes me sukses të zhvillimeve teknologjike, ndërtimi i një modeli orientues *Bonus-Malus* për tregun;
- Përafrimi i kuadrit aktual ligjor, që rregullon sigurimin e detyrueshëm motorik me direktivat e BE-së. Dy çështjet më thelbësore lidhen me përcaktimin në ligj

të modelit *Bonus-Malus*, në mënyrë që të ketë zbatim të unifikuar, **me objektiv kryesor mbrojtjen e konsumatorit**, si dhe rikonceptimi i funksionimit të Fondit të Kompensimit nga BSHS, duke filluar nga mënyra e financimit e deri te roli si fond garancie për tregun e sigurimeve të detyrueshme motorike;

- Rritja e kapaciteteve mbikëqyrëse, e në veçanti ato aktuariale, në funksion të provigjonimit të kujdesshëm dhe ndërtimit të bazave të të dhënave për tarifimin me bazë rreziku.

# SHTOJCA A
## Struktura e AMF-së



# SHTOJCA B
## Lista e Institucioneve të Mbikëqyrura

### TREGU I SIGURIMEVE

| | 1. INSIG sh.a. | 2. SIGMA INTERALBANIAN Vienna Insurance Group sh.a. | 3. SIGAL Uniqa Group Austria sh.a. | 4. ATLANTIK sh.a. |
|---|---|---|---|---|
| *Drejtor i Përgjithshëm* | **Edlira DVORANI** | **Qemal DISHA** | **Avni PONARI** | **Dritan ÇELAJ** |
| *Fusha e Aktivitetit* | Sigurime Jetë + Jo-Jetë | Sigurime Jo-Jetë | Sigurime Jo-Jetë, Risigurime | Sigurime Jo-Jetë |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital shtetëror | Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas | Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas | Shoqëri me kapital vendas |
| *Adresa e Selisë* | ABA Center, Rruga "Papa Gjon Pali II", kati i gjashtë, zyra nr. 600, Tiranë | Rr. “Komuna e Parisit” P. Lura, Kati 2, Tiranë, | Bul. “Zogu I”, Nr. 1 , Kutia Postare Nr. 2387, Tiranë | Rr. “Themistokli Gërmenji”, 3/1, Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 42 223 838 | +355 42 258 254/ 253 | +355 42 233 308/ 253 407/408/<br>+355 42 250 220 | +355 42 230 506<br>+355 42 235 088 |
| *Faqja e Internetit* | *www.insig.com.al* | *www.sigma-al.com* | *www.sigal.com.al* | *www.atlantik.com.al* |
| *Posta Elektronike* | *info@insig.com.al* | *info@sigma-al.com* | *info@sigal.com.al* | *atlantik@atlantik.com.al* |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 3 dt. 08.06.2000<br>Nr. 4 dt. 08.06.2000 | Nr. 01 dt. 03.02.1999 | Nr. 02 dt. 23.06.1999<br>Nr. 06 dt. 03.02.2006 | Nr. 5 dt. 13.04.2001 |
| *Dt. mbarimit të licencës* | Pa afat | Pa afat | Pa afat | Pa afat |

| | 5. INTERSIG Vienna Insurance Group sh.a. | 6. EUROSIG sh.a. | 7. ALBSIG sh.a. | 8. ANSIG sh.a. |
|---|---|---|---|---|
| *Drejtor i Përgjithshëm* | **Gentian SULA** | **Muharrem BARDHOCI** | **Natasha DHOQINA** | **Edlir RUKA** |
| *Fusha e Aktivitetit* | Sigurime Jo-Jetë | Sigurime Jo-Jetë | Sigurime Jo-Jetë | Sigurime Jo-Jetë |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas | Shoqëri me kapital vendas | Shoqëri me kapital vendas | Shoqëri me kapital vendas |
| *Adresa e Selisë* | Rr. “Ismail Qemali”, Ndërtesa Samos Tower, kati 2, Kutia Postare 8292, Tiranë | Rr “Papa Gjon Pali II”, vila Nr. 5, Tiranë | Rr. “George W. Bush”, Nr. 10, Tiranë | Rr. “Donika Kastrioti”, Vila 9/1<br>(Rr. 4 Shkurti), Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 42 270 576/577 | +355 42 238 899/999,<br>+355 42 223 841 | +355 42 254 770<br>+355 42 254 664 | +355 42 263 490/445/486 |
| *Faqja e Internetit* | *www.intersig.al* | *www.eurosig.al* | *www.albsig.com.al* | *www.ansig.al* |
| *Posta Elektronike* | *info@intersig.al* | *info@eurosig.al* | *info@albsig.com.al* | |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 6 dt. 13.09.2001 | Nr. 7 dt. 8.07.2004 | Nr. 10 dt. 19.07.2004 | Nr. 12 dt. 22.06.2012 |
| *Data e mbarimit të licencës* | Pa afat | Pa afat | Pa afat | Pa afat |

| | 9. SICRED sh.a. | 10. SIGAL-LIFE Uniqa Group Austria sh.a. | 11. MAI sh.a. | 12. 3B BROKER sh.a. |
|---|---|---|---|---|
| *Drejtor i Përgjithshëm* | Genc KOXHAJ | Edvin Hoxhaj | Elnar Gashi | Bashkim Kryeziu |
| *Fusha e Aktivitetit* | Sigurime Jetë | Sigurime Jetë | Broker në sigurime në klasat e Jo-Jetës | Broker në sigurime në klasat e Jo-Jetës |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital vendas | Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas | Shoqëri me kapital të huaj | Shoqëri me kapital vendas |
| *Adresa e Selisë* | Rr. Brigada e VIII, Vila 3/1, Tiranë | Bul. "Zogu I", Nr 1, Tiranë | Rr. "Ismail Qemali", pallati Gener 2 (Valle Verde), Kati III, zyra 4, Tiranë | Rr. "Mustafa Matohiti", pallati 7, shk. 2, ap.8, Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 42 237 549<br>+355 42 237 530 | +355 42 253 407/ 408<br>+355 42 233 308 | +355 42 500 514 | +355 42 248 768/42 248 756 |
| *Faqja e Internetit* | *www.sicred.com.al* | *www.sigal.com.al* | *www.mai-cee.com* | |
| *Posta Elektronike* | *contact@sicred.com.al* | *infolife@sigal.com.al* | *elnar.gashi@mai-cee.com* | *info@3bbroker.al* |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 8 dt. 26.07.2004 | Nr. 11 dt. 28.07.2004 | Nr. 1 dt. 11.09.2008 | Nr. 2 dt. 26.03.2009 |
| *Data e mbarimit të licencës* | Pa afat | Pa afat | Pa afat | Pa afat |
| | 13. DEVON sh.a. | 14. ALL - SIG sh.a. | 15. A-EJA INSURANCE BROKER sh.a. | 16. WVP Ndërmjetës në sigurime sh.a. |
| *Drejtor i Përgjithshëm* | Valbona Carcani | Rezarta ZHUKRI | Anila QENDRO | *Ardian KELMENDI* |
| *Fusha e Aktivitetit* | Broker në sigurime | Broker në sigurime në klasat e Jo-Jetës | Broker në sigurime në klasat e Jo-Jetës | Broker në sigurime në klasat e Jetës dhe Jo-Jetës |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital vendas | Shoqëri me kapital vendas | Shoqëri me kapital vendas | Shoqëri me kapital të huaj |
| *Adresa e Selisë* | Bul. "Bajram Curri", Rr. "As-dreni", pallati 4, shk. 1, ap1, Tiranë | Rr. "Abdyl Frasheri", pallati De Rada, Tiranë | Rr. "Pjetër Bogdani", Pall 20, kat 1, Tiranë | Rr. "Sami Frashëri", Pallati Vortek 2, shkalla 2, Ap.5, Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 42 379 925,<br>+355 69 20 58424 | +355 42 257 903 / 42 238 018, | +355 42 249 952<br>+355 42 227 307 | +355 42 224 525 |
| *Faqja e Internetit* | | | | *www.wvp.al* |
| *Posta Elektronike* | *valbona_carcani@yahoo.com* | *info@allsigbroker.al* | *a.qendro@a-ejainsurance.com* | *wvptirana@wvp.al* |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 3 dt. 10.12.2009<br>Nr. 12 dt 23.12.2013 | Nr. 5 dt. 19.03.2010 | Nr. 7 dt. 21.05.2010 | Nr. 10 dt. 25.04.2012 |
| Data e mbarimit të licencës | Pa afat | Pa afat | Pa afat | Pa afat |

| | 17. STAR BROKER sh.a. | 18. IFIS Broker sh.a. |
|---|---|---|
| *Drejtor i Përgjithshëm* | ***Arben SIMAKU*** | ***Edmira MUÇKA*** |
| *Fusha e Aktivitetit* | Broker ne sigurime për klasat e Jo-Jetës | Broker në sigurime në klasat e Jetës, Jo-Jetës dhe Risigurime |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital vendas | Shoqëri me kapital vendas |
| *Adresa e Selisë* | Rr. Nikolla Tupe, Pall. 1/1, Tiranë | Rr. "Ismail Qemali", Pallati 2K, kati 8, Ap.40, Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 69 40 37 001 | +69 20 87 987 |
| *Faqja e Internetit* | | |
| *Posta Elektronike* | *arben.simaku@gmail.com* | |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 11 dt. 23.05.2013 | Nr. 13 dt. 23.01.2014 |
| *Data e mbarimit të licencës* | Pa afat | Pa afat |

## TREGU I LETRAVE ME VLERË

| | 1. RAIFFEISEN BANK sh.a. | 2. BANKA KOMBËTARE TREGTARE sh.a. | 3. INTESA SAN PAOLO Bank Albania sh.a. |
|---|---|---|---|
| *Drejtor Ekzekutiv* | ***Christian CANACARIS*** | ***Seyhan PENCAPLIGIL*** | ***Silvio PEDRAZZI*** |
| *Fusha e Aktivitetit* | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH. | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH. | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH. |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital të huaj | Shoqëri me kapital të huaj | Shoqëri me kapital të huaj |
| *Adresa e Selisë* | European Trade Center, Bul. "Bajram Curri", Tiranë | Bul. "Zhan D'ark", Tiranë | Rr. "Ismail Qemali", Nr. 27, Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 42 226 699<br>+355 42 275 599 | +355 4 250 955<br>+355 4 250 956 | +355 42 276 000/42 248 762 |
| *Faqja e Internetit* | *www.raiffeisen.al* | *www.bkt.com.al* | *www.intesasanpaolobank.al* |
| *Posta Elektronike* | *info@raiffeisen.al* | *info@bkt.com.al* | *opinion@intesasanpaolobank.al* |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 3 dt. 25.06.2009<br>Nr. 6 dt. 29.09.2010 | Nr. 4 dt. 25.06.2009<br>Nr. 7 dt. 18.11.2010 | Nr. 6 dt. 25.06.2009<br>Nr. 2 dt. 21.05.2010 |
| *Data e mbarimit të licencës* | Pa afat | Pa afat | Pa afat |

| | 4. ALPHA BANK -Tirana sh.a. | 5. BANKA CREDINS sh.a. | 6. BANKA E TIRANËS sh.a. |
|---|---|---|---|
| *Drejtor Ekzekutiv* | ***Periklis DROUGKAS*** | ***Maltin KORKUTI*** | ***Savvas THALASSINOS*** |
| *Fusha e Aktivitetit* | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH. | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH. dhe i obligacioneve të shoqërive aksionare dhe të Qeverisë vendore | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH. |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital të huaj | Shoqëri me kapital vendas | Shoqëri me kapital të huaj |
| *Adresa e Selisë* | "Rruga e Kavajës", G-KOM Business Center, Tiranë | Rr."Ismail Qemali", Nr. 4, Tiranë | Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 42 233 550 | +355 42 234 096<br>+355 42 222 916 | +355 42 277 700<br>+355 42 263 022 |
| *Faqja e Internetit* | *www.alphabank.al* | *www.bankacredins.com* | *www.tiranabank.al* |
| *Posta Elektronike* | *qualityassurance.albania@alpha.gr* | *info@bankacredins.com* | *info@tiranabank.net* |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 7 dt. 25.06.2009<br>Nr. 3 dt. 28.06.2010 | Nr. 8 dt. 25.06.2009<br>Nr. 4 dt. 30.08.2010<br>Nr. 1 dt. 13.12.2011 | Nr. 1 dt. 21.05.2010<br>Nr. 1 dt. 21.05.2010 |
| *Data e mbarimit të licencës* | Pa afat | Pa afat | Pa afat |
| | 7. BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA sh.a. | 8. BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE sh.a. | 9. FIRST INVESTMENT BANK sh.a. |
| *Drejtor Ekzekutiv* | ***Frederic BLANC*** | ***Gideon Van Den BROEK*** | ***Bozhidar TODOROV*** |
| *Fusha e Aktivitetit* | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe në tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH. | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë | Shoqëri brokerimi ne letra me vlere te Qeverisë së R.SH.<br>në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH. |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas | Shoqëri me kapital të huaj | Shoqëri me kapital të huaj |
| *Adresa e Selisë* | Bul. "Dëshmorët e Kombit", Kulla Binjake I, Tiranë | Rr. "Murat Toptani", kati VII , pranë Gjergji Center, Tiranë | Bul. "Dëshmorët e Kombit", Twin Towers Nr. 2 Kati i 14 & 15, Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 42 280 442/3<br>+355 42 280 441 | + 355 42 256 254<br>+ 355 42 254 368 | +355 42 256 423/424<br>+355 42 256 422 |
| *Faqja e Internetit* | *www.societegenerale.al* | *www.icbank-albania.com* | *www.fibank.com* |
| *Posta Elektronike* | *info@societegenerale.al* | *enquiry@icbank-albania.com* | |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 5 dt. 25.06.2009<br>Nr. 8 dt. 13.12.2011<br>Nr. 5/1 dt. 21.03.2012 | Nr. 11 dt. 25.06.2009 | Nr. 12 dt. 29.09.2010<br>Nr. 5 dt. 29.09.2010 |
| *Data e mbarimit të licencës* | Pa afat | Pa afat | Pa afat |

| | 10. POSTA SHQIPTARE sh.a. | 11. KAPITAL INVEST sh.a. | 12. TRIUMF GROUP sh.a. |
|---|---|---|---|
| *Drejtor* | ***Majlind Lazimi*** | ***Lirim MUHARREMI*** | ***Mirela ANGJELI*** |
| *Fusha e Aktivitetit* | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë (bono thesari) të Qeverisë së R.SH. në tregun me pakicë | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakice | Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital shtetëror | Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas | Shoqëri me kapital vendas |
| *Adresa e Selisë* | Rr. “Reshit Collaku”, nr. 4, Tiranë | Bul. “Dëshmorët e Kombit”, Twin Towers Nr. 2 Kati i 11, Tiranë | Rr. “M. Gjollesha”, Kulla 2, ap. 13, Tiranë |
| *Tel./Faks* | + 355 42 222 315<br>+ 355 42 266 559 | +355 42 280 202 | +355 68 20 58 275<br>+355 42 256 081 |
| *Faqja e Internetit* | ***www.postashqiptare.al*** | | |
| *Posta Elektronike* | ***posta@postashqiptare.al*** | | |
| *Nr. Licencës/ Data e Licencës* | Nr. 10 dt. 25.06.2009 | Nr. 9 dt. 25.06.2009 | Nr. 2 dt. 25.06.2009 |
| *Data e mbarimit të Licencës* | Pa afat | Pa afat | Pa afat |
| | 13. AKSIONER INTERNATIONAL SECURITIES BROKERAGE sh.a. | 14. APIA WEALTH MANAGEMENT ALBANIA sh.a. | 15. BURSA E TIRANËS sh.a. |
| *Drejtor* | ***Alma HASANAJ*** | ***Aleksandër PRIFTI*** | ***Anila FURERAJ*** |
| *Fusha e Aktivitetit* | Shoqëri brokerimi në tituj për blerjen dhe shitjen e titujve me porosi të klientit në tregun e licencuar në territorin e R.SH. si dhe Agjent brokeri në letra me vlerë në emër dhe për llogari të shoqërisë "Saxo Bank" | Shoqëri këshillimi për investime në tituj | Treg i organizuar letrash me vlerë |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital të huaj | Shoqëri me kapital vendas | Shoqëri me kapital shtetëror |
| *Adresa e Selisë* | Rr. “Qemal Stafa”, pall. 31, njësia tregtare 2, nr. 20, Tiranë | Rr. “Sheshi “Italia”, Sheraton, ambjenti R.T. B7” Tiranë | Rr. “Dora D’Istria”, Nr. 2, Kutia Postare 274/1, Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 44 400 600 | | +355 42 265 058 |
| *Faqja e Internetit* | *www.aksioner.com* | | *www.tse.com.al* |
| *Posta Elektronike* | *info@aksioner.com* | | *tseinfo@abcom-al.com* |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 13 dt. 28.04.2011<br>VB. Nr. 64 dt. 28.04.2011 | Nr. 1 dt 16.07.2013 | dt. 13.07.2007 |
| *Data e mbarimit të licencës* | Pa afat | Pa afat | Pa afat |

| | 16. QENDRA E REGJISTRIMIT TË AKSIONEVE sh.a. | |
|---|---|---|
| *Drejtor* | ***Gentian ALIKA*** | |
| *Fusha e Aktivitetit* | Regjistrues i aksioneve të shoqërive tregtare | |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital shtetëror | |
| *Adresa e Selisë* | Rr. "George W. Bush", Nr. 13, Kutia Postare 7424, Tiranë | |
| *Tel./Faks* | +355 42 233 442, +355 42 233 425 | |
| *Faqja e Internetit* | *www.qra.al* | |
| *Posta Elektronike* | *info@qra.al* | |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | dt. 05.11.2002 | |
| *Data e mbarimit të licencës* | Pa afat | |
| | FONDI I INVESTIMIT RAIFFEISEN PRESTIGJ (Ref. FI-B1) | FONDI I INVESTIMIT "RAIFFEISEN INVEST EURO" (Ref. FI-B2) |
| | Nën administrimin e "Raiffeisen Invest-shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive" sh.a. | Nën administrimin e "Raiffeisen Invest-shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive" sh.a. |

## TREGU I PENSIONEVE PRIVATE VULLNETARE

| | 1. Raiffeisen Invest - Shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive sh.a. | 2. Shoqëri administruese e fondeve të pensionit SIGAL-LIFE Uniqa Group Austria sh.a. | 3. Shoqëri administruese e fondeve të pensionit SiCRED sh.a. |
|---|---|---|---|
| *Administrator i Përgjithshëm* | ***Resmi HIBRAJ*** | ***Naim HASA*** | ***Estela KOCI*** |
| *Fusha e Aktivitetit* | Shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive | Shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar | Shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital të huaj | Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas | Shoqëri me kapital vendas |
| *Adresa e Selisë* | Rr. "Bajram Currri", ETC Kati 10, Tiranë. | Bul. "Zogu I", Tiranë | Rr. Brigada e VIII, Vila 3/1, Tiranë |
| *Tel./Faks* | + 355 42 277 901<br>+355 42 277 905 | +355 42 233 308<br>+355 42 250 220 | +355 42 237 549/ 496<br>+355 44 538 674 |
| *Faqja e Internetit* | *www.raiffeisen.al* | *www.fppsigal.com.al* | *www.sicred-pensions.com.al* |
| *Posta Elektronike* | *invest@raiffeisen.al* | *naimhasa@sigal.com.al* | *ekoci@sicred.com.al* |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 1 dt 18.10.2010 dhe Nr. 1 dt. 13.12.2011 | Nr. 2 dt. 30.03.2011 | Nr. 3 dt. 23.11.2011 |
| *Data e mbarimit të licencë* | Pa afat | Pa afat | Pa afat |

| | 4. FIRST INVESTMENT Bank sh.a. | 5. BANKA E TIRANËS sh.a. | 6. SOCIETE GENERALE ALBANIA sh.a. |
|---|---|---|---|
| *Drejtor Ekzekutiv* | ***Bozhidar TODOROV*** | ***Savvas THALASSINOS*** | ***Frederic BLANC*** |
| *Fusha e Aktivitetit* | Depozitar i aseteve të fondeve të pensionit vullnetar dhe i sipërmarrjeve të investimeve kolektive | Depozitar i aseteve të fondeve të pensionit vullnetar | Depozitar i aseteve të fondeve të pensionit vullnetar |
| *Lloji i Pronësisë* | Shoqëri me kapital të huaj | Shoqëri me kapital të huaj | Shoqëri me kapital privat të huaj dhe vendas |
| *Adresa e Selisë* | Bul. "Dëshmorët e Kombit", Twin Towers Nr. 2 Kati i 14 & 15, Tiranë | Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë | Bul. "Dëshmorët e Kombit", Kulla Binjake I, Tiranë |
| *Tel./Faks* | +355 42 276 702/3<br>+355 42 280 210 | +355 42 269 616/617/429<br>+355 42 269 707 | +355 42 280 442/3<br>+355 42 280 441 |
| *Faqja e Internetit* | *www.fibank.com* | *www.tiranabank.al* | *www.societegenerale.al* |
| *Posta Elektronike* | | *info@tiranabank.net* | *info@socgen.com* |
| *Nr. Licencës/ Data e licencës* | Nr. 1 dt. 30.08.2010 dhe<br>Nr. 1 dt. 13.12.2011 | Nr. 2 dt. 18.11.2010 | Nr. 3 dt. 13.12.2011 |
| *Data e mbarimit të licencës* | Pa afat | Pa afat | Pa afat |
| | FONDI I PENSIONIT VULLNETAR RAIFFEISEN (Ref. FP 1) | FONDI I PENSIONIT VULLNETAR SIGAL (Ref. FP 2) | FONDIN PENSIONIT VULLNETAR SiCRED PENSIONS (Ref. FP 3) |
| | Nën administrimin e "Raiffeisen Invest-shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive" sh.a. | Nën administrimin e "Shoqërisë administruese të fondeve të SIGAL-Life Uniqa Group Austria" sh.a. | Nën administrimin e "Shoqërisë administruese të fondeve të pensionit SiCRED" sh.a. |

# SHTOJCA C
## Anëtarësime dhe Marrëveshje Bashkëpunimi të Nënshkruara

| | | Viti | Institucioni |
|---|---|---|---|
| **A.** | **Anëtarësime në Organizma Ndërkombëtare të Rregullatorëve** | | |
| | IOSCO (Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë) | 1998 | KLV (sot AMF) |
| | IAIS (Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve) | 2001 | AMS (sot AMF) |
| | IOPS (Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve) | 2006 | AMF |
| **B.** | **Marrëveshje të Nënshkruara me Institucione Homologe Jashtë Vendit** | | |
| | Komisioni i Tregut të Kapitaleve të Greqisë | 1999 | KLV (sot AMF) |
| | Komisioni i Letrave me Vlerë të Quebecut (Autoriteti i Tregjeve Financiare të Quebec) | 2000 | KLV (sot AMF) |
| | Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursës i Italisë | 2002 | KLV (sot AMF) |
| | Agjencia e Tregut të Letrave me Vlerë të Sllovenisë | 2003 | KLV (sot AMF) |
| | Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursave i Polonisë (sot Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë) | 2003 | KLV (sot AMF) |
| | Bordi i Tregut të Kapitaleve i Turqisë | 2003 | KLV (sot AMF) |
| | Autoriteti Bankar dhe Pagesave i Kosovës (sot Banka Qendrore e Republikës së Kosovës) | 2004 | AMS (sot AMF) |
| | Komisioni i Mbikëqyrjes së Tregut Financiar i Bullgarisë | 2005 | KLV (sot AMF) |
| | Komisioni Kombëtar i Letrave me Vlerë i Rumanisë | 2005 | KLV (sot AMF) |
| | Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursës së Maqedonisë | 2005 | KLV (sot AMF) |
| | Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursës së Malit të Zi | 2005 | KLV (sot AMF) |
| | Komisioni i Letrave me Vlerë i Kroacisë (sot Agjencia e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare të Kroacisë) | 2005 | KLV (sot AMF) |
| | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) | 2008 | AMF |
| | Ministria Austriake e Financave & Autoriteti i Tregut Financiar të Austrisë | 2009 | AMF |
| | Marrëveshja Multilaterale e Mirëkuptimit me IOSCO-n | 2009 | AMF |
| | Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë, (ISA) | 2010 | AMF |
| | Agjencioni për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional të Maqedonisë, (MAPAS) | 2012 | AMF |
| | Autoriteti Evropian i Tregjeve dhe Letrave me Vlerë (ESMA) | 2013 | AMF |
| **C.** | **Marrëveshje të Nënshkruara me Organizata Brenda Vendit** | | |
| | Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës | 2002 | KLV (sot AMF) |
| | Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) | 2003 | KLV (sot AMF) |
| | Banka e Shqipërisë | 2005 | AMS, KLV (sot AMF) |
| | Autoriteti i Konkurrencës | 2006 | AMF |
| | Drejtoria e Përgjithshme e Doganave | 2009 | AMF |
| | Bordi i Mbikëqyrjes Publike | 2010 | AMF |
| | Ministria e Brendshme | 2011 | AMF |
| | Ministria e Punëve Publike dhe Transportit | 2011 | AMF |
| | Marrëveshje në kuadrin e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF) | 2012 | AMF |
| | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor | 2012 | AMF |

## Raporti i Ekspertit Kontabël të Regjistruar të Pavarur

### Bordit të AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të cilat përfshijnë bilancin më 31 Dhjetor 2014 dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

### *Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Manualin Kontabël për Klasifikimin Buxhetor Ekonomik, Planin Kontabël për Institucionet Buxhetore dhe Udhëzimeve Nr.14 datë 28.12.2006 dhe Nr. 26 datë 27.12.2007 të Ministrit të Financave si dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

### *Përgjegjësia e Ekspertit Kontabel të Regjistruar*

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë që mbështet tepricat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura janë në varësi të gjykimit tonë, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, prej gabimit apo mashtrimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne shqyrtojmë kontrollin e brendshëm, i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por që nuk kanë për qëllim shprehjen e një opinioni për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga Drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

## *Opinioni*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Autoritetit te Mbikëqyrjes Financiare më 31 Dhjetor 2014 si dhe performancën financiare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Rregullat dhe Politikat Kontabel në fuqi për Institucionet Buxhetore dhe të ngjashme me to.

Tiranë, 30 Mars 2015

Artan Xhiani, CPA, EKR
UHY Elite sh.p.k



## BILANCI PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2014 DHE 31 DHJETOR 2013

*(në lekë)*

| AKTIVI I BILANCIT KONTABËL | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| AKTIVE TË QËNDRUESHME | 72,967,958 | 74,918,988 |
| **I. TË PA TRUPËZUARA** | | |
| Studime dhe kërkime | | |
| Koncesione, patenta, licensa e të tjera të ngjashme | | |
| Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara (-) | | |
| Shpenzime për rritjen e AQ të patrupëzuar | | |
| **II. AKTIVE TË QËNDRUESHME TË TRUPËZUARA** | **72,967,958** | **74,918,988** |
| Toka, troje, terene | | |
| Ndërtime e konstruksione | 50,708,505 | 50,708,505 |
| Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune | | |
| Mjete transporti | 6,450,000 | 6,450,000 |
| Rezerva shtetërore | | |
| Kafshë pune e prodhimi | | |
| Inventar ekonomik | 44,703,776 | 43,466,180 |
| Amortizimi i aktiveve të qëndrushme të trupëzuara | (28,894,323) | (25,705,697) |
| Shpenzime në proces për rritjen e AQT | | |
| **III. AKTIVE FINANCIARE** | | |
| Huadhënie e nënhuadhënie | | |
| Pjesëmarrje në kapitalin e vet | | |
| AKTIVE QARKULLUESE | 109,801,167 | 31,798,899 |
| **I. GJENDJA E INVENTARIT** | **5,393,621** | **6,543,017** |
| Materiale | 2,417,993 | 3,962,589 |
| Objekte inventari | 2,975,628 | 2,580,428 |
| Prodhime, punime e shërbime në proces | | |
| Produkte | | |
| Mallra | | |
| Shuma të parashikuara për zhvlerësim të inventarit (-) | | |
| **II. KËRKESA ARKËTIMI MBI DEBITORËT** | **30,420,418** | **20,748,667** |
| Furnitorë (Debitorë), parapagime e pagesa pjesore | | |
| Klientë e llogari të ngjashme | 28,682,403 | 15,019,575 |
| Personeli, paradhënie, deficite e gjoba | 38,315 | 229,092 |

| | | |
|---|---|---|
| Të drejtat e taksa për t'u derdhur në shtet | | |
| Debitorë të ndryshëm | 1,700,000 | 5,500,000 |
| Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-) | | |
| **III. LLOGARITË FINANCIARE** | **73,986,828** | **4,507,215** |
| Llogaritë në bankë | 73,966,828 | 4,507,215 |
| Disponibilitete në thesar | | |
| Llogari në arkë | | |
| Garanci bankare | 20,000 | |
| **LLOGARI TË TJERA AKTIVE** | | |
| Diferenca konvertimi aktive | | |
| Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime | | |
| Shpenzime të periudhave të ardhshme | | |
| **REZULTATI I USHTRIMIT** | | |
| **TOTALI I AKTIVIT** | **182,769,125** | **106,717,887** |

| PASIVI I BILANCIT KONTABËL | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| FONDE TË VETA | 134,219,898 | 66,700,524 |
| **I. Fonde të veta** | **63,821,898** | **66,700,524** |
| Fonde bazë | 63,821,898 | 66,700,524 |
| Grante të brendshme kapitale | | |
| Grante të huaja kapitale | | |
| Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme | | |
| **II. Fonde të tjera të veta** | **70,398,000** | |
| Fonde rezervë | 70,398,000 | |
| Caktim nga rezultati i vitit për investime | | |
| Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme | | |
| **III. Rezultati i mbartur** | | |
| IV. Subvencione të jashtëzakonshme | | |
| V. Pjesëmarrje të institucionit në investime për të tretë | | |
| VI. Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime | | |
| DETYRIME | | |
| **I. Borxhe afatgjatë** | | |
| Huamarrje e brendshme dhe të ngjashme | | |
| Huamarrje e huaj | | |
| **II. Detyrime afatshkurtër** | **2,924,179** | **8,666,924** |
| Klientë (Kreditorë), parapagesa pjesore | | |
| Furnitorë e llogari të lidhura me to | 817,241 | 6,689,594 |
| Personeli e llogari të lidhura me to | 28,330 | 26,407 |
| Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa | 988,513 | 826,169 |
| Tatime të mbledhura nga shteti për llogari të pushtetit lokal | | |
| Shteti fatkeqësi natyrore | | |
| Të tjera operacione me shtetin (kreditor) | | |
| Sigurime shoqërore | 946,860 | 987,694 |
| Sigurime shëndetësore | 143,235 | 137,060 |
| Kreditorë të ndryshëm | | |
| LLOGARI TË TJERA | 45,625,048 | 31,350,439 |
| Të ardhura për t'u rregjistruar në vitet pasardhëse | 45,625,048 | 31,350,439 |
| Diferenca konvertime pasive | | |
| Të ardhura për t'u klasifikuar ose rregulluar | | |
| Të ardhura të arkëtuara para nxjerrjes së titullit | | |
| REZULTATI I USHTRIMIT | | |
| TOTALI I PASIVIT | 182,769,125 | 106,717,887 |

| SHPENZIME TË USHTRIMIT | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| **A. SHPENZIMET E SHFRYTËZIMIT (I-III)** | **109,400,684** | **111,744,334** |
| **I. Shpenzime korrente** | **108,251,288** | **113,717,705** |
| Paga, shpërblime e të tjera personeli | **59,215,765** | **60,211,975** |
| Paga, personel i përhershëm | 48,996,254 | 49,476,882 |
| Paga, personel i përkohshëm | 1,479,390 | 2,303,282 |
| Shpërblime | 8,086,461 | 7,993,837 |
| Shpenzime të tjera personeli | 653,660 | 437,974 |
| Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore | **11,448,085** | **10,675,885** |
| Kontribute për sigurimet shoqërore e shëndetësore | 7,814,276 | 7,750,319 |
| Kontribute për fondet e pensioneve vullnetare | 3,633,809 | 2,925,566 |
| **Mallra dhe shërbime të tjera** | **37,587,438** | **42,829,845** |
| Materiale zyre dhe të përgjithëshme | 1,161,281 | 1,278,174 |
| Materiale dhe shërbime speciale | 587,460 | 721,200 |
| Shërbime nga të tretë | 4,772,169 | 5,784,816 |
| Shpenzime transporti | 931,322 | 1,966,175 |
| Shpenzime udhëtimi | 10,501,898 | 13,311,110 |
| Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme | 301,480 | 828,096 |
| Shpenzime për qeramarrje | 0 | 0 |
| Shpenzime për detyrime për kompesime legale | 0 | 0 |
| Shpenzime të tjera operative | 13,640,623 | 13,365,970 |
| Transferime për Organizatat Ndërkombëtare | 5,691,205 | 5,574,304 |
| Subvencionet | | |
| **II. Ndryshimi i gjendjeve të inventarit (+-)** | **1,149,396** | **(2,131,163)** |
| **III. Kuota amortizimi dhe shuma të parashikuara** | | |
| Kuotat e amortizimit të shfrytëzimit | | |
| Vlera e mbetur e AQ të nxjerra jashtë përdorimit e të shitura | | |
| **B. SHPENZIME FINANCIARE (I+II)** | **0** | **157,792** |
| Interesa për bono thesari dhe kredi direkte | | |
| Interesa për huamarrje të tjera | | |
| Shpenzimet nga këmbimet valutore | 0 | 157,792 |

| | | |
|---|---|---|
| **C. SHPENZIME TË JASHTËZAKONSHME** | **0** | **0** |
| Humbje nga gabime të lejuara në ushtrimin paraardhës | | |
| Shpenzime të tjera të jashtëzakonshme | | |
| **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **109,400,684** | **111,744,334** |
| **D. OPERACIONE KORRIGJUESE TE REZULTATIT** | | |
| Tituj të ardhurash të anulluara | | |
| Caktim të ardhurash funksionale për investime | | |
| Derdhje të ardhurash në buxhet | | |
| Derdhje në buxhet e të ardhurave të pa përdorura | | |
| Transferim të ardhurash brenda sistemit | | |
| Transferime për ndryshim gjendjeje | 0 | 2,131,163 |
| Transferim për debitorë të konstatuar e të ngjashme | | |
| **TOTALI I OPERACIONEVE** | **0** | **113,875,497** |
| **REZULTATI NGA FUNKSIONIMI** | | |
| **TOTALI** | **109,400,684** | **113,875,497** |

| TË ARDHURA TË USHTRIMIT | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| A. TË ARDHURA TË SHFRYTËZIMIT | 107,915,677 | 113,869,514 |
| I. TË ARDHURA JO TATIMORE (a+b+c) | 107,915,677 | 113,869,514 |
| a) Nga ndërmarrjet dhe pronësia | 105,615,677 | 113,869,514 |
| Nga njësi ekonomike publike dhe private jo financiare | | |
| Nga njësi ekonomike publike dhe private financiare | 105,615,677 | 113,569,514 |
| b) Shërbime administrative e të ardhura sekondare | 2,300,000 | |
| Të ardhura nga vlerësimi i dëmeve | | |
| Nga shitja e mallrave e shërbimeve | | |
| Gjoba dhe kamatvonesa, sekuestrime e zhdëmtime | 2,300,000 | 300,000 |
| c) Të tjera të ardhura jo tatimore | | |
| II. GRANTE KORENTE | 0 | |
| a) Grant korent i brendshëm | | |
| Nga i njëjti nivel Qeverisjeje | | |
| Nga nivele të tjera Qeverisjeje | | |
| B. TË ARDHURA FINANCIARE | 335,661 | 5,983 |
| Nga interesat e huadhënies së brendshme | | |
| Të ardhura nga interesat e depozitave | 18,855 | 5,983 |
| Të ardhura nga këmbimet valutore | 316,756 | |
| C. TË ARDHURA TË JASHTËZAKONSHME | 0 | 0 |
| Nga veprimtari të mbyllura e ndryshime të tjera strategjike | | |
| Nga gabime të lejuara në ushtrimet paraardhëse | | |
| **Korrigjime nga vitet e kaluara** | | |
| **Të ardhura të tjera** | | |
| TOTALI I TË ARDHURAVE | 108,251,288 | 113,875,497 |
| D. OPERACIONE TË KORRIGJUARA TË REZULTATIT | 1,149,396 | |
| Urdhër për shpenzime anulluar ose parashkruar | | |
| Transferimi i ndryshimit të gjendjeve | | |
| **TOTALI I OPERACIONEVE** | **109,400,684** | **113,875,497** |
| **REZULTATI I VEPRIMTARISË** | | |
| TOTALI | 109,400,684 | 113,875,497 |